



**PËRMBLEDHJE E
VENDIMEVE TË
KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

2021

PËRMBAJTJA

I. ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS	6
1. Grup personash kundër Policisë Bashkiake Tiranë	6
2. Qendra “T’REJA” kundër S.N.,	9
3. R.H., kundër Bankës Credins	11
II. ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË IDENTITETIT GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL.....	13
4. Çështje kryesisht “Në lidhje me deklaratat e A.P., mbi komunitetin LGBTI, të bëra në emisionin “Zonë e Lirë”, të datës 18.06.2021, në TV Klan dhe emisionin “Ndryshe”, të datës 22.06.2021, në Top Albania Radio.”	13
5. Çështje kryesisht kundër “Green Taxi”	18
III. ÇËSHITJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE	21
6. M.K., kundër Bashkisë Vorë.....	21
7. E.V., kundër Bashkisë Berat.....	23
8. E.D., kundër Bashkisë Kamëz	25
9. S.P., kundër Bashkisë Berat.....	28
10. D.H., kundër Bashkisë Berat.....	30
11. N.S., kundër Ujësjetës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.,.....	32
12. L.E., kundër Bashkisë Berat	35
13. H.K., kundër Bashkisë Mat.....	38
14. M.K., kundër Bashkisë Berat	40
15. G.Gj., kundër L.B., Zv/Kryetar i Bashkisë Berat dhe E.D., Kryetar i Bashkisë Berat	42
16. F.H., kundër Bashkisë Klos	45
17. E.Rr., kundër Bashkisë Lezhë.....	47
18. A.L., kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Lezhë.....	49
19. D.M., kundër Bashkisë Kukës.....	53
20. G.M., kundër Administratorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.....	54
21. K.K., kundër Bashkisë Selenicë	57

22.	F.Rr., kundër Ujësjellës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë	59
23.	S.L., kundër Bashkisë Vau i Dejës	62
24.	F.B., kundër Bashkisë Berat.....	64
25.	M.Xh., kundër Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme.....	67
IV.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE.....	71
26.	M.Q., kundër Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Tiranë.....	71
27.	B.I., kundër Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës	75
V.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË SHSTATZËNISË.....	78
28.	R.T., kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës	78
VI.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË	80
29.	V.G., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës	80
30.	E.SH., kundër A.G.J., Shef i Forces së Sigurisë Portuale Shengjin	82
31.	L.G.J., kundër Bashkisë Kukës.....	85
VII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE	88
32.	Gj.N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).....	88
VIII.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR.....	90
33.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a.,.....	90
34.	Z.F., kundër Bashkisë Sarandë.....	93
35.	Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” kundër Bashkisë Durrës	95
36.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Durrës dhe Operatorëve që ofrojnë shërbimin e transportit publik, Durrës.....	98
37.	F.S., dhe F.E., Bashkisë Vlorë dhe Shoqërisë së Transportit Qytetas “Urban Trans Vlora” sh.p.k.,.....	100
38.	S.L., kundër Bashkisë Tiranë.....	102
39.	D.N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë	104
40.	Shoqata “Shpresë për të verbërit”, kundër Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë “Shpresa-AI” sh.p.k.,	107

41.	B.S., kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë.....	109
IX.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË VENDBANIMIT	112
42.	Qendra “Konsumatori Shqiptar” në bashkëpunim me Qendrën “Durrës Aktiv” kundër Bashkisë Durrës	112
X.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS.....	114
43.	Çështje kryesisht “Mbi vendosjen e kriterit të moshës “jo më shumë se 30 vjeç”, për pranimin në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë e Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë.”	114
X.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR “ÇDO SHKAK TJETËR”.....	119
44.	L.B., dhe A.N., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe M.I., Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, pranë QSUNT	119
45.	A.M., kundër Shkollës së Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër.....	123
46.	S.S., kundër shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier	126
47.	I. A., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUNT)	129
48.	Y.S., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.,	133
49.	T.B., kundër Qendrës Shëndetësore Gramsh dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	135
50.	Gj.V., kundër Shoqërisë RT Minerals sh.p.k.,	138
XI.	ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMEN E SHUMEFISHTË DHE NDËRSEKTORIALE.....	141
51.	Shoqata “Together for Life” kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	141
52.	S.R., dhe P.R., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	145
53.	G.Zh., kundër Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë	148
54.	V.K., kundër Ministrisë së Brendshme dhe ALEAT sh.p.k.,.....	150
55.	M.Z., kundër Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.....	153
56.	M.L., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave	156

Parathënie

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një organ publik i pavarur, i cili ka për funksion garantimin e zbatueshmërisë së Ligjit nr.10221 datë 04/02/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Një ndër kompetencat më të rëndësishme që ky institucion ka, është ai i trajtimit të ankesave që mbërrijnë nga individë, grupe individësh dhe organizata të shoqërisë civile me qëllim konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e sjelljes diskriminuese të konstatuar.

Komisioneri mund të ngrejë edhe çështje kryesisht ose *ex officio*, si dhe ka të drejtë të vendosë sanksione administrative kundrejt subjekteve që nuk zbatojnë vendimet që kanë konstatuar diskriminim.

Qëllimi i kësaj përmbledhje vendimesh të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është që ti shërbejë publikut të gjerë për ta informuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni, por sidomos edhe për ta udhëzuar atë mbi shkaqet, format dhe fushat e diskriminimit me qëllim për një kuptueshmëri më të mirë të tyre.

Përmbledhjet e vendimeve janë hartuar në mënyrë të tillë që ta japin aspektet më thelbësore të vendimit, por sigurisht për një hulumtim më të thellë do të nevojitej konsultimi i tyre në tërësi. Gjithashtu, funksioni i përmbledhjes së vendimeve ka për qëllim edhe të lehtësojë gjetjen e tyre sipas interesit të subjekteve, në faqen *web* të institucionit ku publikohen të gjitha vendimet.

Së fundmi, qëllim specifik është ai i nxitjes së operatorëve të së drejtës, juristë, avokatë, gjyqtarë, lektorë, studiues, studentë, punonjës administrate që të konsultojnë këto vendime për njohjen e praktikës së maturuar prej 10 vjetësh nga institucioni por, edhe për të shprehur sensin e tyre kritik mbi kuptimin dhe arsyeshmërinë e vendimarrjes, si dhe të nxitjes së debatit juridik, social dhe politik mbi të drejtat e njeriut e më specifikisht të parimit të barazisë dhe atij të mosdiskriminimit. Uroj që kjo përmbledhje të shërbejë për qëllimin e saj dhe të jetë një mjet i dobishëm për çdokënd të interesuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

PhD Robert Gajda

I. ÇËSHITJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS¹

1. Grup personash kundër Policisë Bashkiake Tiranë

VENDIM NR. 34, DATË 23.02.2021

Shkaku: Raca dhe Gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesit, anëtarë të komunitetit rom janë diskriminuar për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike nga Bashkia Tiranë.

FAKTET

Grupi i ankuesve i përkasin komunitetit rom, që jetojnë në Yzberisht. Ata janë të papunë dhe fitojnë jetesën duke mbledhur materiale të riciklueshme. Në datën 15 qershor 2020, në Bulevardin e Ri të Kasharit, Policia Bashkiake ndërmori një aksion për sekuestrimin e materialeve të riciklueshme, që ata kishin mbledhur për t'i shitur. Materialet e riciklueshme u sekuestruan pa asnjë procesverbal, si dhe veç tyre Policia Bashkiake u bllokoi edhe karrocet dhe biçikletat, me anë të së cilave, ata transportonin thasët me materialet e riciklueshme.

Grupi i personave që përbëhet nga: L.Z., D.A., I.Sh., F.Sh., V.Sh., R.Sh., S.Sh. dhe M.H., i përkasin komunitetit rom, janë të papunë dhe sigurojnë jetesën duke mbledhur mbetje të riciklueshme në kontenierët e vendosur nga Bashkia Tiranë. Shumica e ankuesve janë të regjistruar si punëkërkues të papunë pranë Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;

¹ Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI (2003) 8, adopted 13 December 2002, par 1(b).

- Rregullorja e Bashkisë Tiranë “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”;
- Ligji Nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” (i ndryshuar);
- Plani i Përbashkët “Për parandalimin e ndotjes së mjedisit, identifikimin dhe goditjen e aktivitetit të paligjshëm, të ushtruar nga individë apo subjekte private, në fushën e mbledhjes, përpunimit të materialeve të riciklueshme, në territorin e Bashkisë Tiranë”, i Bashkisë Tiranë, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Drejtorisë Rajonale të Hetimit Tatimor Tiranë, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Tiranë dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, nënshkruar më datë 31.01.2017;
- Vendimi Nr. 156, datë 21.12.2018, të Këshillit Bashkiak Tiranë “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”.

KONKLUZIONE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka theksuar vazhdimisht se mbrojtja e shtresave në nevojë dhe gëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim duhet të jetë një ndër elementët kryesor i cili duhet të mbahet në konsideratë nga ana e institucioneve të cilët kanë rol të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës apo integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

Komuniteti rom dhe egjiptian në Shqipëri përballet vazhdimisht me situata shumë të vështira për sa i përket çështjes së punësimit, çështje kjo e ngritur dhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit 2019, në të cilin evidentohet se: “Pjesëmarrja e përgjithshme e punësimit dhe fuqisë punëtore tek komuniteti Rom mbeten shumë e ulët (mbi 56% e romëve në moshë pune janë të papunë). Punësimi informal midis romëve përbën 62% të të punësuarve të komunitetit rom²”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi thekson faktin se Bashkia Tiranë dhe Policia Bashkiake Tiranë, gjatë zbatimit të detyrave dhe kompetencave të tyre, duhet të merrnin në konsideratë gjendjen social-ekonomike të shtresave në nevojë, të cilat janë të detyruara që për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, të përdorin mbledhjen e mbetjeve urbane për të siguruar mjetet e jetesës. Institucioni i Bashkisë Tiranë nuk provoi para Komisionerit se ka bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate, në mënyrë që grumbulluesit e mbetjeve të riciklueshme të formalizoheshin dhe të mos rrezikonin shëndetin për të siguruar mjetet e tyre të jetesës.

Mbështetur në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, rekomandimet e dhëna nga përfaqësues të partnerëve dhe institucioneve ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe referuar të dhënave të grumbulluara nga monitorimet në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, është konstatuar se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja. Romët që arrijnë të gjejnë punë

² Progres Raporti 2019, fq. 31, përkthim i Komisionerit.

merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme. Pra, niveli i varfërisë dhe kushtet ekonomike të minoritetit rom dhe atij egjiptian, janë fakte të njohura dhe publike tashmë.

Në analizë të informacionit dhe dokumentacionit të administruar, rezulton se pjesa më e madhe e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme janë kryesisht anëtarë të komunitetit rom dhe atij egjiptian. Në këtë kuptim, mungesa e akteve ligjore apo një procedure standarde për konstatimin, bllokimin, shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve, si dhe veprimet e ndërmarrë nga ana e Policisë Bashkiake Tiranë, bëjnë që anëtarët e këtyre dy komuniteteve, si pjesa më e madhe e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme, të përballen në vijimësi me një situatë të pafavorshme si në rastin e subjekteve ankues, për sa i përket të drejtës së tyre për t'u ankuar për veprimet e Policisë Bashkiake.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë ndërmarrë hapa për hartimin e procedurës standarde, duke lënë kështu në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake mënyrën e veprimit rast pas rasti për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane.

Në këtë këndvështrim, mungesa e masave të ndërmarrë nga ana e Bashkisë Tiranë, për rregullimin e kësaj situatë, në mënyrë që grumbulluesit e mbetjeve të riciklueshme të formalizoheshin dhe të mos rrezikonin shëndetin për të siguruar mjetet e tyre të jetesës, i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situatë për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Tiranë përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përmbushin detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Bashkia Tiranë ka lënë në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake, për të vepruar rast pas rasti, për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane. Fakti që nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk është parashikuar një procedurë standarde se si veprohet në këto raste, lë hapsira që të veprohet në mënyrë arbitrare dhe i mohon qytetarëve të drejtën për të ankimuar procedurat e punonjësve të Policisë Bashkiake. Pra, subjektet ankues janë vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të racës dhe gjendjes së tyre ekonomike, në formën e diskriminimit të tërthortë. Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Nuk ekziston një procedurë standarde ligjore për konstatimin, bllokimin dhe shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve të riciklueshme, me anë të së cilës Policia Bashkiake Tiranë të veprojë për të ushtruar funksionet e saj;
- Nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë ndërmarrë hapa për hartimin e procedurës standarde, duke lënë kështu në tagrin e punonjësve të Policisë Bashkiake mënyrën e veprimit rast pas rasti për bllokimin e mjeteve dhe mbetjeve urbane;
- Mungesa e një procedure standarde, ka përballur pikërisht anëtarët e komunitetit rom dhe atij egjiptian me situatë të pafavorshme si në rastin konkret;
- Bashkia Tiranë nuk provoi se kishte ndërmarrë hapa konkrete në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, sa i përket formalizimit të grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme, duke i mohuar kështu edhe mundësinë për të siguruar mjetet minimale të jetesës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të grupit të ankuesve L.Z., D.A., I.Sh., F.Sh., V.Sh., R.Sh., S.Sh. dhe M.H., për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë dhe Policisë Bashkiake Tiranë.
- Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë, për hartimin e një procedure standarde, lidhur me konstatimin dhe bllokimin e mjeteve të transportit dhe mbetjeve të riciklueshme.

2. Qendra “T’REJA” kundër S.N.

VENDIM NR. 58, DATË 12.04.2021

Shkaku: Raca
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Në emisionin “Shqipëria Live” të datës 14.12.2020 të transmetuar në televizionin Top Channel, S.N. ka mbajtur një qëndrim diskriminues kundër komunitetit Rom.

FAKTET

Në emisionin “Shqipëria Live” të datës 14.12.2020, të transmetuar në televizionin Top Channel, S.N., është shprehur si vijon: “... njësoj si të korruptuarit që kanë paguar fëmijët, shumica Romë, për të sjellë shkatërrimin e Shqipërisë ...” dhe “... mendoni se kanë ardhur vetë fëmijët atje, shumica Romë, të gjithë të paguar, turp i madh ...”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Rekomandimi i Përgjithshëm të Politikave Nr. 15 të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për “Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerësoi se, etiketimi i fëmijëve të komunitetit Rom si të paguar dhe shkatërrues të pronës, në mediat vizive kombëtare, nuk ndihmon grupet e pamundura dhe të marginalizuara të shoqërisë që të krijojnë një perceptim pozitiv në shoqëri, përkundrazi mund të ndikojë në mbajtjen e qëndrimeve negative dhe agresive ndaj këtij komuniteti, nga ana e publikut në përgjithësi dhe atij më pak të informuar në veçanti. Përdorimi i deklarimeve të tilla, përmban një kuptim negativ dhe denigrues kundrejt komunitetit rom, duke shfaqur doza diskriminimi dhe përforcon stereotipet e krijuara ndaj pakicës romë dhe i vendos ata në pozita të pafavorshme e përçmuese në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

Komisioneri vlerësoi se gjuha e përdorur nga S.N., për shkak të racës, reflekton dukshëm një qëndrim të qëllimtë diskriminues në mënyrë të tillë që cenon rëndë parimin e mosdiskriminimit, në zbatim të Ligjit Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe etiketime të tilla ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera përmes fyerjes apo stigmatizimit janë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.

Rëndësia që merr liria e fjalës për një person publik sjell një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mostolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet televizionit kombëtar përbën një mjet të fuqishëm të përhapjes së informacionit dhe të ndikimit të publikut. Komisioneri sjell në vëmendje se, nga ana e politikanëve dhe personave publik duhet të bëhet dallimi midis diskutimit politik dhe diskutimit të çështjeve të tjera të interesit publik, duke mos veçuar grupe të marginalizuara të shoqërisë sonë.

Komisioneri vlerësoi se pavarësisht faktit nëse diskutimi i bërë në emision, nga ana e S.N., nuk mund të ketë patur qëllim të drejtpërdrejtë nxitjen e urrejtjes (në formën e denigrimit) apo diskriminimin e komunitetit rom, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e gjuhës së urrejtjes, anëtarët e këtij komuniteti, pasi përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, duke fyer kështu komunitetin rom dhe duke mos lejuar perceptimin e tyre shoqëror si anëtar me të drejta të barabarta në shoqërinë shqiptare.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit Rom nga ana e S.N., për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes.
- Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, S.N., të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë, e cila paragjykon haptazi dhe prek dinjitetin e personave të komunitetit rom.

3. R.H., kundër Bankës Credins

VENDIM NR. 100, DATË 08.06.2021

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Banka Credins ka kundërshtuar vendimin në gjykatë, ndërsa SHPSF “Eagle Security” ka zbatuar vendimin.

Ankuesi është diskriminuar për shkak të racës, nga ana e Bankës Credins dhe SHPSF “Eagle Security” në ofrimin e shërbimeve.

FAKTET

Ankuesi është paraqitur pranë Degës Tirana 3 të Bankës Credins, për të kryer disa veprime bankare. Pasi ka pritur në radhë, personi i sigurisë e ka lejuar për të hyrë në bankë. Përpara tij në radhë kanë qenë tre klientë femra, të cilat kanë pasur çanta të përmasave të mëdha dhe personi i sigurisë nuk ka bërë asnjë bisedë me to, por i ka lënë të hynin në bankë. Sapo i ka ardhur radha, personi i sigurisë i ka kërkuar që të linte çantën në tokë. Duke qenë se në çantë kishte dokumente personale të rëndësishëm, ankuesi i ka kërkuar punonjësit që ta merrte çantën me vete. Punonjësi i sigurisë me një mënyrë komunikimi shumë të vrazhdë i ka thënë “Mos na çaj b... shumë por lër çantën aty dhe futu brenda se të nxora jashtë për leckash”. Pasi ankuesi kishte lënë çantën në tokë, kishte marrë dokumentet dhe portofolin për të marrë shërbimin në sportel, punonjësi i sigurisë e kishte tërhequr nga xhupi dhe i ka bërë titur duke e ka sharë “gabel i drejt, dil jashtë, mos na çaj b... shumë se ta futa me këtë (aparatin që mat sigurinë e çantave)”. Në këtë moment një punonjës i bankës ka hyrë në mes dhe e ka larguar, ndërsa punonjësi i sigurisë ka vazhduar ta ofendojë. Ankuesi është ankuar dhe pranë bankës, për veprimet dhe sjelljen raciste të punonjësit të sigurisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolle 12;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”;
- Vendimi Nr. 67, datë 01.06.2016 i Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e Rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”.

KONKLUSIONE

Në vlerësim të pamjeve video të vëna në dispozicion nga banka, rezulton që, punonjësi i sigurisë A.M., ka kërkuar kontrollin e çantës me metaldetektor vetëm për ankuesin dhe për asnjë klient tjetër. Nga këqyrja e pamjeve, kemi evidentuar se punonjësi i sigurisë A.M., ka lejuar të hyjnë në mjediset e bankës, të paktën tre kliente me çanta pa i kontrolluar me metaldetektor siç është përcaktuar në kontratë, si dhe ka lejuar dhe një klient mashkull të hyjë në mjediset e brendshme të bankës me gjithë çantë, pa e kontrolluar me metaldetektor. Gjithashtu, nga vlerësimi i pamjeve video, shikohet se punonjësi i sigurisë ka debatuar me ankuesin dhe ka tentuar dhe të ushtrojë forcë ndaj tij, në momentin kur e ka tërhequr nga krahu dhe nëse nuk do të ishte ndërhyrja nga punonjësi i sigurisë së brendshme të bankës, konflikti mes klientit dhe punonjësit të sigurisë A.M., mund të ishte përkeqësuar dhe më tepër.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë ta pabarabartë krahasuar me klientët e tjerë të bankës, lidhur me zbatimin e procedurës të hyrjes së klientëve në bankë, nga ana e punonjësit të sigurisë A.M.

Komisioneri arriti në konkluzionin se Banka Credins dhe SHPSF “Eagle Security”, duke mos analizuar dhe mos vlerësuar situatën e pretenduar nga ankuesi dhe duke marrë në mbrojtje sjelljen e pabarabartë të punonjësit të sigurisë A.M., e kanë vendosur ankuesin në kushte të pafavorshme. Komisioneri krijoi bindjen se R.H., është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme nga ana e Bankës Credins dhe SHPSF “Eagle Security”. Duke i’u referuar faktit se, ankuesi është anëtar i komunitetit rom, prezumimit se punonjësi i sigurisë për shkak të paraqitjes së jashtme të ankuesit, e ka identifikuar si anëtar i komunitetit rom dhe faktit që Banka Credins dhe SHPSF “Eagle Security” nuk arritën të justifikojnë objektivisht veprimet diskriminuese të prezumuara, për këtë arsye, krijohet bindja se veprimet e pafavorshme të Bankës Credins dhe SHPSF “Eagle Security” kanë qenë për shkak të racës së ankuesit.

Komisioneri arriti në përfundimin se shtetasi R.H., është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e Bankës Credins dhe SHPSF “Eagle Security”, trajtim i cili ka ardhur për shkak të racës së ankuesit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit R.H., për shkak të racës, nga ana e Bankës Credins dhe SHPSF “Eagle Security”.
- Në referim të pikës 1 të këtij Vendimi, Banka Credins dhe SHPSF “Eagle Security”, të dalin me një deklaratë publike verbale apo të shkruar me anë të së cilës distancohen nga veprimet diskriminuese që prek dinjitetin e personave të komunitetit rom.

II. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË IDENTITETIT GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL

4. Çështje kryesisht “Në lidhje me deklaratat e A.P., mbi komunitetin LGBTI, të bëra në emisionin “Zonë e Lirë”, të datës 18.06.2021, në TV Klan dhe emisionin “Ndryshe”, të datës 22.06.2021, në Top Albania Radio.”

VENDIM NR. 217, DATË 15.11.2021

Shkaku: Orientimi seksual, identiteti gjinor, karakteristikat e seksit.
Forma: Gjuhë urrejtje
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Personat që i përkasin komunitetit LGBTI, janë diskriminuar si pasojë e gjuhës së urrejtjes të përdorur nga A.P.

FAKTET

A.P., është përfaqësues dhe drejtues i Kishës Ungjilli i Krishtit. A.P., ka qenë i ftuar dhe ka marrë pjesë në emisionin “Zonë e Lirë”, transmetuar në datën 18.06.2021, në TV Klan dhe në datën 22.06.2021 ka marrë pjesë si i ftuar në emisionin radiofonik “Ndryshe”, i cili transmetohet në Top Albania Radio. Gjatë transmetimit të emisionit “Zonë e Lirë”, të datës 18.06.2021, në TV Klan, rezultoi se, një nga temat e diskutuara dhe ku ka qenë i ftuar A.P., lidhej me shpalljen nongrata të personave homofobë. Gjatë diskutimit të zhvilluar në këtë emision, rezultoi se, ndër të tjera, A.P., është shprehur se: “... të jesh gej është gej, është devijancë, është të dalësh nga rruga ... Nuk ka akt më të shëmtuar dhe nuk ka akt më skandaloz se sa të kërkohet dehumanizimi i qenieve njerëzore, duke i vendosur një numër. E dini se çfarë më kujton kjo ideja e heqjes së fjalës nënë dhe fjalës baba, por vendosja e një numri, prindi 1 dhe prindi 2? ... Kampet e përqendrimit të Hitlerit, një numër social që z. Ilirjani e njeh fare mirë në SHBA, numrat e të burgosurve ...”. Më tej gjatë zhvillimit të diskutimeve, A.P., ka vazhduar fjalën tij, duke u shprehur se: “... Nuk ka çnderim më të madh se sa të heqësh nocionin nënë dhe t’i vendosësh një numër. Pastaj dhe me hapjen e kërkesës të të drejtës tjetër që këta duan të fitojnë, dhe e drejta tjetër është adoptimi i fëmijëve. Dhe hyjmë tek një akt skandaloz kriminal. I heq të drejtën një fëmije të vogël për të patur një nënë dhe një baba, duke i mundësuar atij të jetojë me dy burra ose me dy gra ... Imagjinoni ato foshnje të vogla të cilave do t’ju hiqet e drejta përmes adoptimit dhe duke u adoptuar nga çifte homoseksuale që mund të jenë dy burra, hiqet e drejta për të patur një nënë. Shiko sa i skajshëm është ky egoizëm etik që e quan Aristoteli. Pra, dashuria e këtyre individëve për veten e tyre, bën që të shkelin nënën, babain dhe që të shkelin të drejtat e tyre njerëzore të mbrojtura nga karta e të drejtave njerëzore mbi fëmijët ...”.

Gjatë transmetimit të emisionit “Ndryshe”, të datës 22.06.2021, në Top Albania Radio, rezulton se A.P., ka qenë i ftuar dhe ka diskutuar, ndër të tjera, për komunitetin LGBTI. Gjatë transmetimit të këtij emisioni, rezulton se, midis të tjerave, A.P., është shprehur: “ ... të jesh gej është bërë trend ... zëvendësimi nga nëna me prindi 1 dhe nga babai me prindin 2, së pari kemi të bëjmë me një dekonstrukcion të nocioneve dhe vlerave. ... Në këtë moment nëse ne themi do të pranohet në Shqipëri ndryshimi i këtyre nocioneve kaq të rëndësishme për njerëzit, atëherë kjo do t'i hapi rrugën edhe vijimin e kërkesave të tjera të komunitetit LGBTIQ që lidhen me martesën gej, adoptimin e fëmijëve, pastaj unë besoj që kemi të bëjmë edhe me akte kriminale. Kështu i shikoj unë. Akte që lidhen me idenë e mohimit të së drejtës natyrore të një fëmije që të ketë një nënë dhe një baba. Pra një fëmijë do të rritet nga 2 baballarë, duke i'u hequr e drejta për të patur një nënë, apo të rritet nga 2 gra, duke i'u hequr e drejta për të patur një baba ...”. Në vijim të diskutimeve gjatë këtij emisioni, A.P., shprehet: “... pozicioni im është kundër gjuhës së dhunës përkundrejt komunitetit LGBTIQ. Natyrisht që ne i duam këta njerëz, por nga ana tjetër duhet të jemi të kujdesshëm që të mos shantazhohemi nga mesazhet që përcillen prej këtij komuniteti. Kam dëgjuar që disa figura publike do i padisin në Amerikë për homofobi prej opinionit të tyre. Unë i bie me deklarat e mia të jem homofobi i parë shqiptar ...”, duke vijuar me tej: “... Me legalizimin e martesave hiqet steka morale. Që do të thotë që çdo njeri mund të vijë dhe të kërkojë martesën dhe me një kafshë, mund të kërkojë edhe martesën treshe, katërshe ... Nuk ka më kufi ...”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrëjtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave);
- Rekomandimi CM/Rek (2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave);
- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrëjtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 22, Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993.

KONKLUSIONE

Liria e shprehjes dhe liria për të shprehur/manifestuar fenë dhe besimin, janë subjekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj. Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive që ka liria e shprehjes si dhe liria e fesë dhe besimit në raport, me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave pavarësisht orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit.

Kufizimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit, është një kërkesë e imponuar nga parashikimi që bëhet në Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili sanksionon se gjuha e urrejtjes përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit dhe se çdo formë e shprehjes e ushtruar në kundërshtim me këtë ligj është e ndaluar. Kufizimi i i lirisë së shprehjes dhe lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit, kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, që në rastin konkret është siguri i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi i personave për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, shkaqe këto që garantojnë kuadrin mbrojtjes të komunitetit të personave LGBTI. Në këtë mënyrë, përmbushen dy kushtet mbi bazën e të cilave mund të kufizohen si e drejta e shprehjes, ashtu edhe ajo e fesë dhe besimit, kufizimi është vendosur bazuar në Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar dhe për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në rastin konkret për mbrojtjen nga diskriminimi të personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

Komisioneri në çështjen në fjalë ka vlerësuar gjuhën e përdorur nga A.P., gjatë shprehjes së mendimeve, opinioneve apo qëndrimit, qoftë edhe në kuadër të lirisë së ndërgjegjes, fesë dhe besimit të tij, në kuadër të debatit të zhvilluar. Liria e pasjes së mendimeve ose opinioneve dhe liria e ndërgjegjes fesë dhe besimit, janë të drejta të cilat nuk mund të kufizohen, ndërsa mënyra e shprehjes ose manifestimi i tyre, është objekt i kufizimeve sipas përcaktimeve të mësipërme.

Duke i'u referuar përmbajtjes së diskutimeve, gjuhës dhe fjalëve të përdorura nga A.P., rezulton se personat LGBTI portretizohen si persona të cilët janë një kërcënim për traditën apo vlerat shoqërisë. Këta persona, konsiderohen si persona që çënojnë familjen tradicionale, që kërkesat e tyre janë antivlera pasi synojnë mungesë respekti ndaj prindërve duke propozuar heqjen e fjalëve “mami” dhe “babi”. Ai përdor fjalën “*devijancë*” për faktin e të qenit gej. Deklarata e A.P., se ai është kundër gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, nuk gjen asnjë mbështetje në gjuhën e përdorur gjatë diskutimeve të tij në këto emisione. Personat LGBT gjithashtu portretizohen si persona të cilët me kërkesat e tyre çënojnë interesat dhe të drejtat e fëmijëve, duke vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë të këtyre kërkesave dhe cilësimit të tyre si “akte kriminale”. Në këtë mënyrë personat LGBTI portretizohen si persona të cilët paraqesin rrezik për këtë kategori të veçantë, siç janë fëmijët, që gëzojnë një mbrojtje të posaçme, duke shprehur një gjë të pavërtetë, se kërkesa e tyre përbën “akt kriminal”. Cilësimi i kërkesave të komunitetit LGBTI si “akte kriminale”, ndërkohë që një gjë e tillë është e pabazuar, bën që personat e këtij komuniteti të perceptohen nga publiku si “kriminelë” për sa kohë që kërkesat e tyre konsiderohet si “akt kriminal”. Sipas subjektit pretendimet e personave LGBTI duhet të shikohen si kundra moralit të shoqërisë duke u shprehur “*Me legalizimin e martesave hiqet steka morale.*” apo duke bërë një lidhje dhe krahasime me fenomene apo sjellje të cilat nuk janë të lejuara në shoqërinë tonë si poligamia apo martesa me kafshë duke u shprehur: “*Që do të thotë që çdo njeri mund të vijë dhe të kërkojë martesën dhe me një kafshë, mund të kërkojë edhe martesën treshë, katërshe ... Nuk ka më kufi*”.

Komisioneri konstaton se, nuk rezulton asnjë lidhje midis termave, dukurive apo sjellje si “zoofilia” apo “parafilia” dhe homoseksualitetit. Gjithashtu, nuk rezulton që të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë midis vendeve që kanë legalizuar martesat midis personave të të njëjtës gjini, apo që njohin bashkëjetesën e çifteve homoseksuale ose birësimin e fëmijëve nga persona që i përkasin komunitetit LGBTI dhe legjitimitet të zoofilisë ose martesës me kafshë. Nuk rezulton ndonjë lidhje midis poligamisë dhe vendeve të cilat kanë njohur martesat ose partneritetet midis personave të të njëjtit seks. Përkundrazi, rezulton se, midis vendeve të cilat ndalojnë martesat ose parteritetet e personave të të njëjtit seks, janë më tepër ato vende në të cilat poligamia është e lejuar, siç janë Afganistani, Pakistani, Irani, Emiratet e Bashkuara Arabe, Algjeria etj.

Debati dhe diskutimi për çështje të ndryshme është i nevojshëm veçanërisht për tema apo çështje sensitive, që janë në interes të opinionit të gjerë. Diskutime mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjykimeve dhe stigmatizimin e personave për shkak të orientimit seksual identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë personat LGBT si kërcënim për shoqërinë apo duke i cilësuar si akte kriminale kërkesat e tyre, stimulojnë frikën, nxisin qëndrime negative, nxisin diskriminimin dhe për këtë arsye ato janë në kundërshtim me ligjin. Gjuha e përdorur nga A.P., stigmatizon personat e komunitetit LGBTI duke i etiketuar ata në një mënyrë negative dhe me attribute të pavërteta.

Gjuha e përdorur nga A.P., është përcjellë në një kontekst kur debati i lindur si pasojë e diskutimit të propozimit në lidhje me opsionin e përdorimit të termave “prindi 1” dhe “prindi 2” për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të çifteve që i përkasin komunitetit LGBTI, ka shkaktuar tensione në shoqëri. Si pasojë e këtij debati, nga aktivistë të komunitetit LGBTI janë raportuar

kërcënime të shumta në rrjetet sociale dhe se një anëtar i këtij komuniteti është dhunuar fizikisht. Gjuha e përdorur dhe e shpërndarë në një mjedis shoqëror ku homofobia dhe transfobia janë të theksuara dhe paraqesin një fenomen shqetësues, shton mundësinë që të nxiten akte frikësimi, armiqësimi apo diskriminimi ndaj personave LGBTI që drejtohen në rastin konkret.

Duke qenë një përfaqësues dhe udhëheqës fetar, A.P., ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. A.P., është një person aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij, A.P., mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së fesë dhe besimit. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet, qofshin këto edhe të bazuara në fenë apo besimin të cilit ai i përket. Në mënyrë të përsëritur në të dy emisionet A.P., ka përdorur të njëjtën gjuhë duke etiketuar personat LGBTI në një mënyrë negative, pasi me kërkesat e tyre ata janë kërcënim për shoqërinë apo duke i etiketuar se me kërkesat e tyre janë duke konsumuar akte kriminale, si dhe duke i krahasuar në mënyrë të pavërtetë me zoofilinë apo poligaminë, të cilat në asnjë rast nuk rezultojnë të lidhura. Institucionet fetare gëzojnë autonomi në administrimin e çështjeve të tyre dhe mund të kenë opinione të ndryshme në lidhje me çështjet e orientimit seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit, por në asnjë rrethanë ato nuk duhet të nxisin dhunë apo urrejtje. Në këtë kontekst, shprehja e lirisë së fesë dhe besimit e dikujt nuk mund të çënojë të tjerët për të patur një jetë të lirë nga urrejtja dhe diskriminimi.

Komisioneri mban parasysh edhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat. Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet medias audiovizive dhe radiofonike është shumë më e fuqishme dhe arrin tek një publik shumë i gjerë. Të dy emisionet nëpërmjet të cilave është shprehur gjuha e urrejtjes janë media që kanë një shtrirje kombëtare.

Komisioneri vlerëson se, gjuha e përdorur nga krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBT. Edhe pse deklaratat e bëra nga A.P., nuk drejtohen kundër individëve të caktuar, anëtarët e komunitetit LGBTI, portretizohen dhe etiketohen si modele negative vetëm për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit. Këto deklaratat edhe pse nuk janë një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohen si deklaratat që nxisin urrejtje. Personat e komunitetit LGBTI kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë subjekte të homofobisë, transfobisë dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se për shkak të vulnerabilitetit të këtij grupimi është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndaluar çdo përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, gjuha e përdorur nga A.P., përbën gjuhë urrejtje kundër personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura nga A.P., janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe

lirisë së shprehjes së fesë dhe besimit. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerësoi se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, si pasojë e gjuhës së përdorur nga A.P., në emisionin Zonë e Lirë, transmetuar në datë 18.06.2021 në TV Klan dhe emisionin “Ndryshe” transmetuar në datën 22.06.2021 në Top Albania Radio.
- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, A.P., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.

5. Çeshtje kryesisht kundër “Green Taxi”

VENDIM NR. 125, DATË 05.07.2021

Shkaku: Orientimi seksual dhe identiteti gjinor
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Shoqëria “Green Taxi” ka refuzuar t’u ofrojë shërbimin taksi disa personave transgjitorë në Tiranë duke i diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
--

FAKTET

Referuar versionit të ngjarjes së ndodhur në datën 26.03.2021, të parashtruar nga ana e përfaqësuesve të shoqatës Aleanca LGBTI, si dhe mbështetur në audion e bisedës së regjistruar me operatoren e shoqërisë “Green Taxi”, rezulton se kjo e fundit është shprehur se shoferët nuk pranojnë t’i ofrojnë shërbimin taksi, personave transgjitorë (travestitë). Pretendimi i shoqatës Aleanca LGBTI konsiston në refuzimin e një shërbimi publik ndaj personave transgjitorë, duke vënë në dukje faktin se shërbimi është refuzuar në kërkesën e tyre, të dytë. Përfaqësuesja e shoqërisë “Green Taxi”, në seancën dëgjimore, të datës 24.06.2021, ka parashtruar një version tjetër të ngjarjes së ndodhur, duke sqaruar se ndërmjet shoferit dhe individit transgjitor ka patur një konflikt verbal, i cili është iniciuar nga klienti e është vijuar nga taksisti i punësuar nga shoqëria “Green Taxi”. Në këtë kontekst, Green Taxi është shprehur se ka ndërmarrë masa disiplinore ndaj

personave përgjegjës, masa këto që nuk janë depozituar asnjëherë në cilësi prove pranë KMD-së. Njëkohësisht, Komisioneri ka konstatuar se Green Taxi nuk e ka vërtetuar në asnjë rast versionin e saj të ngjarjes me fakte dhe prova konkrete, sikurse është vepruar nga ana e shoqatës Aleanca LGBTI, e cila në cilësinë e informacionit të besueshëm, të dërguar në adresë të KMD-së, ka përcjellë linkun, ku ndodhet e publikuar biseda e regjistruar me operatoren e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër, shoqëria “Green Taxi” ka theksuar faktin se qëndrimi i këtyre punonjësve nuk është qëndrimi zyrtar i shoqërisë, si dhe ka kërkuar falje publike në www.dylbersizem.com dhe në www.historiaime.al, lidhur me sa ka ndodhur. Në pretendimet e saj, Shoqëria Green Taxi ka theksuar faktin se shërbimi i saj publik ofrohet ndaj të gjithë klientëve, pa asnjë dallim, ndërkohë që përmbajtja e bisedës së regjistruar me operatoren e kësaj shoqërie vërteton të kundërtën. Sikurse rezulton edhe nga provat e administruara, taksistët e shoqërisë refuzonin t’u ofronin shërbim individëve transgjnorë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14 si dhe Protokollin 12 i saj.);
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Rekomandimi CM / Rec (2010) 5, i Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Europës, “Për vendet anëtare mbi masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor”.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka konstatuar se Green Taxi nuk e ka vërtetuar në asnjë rast versionin e saj të ngjarjes me fakte dhe prova konkrete, sikurse është vepruar nga ana e shoqatës Aleanca LGBTI, e cila në cilësinë e informacionit të besueshëm, të dërguar në adresë të KMD-së, ka përcjellë linkun, ku ndodhet e publikuar biseda e regjistruar me operatoren e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër, rezulton se diskriminimi dhe intoleranca, që përjetojnë individët transgjnorë janë evidente në fushën e shërbimeve, kujdesit shëndetësor, punësimit etj. Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se nëse klientët nuk do të ishin transgjnorë, shërbimi taksi do t’u ishte ofruar normalisht, pa asnjë hezitim, nga ana e taksistëve të Green Taxi.

Komisioneri gjykon se ngjarja në fjalë konsiston në refuzimin e një shërbimi publik ndaj një personi transgjnor, nga ana e “Green Taxi”.

Komisioneri gjykoi se refuzimi i ofrimit të shërbimit ndaj një personi transgjnor, nënkupton se ky refuzim i adresohet çdo personi që i përket këtij komuniteti. Në këtë mënyrë, shoqëria “Green Taxi” e ka ekspozuar këtë komunitet ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë,

me individët e tjerë, të cilëve ofrohet shërbimi publik taksi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të personave transgjinorë, nga ana e shoqërisë “Green Taxi”.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, brenda 3 (tre) muajve nga marrja dijeni, Shoqëria “Green Taxi” të bashkëpunojë me organizatat që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për trajnimin e punonjësve të saj, lidhur me çështjet e ndalimit të diskriminimit, në fushën e shërbimeve, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Komisioneri kërkon nga ana e Shoqërisë “Green Taxi”, mos përsëritjen e situatave të tilla diskriminuese në të ardhmen.

III. ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

6. M.K., kundër Bashkisë Vorë

VENDIM NR. 47, DATË 17.03.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në proces

Ankuesi M.K., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi M.K., ka qenë punonjës pranë Bashkisë Vorë në pozicionin e punës “*specialist/topograf*”, pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Ai ka punuar pranë kësaj bashkie që prej vitit 2003 me disa shkëputje, dhe që prej datës 01.11.2011, marrëdhëniet e tij të punës kanë vijuar pa shkëputje pranë kësaj bashkie. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës ankuesi ka punuar në pozicione të ndryshme pune dhe nuk rezultoi që ndaj tij të ishin marrë masa disiplinore.

Në datën 18.02.2020, Bashkia Vorë ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurave për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, pa i komunikuar motivacionin. Në datën 24.02.2022 midis ankuesit dhe Bashkisë Vlorë është zhvilluar takimi për të diskutuar në lidhje me ecurinë e marrëdhënies së punës. Gjatë këtij takimi ankuesit i është komunikuar se, arsyet për fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës konsistojnë në faktin se: ankuesi nuk ishte i emëruar në pozicionin që mbante; kishte konflikt interesi me pozicionin që mbante; ndaj tij ishin konstatuar shkelje të Kodit të Etikës, pasi ndaj tij ishin paraqitur tre ankesa nga qytetarët. Ankuesi e ka kundërshtuar arsyen e zgjidhjes së marrëdhënies së punës dhe ka kërkuar nga Bashkia Vorë që ankesat e ardhura nga qytetarët të verifikohen. Në datën 28.02.2020, Kryetari i Bashkisë Vorë ka nxjerrë urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për M.K., me motivacionin shkelje e Kodit të Etikës. Marrëdhëniet financiare midis ankuesit M.K., dhe bashkisë Vorë janë ndërprerë në datën 28.05.2020.

Që prej vitit 2014, M.K., ishte anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky që rezultoi i provuar në bazë të kartës së anëtarësisë, të lëshuar nga Partia Demokratike.

Ankuesi e kundërshtoi arsyen e largimit nga puna duke pretenduar se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai ishte mbështetës dhe anëtar i Partisë Demokratike dhe se bindjet e tij ishin të kundërta me ato titullarit të institucionit, Kryetarit të Bashkisë Vorë, i cili është përfaqësues i Partisë Socialiste (PS).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se M.K., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme në procedurën e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës. Arsyeja e pretenduar për zgjidhjen e kontratës së punës me M.K., nuk rezulton e provuar, për sa kohë që nuk rezulton që të jetë realizuar asnjë verifikim në lidhje me bazueshmërinë dhe vërtetësinë e tyre. Duke patur barrën e provës për të provuar arsyen e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, Bashkia Vorë në cilësinë e punëdhënësit nuk arriti të provojë shkeljen e Kodit të Etikës nga ana e ankuesit, për të legjitimuar në këtë mënyrë faktin se shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me ankuesin ka të bëjë me sjelljen e tij. Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi.

Duke i'u referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike, prezumimit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet e tij politike, dhe faktit që Bashkia Vorë nuk arriti të provojë se zgjidhja e kontratës ka patur një shkak të ligjshëm, *krijohet prezumimi* se veprimet e Bashkisë Vorë kanë qenë të motivuara politikisht. *Bashkia Vorë e cila kishte barrën e provës*, dështoi që të provonte se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm apo që, megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Në këto kushte, Komisioneri arriti në përfundimin se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin ka ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit M.K., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Vorë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Vorë të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

7. E.V., kundër Bashkisë Berat

VENDIM NR. 198, DATË 14.10.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi E.V., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi E.V., ka qenë punonjës pranë Bashkisë Berat dhe ka punuar në pozicionin e punës “*Inspektor i mbrojtjes së territorit*”, në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit. E.V., ka filluar punë pranë Bashkisë Berat që prej datës 24.10.2017. Në fillim të muajit dhjetor 2019 ndaj E.V., ka filluar procedimi penal për veprat penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe “*Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*”. Në kuadër të këtyre procedimeve penale ndaj ankuesit është vendosur fillimisht masa e sigurimit “arrest në burg”, e cila më pas është ndryshuar në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” si dhe me pezullimin nga funksionet publike të ankuesit për një periudhë 3 muajore. Në datën 10.12.2019, Kryetari i Bashkisë Berat ka vendosur pezullimin nga detyra të E.V., për shkak të këtij procedimi penal. Në datën 08.01.2020, gjykata kompetente e ka hequr masën ndaluese “Pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”. Në datën 28.4.2020, gjykata kompetente ka pushuar procedimin penal në ngarkim të ankuesit për veprën penale të “*Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 14.5.2020.

Ankuesi është rithyer në punë me urdhrin e datës 03.08.2020 dhe ka filluar efektivisht punë në datë 04.08.2020. Në datën 07.08.2020 ndaj ankuesit është dhënë pa asnjë komunikim dhe njoftim paraprak masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*”, me motivacionin “*Për shkelje të konstatuara nga inspektimi financiar i Kontrollit të Lartë Shtetit në lidhje me detyrën e tij funksionale për mos arkëtim të penaliteteve, prishje të Planit Urbanistik, nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit*”. Ankuesi e ka kundërshtuar masën disiplinore, por nuk ka marrë përgjigje nga punëdhënësi.

Në datë 18.09.2020, ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurave për zgjidhje të kontratës së punës me motivacionin “*Mosrealizim i detyrave funksionale në mënyrë të përsëritur dhe moszbatim i urdhrave të eprorit*”. Në datë 28.12.2020, Bashkia Berat ka vendosur shkarkimin nga detyra dhe zgjidhjen e kontratës së punës me E.V, me motivacionin “*shkelje të detyrimeve kontraktuale për mosrespektimin e përsëritur të afateve të caktuara për kryerjen e detyrave funksionale*”.

Që prej vitit 2016, E.V., ishte anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), fakt ky që rezultoi i provuar në bazë të kartës së anëtarësisë dhe vërtetimit, të lëshuar nga ky subjekt politik. Ankuesi pretendoi se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai ishte mbështetës dhe anëtar i LSI dhe se bindjet e tij ishin të kundërta me ato titullarit të institucionit, Kryetarit të Bashkisë Berat, i cili ishte përfaqësues i Partisë Socialiste (PS).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolle 12 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi E.V., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme gjatë procesit disiplinor dhe procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, nga ana e Bashkisë Berat. Masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” e marrë ndaj ankuesit është marrë pa bërë asnjë vlerësim të performancës dhe pa i dhënë mundësinë ankuesit që të dëgjohet dhe të mbrohet, në kundërshtim me nenin 37, të Kodit të Punës. Bashkia Berat nuk arriti të provojë, shkeljet e pretenduara, pra, se cilat ishin detyrat funksionale të cilat në mënyrë të përsëritur nuk kishte përmbushur apo cilët ishin urdhrat që i ishin dhënë ankuesit nga ana e eprorit, të cilat ai nuk i kishte zbatuar. Kodi i Punës ngarkon punëdhënësin me detyrimin për të provuar shkeljet e pretenduara se janë konsumuar nga punëmarrësi. Në këtë kuptim, i takonte Bashkisë Berat, e cila dështoi që të provonte se, largimi i ankuesit nga puna është bërë për një shkak të ligjshëm, pra për shkak të shkeljeve të pretenduara.

Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, *Bashkia Berat, e cila kishte barrën e provës* që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një

justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, *dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike*. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Berat, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit E.V., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Berat.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Berat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

8. E.D., kundër Bashkisë Kamëz

VENDIM NR. 15, DATË 29.01.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi E.D., është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, gjatë procesit të rekrutimit për vendin e lirë të punës si nëpunës civil.
--

FAKTET

Ankuesi E.D., ka punuar si “specilist i medias” pranë Bashkia Kamëz. Ai ka filluar punë në këtë pozicion në datë 05.11.2013 dhe ka punuar në të njëjtin pozicion pune deri në datën 26.03.2019, kur është larguar me dëshirën e tij, pra me dorëheqje. Në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (dt. 26.02.2014), E.D., ka qenë i punësuar në pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënies me Publikun dhe Mediat”, për një periudhë më pak se një vit. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz nuk ka nxjerrë aktin për deklarimin e ankuesit si “nëpunës civil në periudhë prove, por, ankuesi ka kryer dhe ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civil të administratës vendore në periudhë prove, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Për ankuesin është kryer vlerësimi i punës si nëpunës civil për periudhën 05.01.2016-31.12.2016, nga ku rezulton se ai është vlerësuar me vlerësimin 1, “shumë mirë”. Ndaj ankuesit nuk është marrë asnjë masë disiplinore gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës.

Në datë 15.05.2020, Bashkia Kamëz ka shpallur njoftimin për vendin e lirë të punës “Përgjegjës i Medias dhe Informimit”, pranë kësaj bashkie, pozicion pune i cili bën pjesë në shërbimin civil. Për këtë procedurë konkurimi kanë paraqitur aplikimet dy konkurrentë, ankuesi E.D., dhe Xh.S. Në përfundim të procedurës për lëvizje paralele, për këtë konkurs nuk ishte paraqitur asnjë kandidat. Më pas, gjatë procedurës së “ngritjes në detyrë” për konkursin në fjalë, Bashkia Kamëz ka vlerësuar se asnjë nga konkurrentët e paraqitur nuk plotësonte kriteret dhe për rrjedhojë është vendosur që konkursi të kalojë në fazën tjetër, atë të procedurës së “panimit në shërbimin civil”. Bashkia Kamëz njoftoi E.D., se pas fazës së parë të verifikimit të dokumentacionit për procedurën e “ngritjes në detyrë” aplikimi i tij ishte skualifikuar për shkak se nuk përmbushte kërkesat e nenit 26, pika 3, germa “b” të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Bashkisë Kamëz ka vazhduar procedurën e konkurimit dhe ka kualifikuar ankuesin dhe aplikantin Xh.S., për procedurën e pranimit në shërbimin civil. Bashkia Kamëz ka publikuar vijimin e procedurës në datën 29.06.2020 në faqen e saj zyrtare, ndërsa zhvillimi i konkursit ishte përcaktuar në datë 01.07.2020. Ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Bashkisë Kamëz për mungesë transparence dhe kohën e shkurtër të vendosur për zhvillimin e konkursit. Bashkia Kamëz i ka kthyer përgjigje duke parashtruar se mosparaqitja e tij në datën dhe orën e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit ishte shkak që ai ishte skualifikuar. Bashkia Kamëz ka vijuar me procedurat e konkurimit dhe në datën 06.07.2020 ka shpallur rezultatet e konkurimit, sipas të cilit rezultoi se, Komiteti i përhershëm i pranimit, në përfundim të procedurës së testimit ka shpallur fitues për pozicionin “përgjegjës i medias” shtetasin Xh.S.

Që prej vitit 2014, E.V., ishte anëtar i Partisë Demokratike (P.D), fakt ky që rezultoi i provuar në bazë të kartës së anëtarësisë të lëshuar nga ky subjekt politik.

Ankuesi pretendoi se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai ishte mbështetës dhe anëtar i PD dhe se bindjet e tij ishin të kundërta me ato titullarit të institucionit, Kryetarit të Bashkisë Kamëz, i cili ishte përfaqësues i Partisë Socialiste (PS).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 12;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 116, datë 05.03.2014 “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, E.D., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, gjatë procesit të rekrutimit për vendin e lirë të punës si nëpunës civil, në pozicionin “Përgjegjës i medias”, të shpallur nga Bashkia Kamëz. Ankuesi ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes, në datën 26.03.2019. Bazuar në pikën 4, të nenit 64, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, brenda dt. 26.03.2021, ankuesi ka patur të drejtë të konkurojë si nëpunës civil, për procedurat e ngritjes në detyrë, sipas nenit 26 të këtij ligji. Për rrjedhojë, s’kualifikimi i ankuesit nga procedura e ngritjes në detyrë rezulton të jetë bërë në mënyrë të padrejtë. S’kualifikimi i ankuesit nga procedura e ngritjes në detyrë ka lejuar dhe ka mundësuar vazhdimin e procedurave për fazën e radhës, atë të pranimit në shërbimin civil, fazë kjo që lejon pranimin e personave nga jashtë shërbimit civil.

Në lidhje me vazhdimin e procedurës së pranimit, për pozicionin ku kishte aplikuar ankuesi, në të cilin njoftohej për kualifikimin e tij dhe caktimin e datës së konkurimit, rezultoi një diferencë dhe mungesë transparence, në raport me njoftimet e tjera të publikuara në një periudhë të përafërt. Kjo diferencë në lidhje me transparencën e treguar, mund të mos cënonte efektivitetin e njoftimit, nëse do të ishte vendosur në dispozicion një afat më i gjatë për zhvillimin e fazës së vlerësimit. Nga ana tjetër, në rast se Bashkia Kamëz do të kishte ndjekur të njëjtin standart për procedurën e kundërshtuar, sikundër ka ndjekur për procedurat e tjera të ngjashme, pretendimet e ankuesit për mungesë transparence apo mungesë të njoftimit efektiv, do të rezultonin të pa mbështetura. Bashkia Kamëz nuk dha asnjë justifikim në lidhje me këtë shmangie nga mënyra e publikimit të njoftimeve në raport me rastet e tjera të ngjashme.

Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, *Bashkia Kamëz, e cila kishte barrën e provës* që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, *dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike*. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Kamëz, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për s’kualifikimin e E.D., nga procedurat e konkurimit për vendin e lirë të punës si nëpunës civil, mbetet shkakun i diskriminimit, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit E.D., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kamëz.

9. S.P., kundër Bashkisë Berat

VENDIM NR. 103, DATË 09.06.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi S.P., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi S.P., ka qenë punonjës pranë Bashkisë Berat dhe ka punuar në pozicionin e punës “specialist finance”, në Drejtorinë e Arsimit. Ankuesi është emëruar në këtë pozicion pune në datë 22.09.2017 dhe ka punuar deri në datën 04.05.2020, kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Në datën 25.02.2020, Bashkia Berat ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së tij të punës. Arsyeja e fillimit të procedurës ishte ristrukturimi i Drejtorisë së Arsimit dhe pakësimi i numrit të punonjësve, bazuar në strukturën e re të Bashkisë Berat, miratuar në datë 21.02.2020. Gjatë takimit të zhvilluar midis ankuesit dhe Bashkisë Berat në datën 30.04.2020, ankuesi ka kundërshtuar arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës duke pretenduar se bashkia ka patur mundësi reale për ta sistemuar në një vend pune të përshtatshëm me arsimin dhe kualifikimet e tij. Në datën 04.05.2020, është vendosur shkarkimi nga detyra dhe zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin me motivacionin “Ristrukturim i strukturës së Drejtorisë së Arsimit dhe shkurtim i pozicionit të punës”.

Rezultoi e provuar se, numri total i punonjësve në Drejtorinë e Arsimit, nuk ishte pakësuar, ndërsa ishte pakësuar numri i punonjësve në sektorin ekonomik, ku është pozicionuar vendi i punës i ankuesit. Pas miratimit të strukturës së re, në datat 19.03.2020 dhe 30.03.2020 Bashkia Berat, ka punësuar pranë Drejtorisë së Arsimit, dy punonjës të rinj në pozicionin specialist për administratën. Arsimi i kërkuar për pozicionin e punës “specialist për administratën”, është arsimi i lartë, pa specifikime në lidhje me profilin e arsimit të lartë të kërkuar. Punonjësi, i cili ishte mbajtur në punë në pozicionin specialist finance, kishte 6 muaj që ishte marrë në punë ndërsa E.D. kishte më shumë

vjetërsi pune në Drejtorinë e Arsimit. Bashkia Berat nuk provoi se punonjësi që ishte mbajtur në punë ishte më i kualifikuar se ankuesi.

Që prej vitit 2016, S.P., është anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe në zgjedhjet për Kuvendin 2017 ai ka qenë anëtar KQV-je, në Qarkun e Beratit, si përfaqësues i LSI.

Ankuesi pretendoi se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai ishte mbështetës dhe anëtar i LSI dhe se bindjet e tij ishin të kundërta me ato titullarit të institucionit, Kryetarit të Bashkisë Berat, i cili ishte përfaqësues i Partisë Socialiste (PS).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 12;
- Karta Sociale Europiane;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme gjatë procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, nga ana e Bashkisë Berat. Nuk rezultoi që Bashkia Berat të ketë kryer përzgjedhjen e punonjësit që do të vazhdonte punën në pozicionin specialist finance, bazuar në kritere të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike për punonjësit e përfshirë. Bashkia Berat, duhet të kishte mbajtur ankuesin në pozicionin specialist finance ose mund ta kishte sistemuar atë në një nga 2 pozicionet e punës specialist për administratën, të cilat rezultojnë të kenë qenë pozicione të lira. Bashkia Berat nuk arriti të japë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm se përse e ka zgjidhur kontratën e punës me ankuesin, në kushtet kur ka patur mundësi reale për të vazhduar marrëdhënien e punës me ankuesin.

Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, *Bashkia Berat, e cila kishte barrën e provës* që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, *dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike*. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e

Bashkisë Berat, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit S.P., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Berat.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Berat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

10. D.H., kundër Bashkisë Berat

VENDIM NR. 121, DATË 30.06.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi D.H., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi D.H., ka filluar punë pranë Bashkisë Berat në datën 01.02.2018 dhe ka punuar në pozicionin e punës “Inspektor i mbrojtjes së territorit”, në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit. D.H. Në fillim të muajit dhjetor 2019 ndaj D.H., ka filluar procedimi penal për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”. Në kuadër të këtyre procedimeve penale ndaj ankuesit është vendosur masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ndërsa gjykata nuk ka pranuar kërkesën e organit të akuzës për pezullimin nga funksionet publike të ankuesit për një periudhë 3 mujore. Si pasojë e fillimit të procedimit penal, ankuesi ishte pezulluar nga detyra. Vendimi i gjykatës për të mos miratuar kërkesën e organit të akuzës për pezullimin nga funksionet publike të ankuesit për një periudhë 3 mujore ka marrë formë të prerë në datën 13.01.2020. Në datën 14.01.2020, ankuesi ka vendosur në dispozicion të Bashkisë Berat, kopje të vendimit të gjykatës dhe ka kërkuar rikthimin

në detyrë. Në datën 28.04.2020, gjykata kompetente ka pushuar procedimin penal në ngarkim të ankuesit për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 14.05.2020. Në datë 08.06.2020, ankuesi ka rikërkuar nga Bashkia Berat rikthimin e tij në detyrë.

Ankuesi është rikthyer në detyrë, në datën 03.08.2020. Në datën 07.08.2020 ndaj ankuesit është dhënë pa asnjë komunikim dhe njoftim paraprak masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*”, me motivacionin “*Për shkelje të konstatuara nga inspektimi financiar i Kontrollit të Lartë Shtetit në lidhje me detyrën e tij funksionale për mos arkëtim të penalteteve, prishje të Planit Urbanistik, nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit*”.

Në datë 08.09.2020, ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurave për zgjidhje të kontratës së punës me motivacionin “*Mosrealizimi i detyrave funksionale në mënyrë të përsëritur dhe moszbatim i urdhrave të eprorit*”. Në datë 16.11.2020, Bashkia Berat, ka vendosur shkarkimin nga detyra dhe zgjidhjen e kontratës së punës me D.H., me motivacionin “*Shkelje të detyrimeve kontraktuale për mosrespektimin e përsëritur të afateve të caktuara për kryerjen e detyrave funksionale*”.

Që prej vitit 2016, D.H., është anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

Ankuesi pretendoi se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai ishte mbështetës dhe anëtar i LSI dhe se bindjet e tij ishin të kundërta me ato titullarit të institucionit, Kryetarit të Bashkisë Berat, i cili ishte përfaqësues i Partisë Socialiste (PS).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 12;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi D.H., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme gjatë procesit disiplinor dhe procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, nga ana e Bashkisë Berat. Masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” është marrë pa bërë asnjë vlerësim të performancës dhe pa i dhënë mundësinë ankuesit që të dëgjohet dhe të mbrohet, në kundërshtim me nenin 37 të Kodit të Punës. Bashkia Berat nuk arriti të provojë, shkeljet e pretenduara, pra, se cilat ishin detyrat funksionale të cilat, në mënyrë të përsëritur, nuk kishte përmbushur apo cilët ishin urdhrat që i ishin dhënë ankuesit nga ana e eprorit,

të cilat ai nuk i kishte zbatuar. Kodi i Punës ngarkon punëdhënësin me detyrimin për të provuar shkeljet e pretenduara se janë konsumuar nga punëmarrësi. Në këtë kuptim, i takonte Bashkisë Berat, e cila dështoi që të provonte se, largimi i ankuesit nga puna është bërë për një shkak të ligjshëm, pra për shkak të shkeljeve të pretenduara.

Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit.

Në kushtet kur, argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, *Bashkia Berat, e cila kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike.* Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Berat, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkakun i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit D.H., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Berat.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Berat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

11. N.S., kundër Ujësjetës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.,

VENDIM NR. 129, DATË 12.07.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja N.S., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.
--

FAKTET

Ankuesja N.S., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Ujësjetës Kanalizime Berat-Kuçovë (UKBK) sh.a. N.S., ka filluar punë pranë UKBK sh.a., në datë 12.02.2018 dhe ka punuar në pozicionin e punës “specialiste prokurimesh”. N.S., ka përfunduar studimet e larta universitare dhe zotëron diplomë Master i Shkencave, në Shkencat Juridike. Që prej vitit 2014, N.S është anëtare e Partisë Demokratike (PD) dhe për periudhën 20.7.2015-24.7.2019 ajo ka qenë anëtare e Këshillit Bashkiak, për subjektin politik PD.

Në datën 06.02.2020, UKBK sh.a., ka njoftuar N.S., për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës, pasi në bazë të vendimit të datës 06.01.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të UKBK sh.a., vendi i punës “specialist prokurimesh” është suprimuar. Në takimin e zhvilluar në datë 06.04.2020, N.S., ka kundërshtuar zgjidhjen e marrëdhënies të punës dhe ka kërkuar informacion në lidhje me suprimimin e vendit të saj të punës pasi nuk ka patur dijeni për ristrukturimin. Në datën 07.04.2020, ankuesja ka paraqitur një kërkesë për t’u sistemuar në një vend të ri pune që ishte hapur me strukturën e re dhe që në atë moment ishte i lirë. Ankuesja nuk ka marrë përgjigje. Në takimin e datës 06.04.2020, N.S., ka parashtruar përpara punëdhënësit pretendimin se zgjidhja e kontratës së punës kishte si bazë bindjet e saj politike dhe faktin se ajo është anëtare e Partisë Demokratike. Pretendimin se zgjidhja e kontratës së punës po bëhej për shkak të bindjeve politike, ankuesja e ka parashtruar edhe në një ankesë të veçantë drejtuar UKBK me datë 06.04.2020. Ankesa për diskriminim e ankueses nuk është shqyrtuar nga ana e UKBK sh.a.

Rezultoi se, numri total i punonjësve për vitin 2020 nuk kishte ndryshuar. Për vitin 2020, krahas suprimimit të vendit të punës të ankueses, shoqëria ka hapur edhe vende të reja pune, sikundër është pozicioni i “Përgjegjës të marrëdhënies me klientin në sektorin fshat” dhe “Përgjegjës i shitjes”. Në pozicionin e punës “Përgjegjës i marrëdhënies me klientin në sektorin fshat” UKBK sh.a., ka emëruar një punonjës të ri në datën 14.01.2020. Pozicioni i punës “Përgjegjës i shitjes” i cili ka qenë i lirë ka patur si kriter formimin ekonomik ose juridik. UKBK sh.a., prapësoi se, ankuesja nuk plotësonte kriterin e arsimit për t’u sistemuar në këtë pozicion pune. Pozicioni i punës “Përgjegjës i shitjes” është mbullur si pozicion pune në datën 15.04.2020, pak ditë pasi ankuesja ka depozituar kërkesën e datës 07.04.2020 për t’u sistemuar në këtë pozicion pune. UKBK sh.a., shprehet se ky pozicion pune është baza e të ardhurave të shoqërisë, por nuk dha shpjegime në lidhje me arsyen që e ka shtyrë që të bëjë mbylljen e këtij vendi pune.

UKBK sh.a., pretendoi se, si rezultat i ngarkesës dhe volumit të punës, Këshilli i Administrimit vlerësoi se, ekzistenca e dy pozicioneve “Këshilltar juridik” dhe “Specialist prokurimesh (vendi i punës i ankueses) në strukturën e shoqërisë nuk ishin e nevojshme dhe për këtë arsye kishte vendosur vendi i punës “Specialist prokurimesh” të suprimohej dhe detyrat e këtij vendi pune do t’i kalonin pozicionit të punës me emërtesën “këshilltar juridik”. Rezultoi se, asnjë nga pozicionet e punës “Këshilltar juridik” dhe “Specialist prokurimesh” nuk figuron në strukturën e 2020, por është krijuar një pozicion i ri me emërtimin “Jurist”. Në këtë vend pune, UKBK sh.a ka sistemuar punonjësen T.P., e cila kishte mbajtur më parë pozicionin e punës “Këshilltare juridike”. Në datën 15.04.2020, ishte krijuar një pozicion i lirë pune pasi ishte parguar “Përgjegjës i burimeve

njerëzore”. UKBK sh.a., kishte punësuar në këtë pozicion pune një punonjëse të re, ndërsa ankuesja pretendoi se ajo mund të ishte sistemuar në këtë pozicion pune.

Në datë 23.07.2020, ankueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me motivacionin “*Shkurtim i vendit të punës në strukturën e U.K.Berat-Kuçovë.*”

Ankuesja N.S., pretendoi se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ajo është mbështetëse dhe anëtare e PD.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolle 12;
- Karta Sociale Europiane;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesja N.S., është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme gjatë procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, nga ana e UKBK sh.a. Në kuadër të ristrukturimit, UKBK sh.a., nuk ka kryer asnjë vlerësim në lidhje me efektet e ndryshimeve strukturore tek punonjësit ekzistues apo mbi mundësinë e sistemimit të tyre në përputhje me pozicionet e punës dhe kriteret e përcaktuara, sipas strukturës së re. UKBK sh.a., fillimisht duhet të kishte vlerësuar mundësinë e sistemimit të ankueses si punonjëse ekzistuese, në përputhje me arsimimin dhe kualifikimin e kërkuar për vendet e lira të punës që ekzistojnë në ato momente. UKBK sh.a., nuk ka bërë asnjë vlerësim të tillë në raport me mundësinë e sistemimit të ankueses në një nga vendet e lira të punës “Përgjegjësit të marrëdhënieve me klientin në sektorin fshat” dhe “Përgjegjës i shitjes”. Më pas, nëse do të rezultojnë akoma vende të lira, mund t’i plotësonin ato me punonjës të rinj. Rezultoi e provuar se ankuesja plotëson kriterin e kërkuar arsimor dhe “Përgjegjës i shitjes” një fakt ky që është kontradiktor me pretendimin e UKBK sh.a., i cili pretendoi se ankuesja nuk plotëson kriterin e arsimit. Gjithashtu, UKBK sh.a., ka shkelur detyrimin ligjor duke mos shqyrtuar ankesën për diskriminim të paraqitur nga ankuesja në datën 06.04.2020. Edhe pse punëdhënësi kishte filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës, ankuesja vazhdonte të ishte punonjëse e UKBK sh.a (zgjidhja e marrëdhënieve të punës me N.S., është bërë në datën 23.7.2020, pra pas tre muajsh) dhe ky i fundit në cilësinë e punëdhënësit ka detyrimin që të trajtojë ankesat për diskriminim që i paraqiten nga punëmarrësit.

Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankueses, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankueses.

Në kushtet kur, argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i saj nga puna ishte kryer për motive politike, *UKBK sh.a., e cila kishte barrën e provës* që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, *dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike*. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e UKBK sh.a., i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkakun i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuseses N.S., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë (UKBK) sh.a.
- Në referim të pikës 1, UKBK sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesen në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

12. L.E., kundër Bashkisë Berat

VENDIM NR. 236, DATË 10.12.2021

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi L.E., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi L.E., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Berat dhe ka punuar në pozicionin Administrator në Njësinë Administrative Otlak. Ankuesi ka filluar punë në datën 25.02.2016 dhe marrëdhëniet e tij të punës kanë vijuar normalisht deri në datën 02.08.2019, kur ankuesi pa asnjë njoftim paraprak dhe pa asnjë motivacion, është shkarkuar nga detyra dhe i është zgjidhur kontratës individuale e punës. Që prej vitit 2016, L.E., është anëtar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim

(LSI), ndërsa në zgjedhjet vendore të vitit 2015, L.E., figuron kandidat i shpallur fitues nga KQZ për Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Berat, si përfaqësues i subjektit politik LSI.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Bashkia Berat pretendoi se zgjidhja e kontratës së punës me L.E., është bërë për shkak të performancës së ulët financiare në Bashkinë Berat, e cila kishte rishikuar marrëdhëniet e punës jo vetëm me këtë administrator. Bashkia Berat, pretendoi gjithashtu se, marrëdhënia e punës midis Kryetarit të Bashkisë, i cili është një person i zgjedhur politikisht dhe Administratorit të Njesisë Administrative, ka një natyrë të veçantë dhe të ndryshme nga punonjësit e tjerë të administratës publike, pasi duhet të ekzistojë një marrëdhënie besimi nga ana e Kryetarit, për të deleguar zgjidhjen e detyrave të ndryshme administrative, duke qenë se funksionet e administratorit parashikohen në nenin 66, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ankuesi e kundërshtoi arsyen e largimit nga puna duke pretenduar se, ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai ishte mbështetës dhe anëtar i subjektit politik LSI dhe se bindjet e tij ishin të kundërta me ato të titullarit të institucionit, Kryetarit të Bashkisë Berat, i cili është përfaqësues i Partisë Socialiste (PS).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 12;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 893, datë 17.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm*”.

KONKLUSIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi L.E., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme gjatë zgjidhjes së kontratës së punës, nga ana e Bashkisë Berat. Bashkia Berat megjithëse kishte barrën e provës, nuk arriti të provojë, se zgjidhja e kontratës së punës dhe largimi i ankuesit nga puna ka ndodhur për shkaqe ose arsye të justifikuara. Ajo nuk arriti të tregojë se ku ka konsistuar përgjegjësia e ankuesit për administrimin e Njesisë Administrative dhe urdhri për zgjidhjen e marrëdhënies së punës së ankuesit nuk ka asnjë motivacion. Urdhri për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin është nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë Berat vetëm në ditën e dytë të punës, pasi ky i fundit ka marrë detyrën. Procedura e ndjekur nga Bashkia Berat gjatë zgjidhjes

së kontratës së punës me ankuesin, është zhvilluar në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës dhe të drejtën e ankuesit që të dëgjohej dhe të mbrohet përpara se punëdhënësi të marrë vendimin përfundimtar për zgjidhjen e kontratës së punës.

Komisioneri vlerësoi se, funksioni i Administratorit të Njesisë Administrative, nuk është funksion politik. Në bazë të Ligjit Nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, Administratori i Njesisë Administrative, nuk është organ i pushtetit vendor. Bazuar në detyrat e përcaktuara në nenin 66 të ligjit të sipërcituar, për administratën e njesisë administrative, Komisioneri vlerësoi se, Administratori i Njesisë Administrative, i cili drejton administratën e njesisë administrative është një funksion publik, një detyrë që ushtrohet nga personi i emëruar (si i punësuar) për përmbushjen e këtij shërbimi publik. Në bazë të Ligjit Nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, të ndryshuar, struktura dhe organika e njësive administrative është pjesë e administratës së bashkisë. Ky fakt përforcohet edhe mbi bazën e parashikimeve të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Berat, funksionet e administratorëve të njësive administrative, parashikohen si funksione të natyrës administrative, pjesë përbërëse të strukturës administrative të Bashkisë Berat. Njëkohësisht, sipas strukturës dhe organikës së Bashkisë Berat, administratorët e njësive administrative dhe ato të lagjeve nuk janë pjesë përbërëse e Kabinetit të Kryetarit, anëtarët e së cilit, për analogji me parashikimet e Vendimit Nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, kanë status politik dhe marrëdhënia e tyre e punës është e një natyre të veçantë. Administratorët janë punonjës që nuk gëzojnë status të veçantë, i cili e bën punësimin e tyre, të lidhur dhe të kushtëzuar me qëndrimin në detyrë ose jo të Kryetarit të Bashkisë.

Lidhur me Administratorin e Njesisë Administrative, legjislacioni i posaçëm për pushtetin vendor nuk përmban ndonjë parashikim lidhur me statusin juridik të tyre, ata nuk janë nëpunës civil, por njëkohësisht nuk janë as funksionar politikë dhe as organe të zgjedhura. Komisioneri, vlerësoi se funksioni i Administratorit të Njesisë Administrative, i cili ushtrohet nga një i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, përderisa ligji nuk përcakton ndonjë afat të tillë, passjell që ky funksion gëzon të njëjtën mbrojtje sikurse parashikohet për çdo punëmarrës nga dispozitat e Kodit të Punës dhe Ligjit Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, rezultuan të provuara bindjet politike të ankuesit, shkak ky që gëzon mbrojtje nga diskriminimi. Komisioneri vlerësoi se, provat e administruara ishin të mjaftueshme në mbështetje të faktit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet politike të ankuesit. Njëkohësisht, Komisioneri mbajti në konsideratë edhe qasjen që Bashkia Berat ka ndaj funksionit të Administratorit të Njesisë Administrative, i cili konsiderohet prej saj, si një funksion i lidhur ngushtësisht me fatin e Kryetarit të Bashkisë. Kjo qasje e Bashkisë Berat ndaj funksionit të Administratorit të Njesisë Administrative, të çon në deduksionin se, në kundërshtim me parashikimet ligjore, ajo e konsideron këtë si funksion politik dhe se drejtuesi i Administratës së Njesisë Administrative duhet të emërohet një person i cili i përket të njëjtës forcë politike, përfaqësues i të cilit është edhe Kryetari

i Bashkisë, në mënyrë që të përlligjet besimi që, sipas Bashkisë Berat duhet të ekzistojë midis Kryetarit të Bashkisë dhe Administratorit të Njësisë Administrative.

Në kushtet kur, argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi ishin në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijonin prezumimin se*, largimi i tij nga puna ishte kryer për motive politike, *Bashkia Berat, e cila kishte barrën e provës* që të provonte, ose që nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm ose të provonte se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm ishte i lidhur me shkakun e pretenduar, kishte një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, *dështoi që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime ishin kryer për motive politike*. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Berat, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës të ankuesit mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit L.E., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Berat.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Berat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

13. H.K., kundër Bashkisë Mat

VENDIM NR. 30, DATË 19.02.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

H.K., ka punuar në Ndërmarrjen e Rrugëve pranë Bashkisë Mat. Ai është diskriminuar duke u larguar nga puna për shkak të bindjeve politike nga Bashkia Mat.
--

FAKTET

H.K., ka filluar punë në Ndërmarrjen e Rrugëve pranë Bashkisë Mat, si punëtor i pakualifikuar, që në vitin 2007. Në vitin 2019, u miratua Struktura dhe Organika e re e Bashkisë Mat. Me miratimin e saj, numri i punonjësve në Sektorin e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, nga 41 u reduktua në 26 dhe numri i punonjësve të mirëmbajtjes nga 26 u reduktua në 16. Pas miratimit të strukturës

ankuesi është njoftuar për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të shkurtimit të vendit të punës në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Mat.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12;
- Konventa Nr. 111 Organizata Ndërkombëtare e Punës ILO;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KONKLUSIONE

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm krahasuar me punonjësit e tjerë që janë mbajtur në punë.

Argumentimi i Bashkisë Mat se vlerësimi i punonjësve se cili largohet dhe cili mbetet në punë, është bërë duke u bazuar në realizimet konkrete të detyrave që u caktohen dhe frekuentimin dhe përkushtimin në punë, rezulton i pabazuar në prova dhe fakte, por mbetet deklarativ për sa kohë nuk është depozituar asnjë dokument mbi bazën e të cilit të mund të evidentohet realizimi i detyrave, frekuentimi dhe përkushtimi në punë i të gjithë punonjësve. Në këtë kontekst, Komisioneri, në mungesë të dokumentimit të deklarimeve të Bashkisë, mungesën e dokumentimit të fakteve të pretenduara për realizimet e detyrave dhe përkushtimit në punë të punonjësve e vlerëson si argument pro pretendimeve të ankuesit.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia, nuk provoi përpara Komisionerit se:

- Bazuar në strukturën datë 25.09.2019 të Bashkisë Mat dhe shkurtimin e pozicioneve të punës, punëtor mirëmbajtje, përzgjedhja e punonjësve për të qëndruar në këtë pozicion ishte bërë mbi bazën e kriterëve të qarta dhe objektive.
- Largimi i ankuesit nga puna për shkak të shkurtimit të ishte i arsyeshëm dhe objektiv.
- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Mat, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.

Nga ana e Bashkisë Mat, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit, fakte dhe prova lidhur me kriteret që kishte ndjekur Bashkia Mat, për vlerësimin e punëtorëve të mirëmbajtjes të cilët do qëndronin apo largoheshin nga puna. Mungesa e këtyre provave, nuk lejon Komisionerin që të kuptojë se si është bërë përzgjedhja e punonjësve që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe të

punonjësve që vazhduan marrëdhëniet e punësimit, çka krijon premisa në përforcim të dyshimit të arsyeshëm mbi shkakun diskriminues të largimit nga puna të H.K.

Komisioneri krijon bindjen se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Në rastin konkret, bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi Bashkia Mat nuk arriti të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit nuk është bërë për shkak të bindjeve politike ose se largimi është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të H.K., nga ana e Bashkisë Mat, për shkak të bindjes politike.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Mat të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të.

14. M.K., kundër Bashkisë Berat

VENDIMI NR. 44, DATË 11.03.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

M.K., është diskriminuar në marrëdhëniet e punësimit për shkak të bindjeve politike nga Bashkia Berat.

FAKTET

M.K., është paraqitur 5 minuta me vonesë në punë, dera ka qenë e mbyllur dhe kanë qenë rreth 20 punonjës jashtë institucionit të bashkisë, të cilët kanë qëndruar deri në orën 8.30 derisa është hapur dera dhe kanë vazhduar punën normalisht. Më pas, është vënë në dijeni të urdhrin për dhënie mase disiplinore nëpunësit civil, “Vërejtje” me motivacionin, për mos zbatim të orarit zyrtar të punës në mënyrë të përsëritur dhe shkelje të etikës në komunikim me eprorin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokolle 12;
- Konventa Nr. 111 Organizata Ndërkombëtare e Punës ILO;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.

KONKLUZIONE

Nga ana e Bashkisë Berat nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjin faktin e thyerjes së Kodit të Etikës nga ana e M.K., dhe masa disiplinore e marrë ndaj saj dhe mosmarrja e masave për punonjësit e tjerë që nuk kanë zbatuar orarin e punës në mënyrë të përsëritur, në datë 02.06.2020 është bërë për shkaqe të arsyeshme dhe objektive.

Nga faktet dhe provat e administruara, arsyeja e pretenduar për dhënien e masës disiplinore për shkelje të etikës në komunikim me eprorin, rezulton vetëm me deklarimin verbal të bërë nga Bashkia Berat, por nuk rezulton që të jetë mbajtur një procesverbal apo dokumentacion tjetër për ta vërtetuar atë. Duke pasur barrën e provës për të provuar arsyen e dhënies së masës disiplinore, Bashkia Berat në cilësinë e punëdhënësit nuk arriti të provojë shkeljen e Kodit të Etikës nga ana e ankueses, për të legjitimuar në këtë mënyrë faktin se dhënia e masës disiplinore ka të bëjë me sjelljen e ankueses.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Berat, nuk arriti të provonte përpara Komisionerit se:

- Janë marrë masa disiplinore për të gjithë punonjësit që nuk kanë firmosur në listëprezencën e datës 02.06.2020, për moszbatim të orarit zyrtar të punës në mënyrë të përsëritur.
- Të të faktonte shkeljen e Kodit të Etikës nga ana e ankueses.
- Nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesja, që janë bindjet politike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Berat, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.

Komisioneri arrin në përfundimin se, subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Berat, krahasuar me punonjësit e tjerë, për të cilët nuk është marrë masë disiplinore, për mosfirmosje të listëprezencës si dhe për thyerje të Kodit të Etikës.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankueses konsiston në veprimet për dhënien e masës disiplinore ndaj saj. Për rrjedhojë, edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri, që Bashkia Berat në komunikim me të, të zbatojë normat e etikës. Lidhur me këtë kërkesë, Komisioneri kërkon nga Bashkia Berat që të ndërpresë veprimet diskriminuese ndaj ankueses për shkaqet e konstatuara si diskriminuese.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankueses M.K., nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të bindjes politike.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Berat të marrë masa për ndërprerjen e veprimeve diskriminuese ndaj ankueses, pas kthimit të saj në punë nga leja e barrëlindjes.

15. G.Gj., kundër L.B., Zv/Kryetar i Bashkisë Berat dhe E.D., Kryetar i Bashkisë Berat

VENDIM NR. 86, DATË 26.05.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar për shkak të bindjes politike gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore, mostrajtit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil.

FAKTET

Ankuesi, në vitin 2018, është emëruar në Shërbimin Civil në periudhë prove në pozicionin, Specialist i Kontrollit të Zhvillimit të Punëve Publike dhe Private, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Me urdhrin e vitit 2020, G.Gj., është emëruar sipas strukturës së re, të administratës të vitit 2020 në pozicionin, Specialist për Monitorimin e Investimeve, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në momentin e lirimit nga shërbimi civil.

Në vitin 2019, L.B., është emëruar në pozicionin, Zëvendëskryetar i Bashkisë Berat, si dhe krahas detyrës funksionale si Zëvendëskryetar i bashkisë është komanduar dhe në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për një periudhë të vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, me anë të shkresës “*Tërheqje vëmendje*”, drejtuar nëpunësit civil G.Gj., Kryetari i Bashkisë Berat ka tërhequr vëmendjen ankuesit, me motivacionin “*Vonesa në zbatim të detyrave të ngarkuara nga eprori*”.

Më tej, Drejtori i Komanduar, L.B., ka propozuar dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*” për punonjësin G.GJ me motivacionin: “*Për mos realizim në kohë të detyrave të ngarkuara*”.

Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar që nëpunësit civil G.Gj., t’i jepej masa disiplinore “*Vërejtje*”, me motivacionin “*Për mos realizim në kohë të detyrave të ngarkuara*”.

Sa më sipër, ankuesi ka kërkuar rishikimin e masës disiplinore dhe ka argumentuar situatën dhe marrëdhëniet e punës me Drejtorin e Komanduar, por nuk ka një përgjigje.

Ankuesi duke u ndjerë i anashkaluar në detyrat që duhet të mbulonte sipas pozicionit të tij, i është drejtuar përsëri Kryetarit të Bashkisë, të cilin e ka vënë në dijeni se po diskriminohet nga L.B., pasi shkresat siglohen vetëm në emrin e koleges që është në të njëjtin sektor dhe së fundmi siglimi i shkresave po i bëhej dhe një punonjëseje të sapo emëruar në sektorin e planifikimit, e cila nuk ka lidhje me detyrat e sektorit të investimeve. Në këtë shkresë, ankuesi ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, zgjidhjen e shqetësimit të ngritur në mënyrë të përsëritur. Nga ana e bashkisë nuk ka një përgjigje për shkresën e ankuesit.

Në vijim, ankuesi i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe ka rikërkuar marrjen e masave për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë, të diskriminimit dhe viktimizimit të tij, nga ana e zv/Kryetarit të Bashkisë, L.B. Në mes të tjerash, G.Gj., në këtë shkresë ka sjellë në vëmendje të Kryetarit të Bashkisë, dhe mbrojtjen e punëmarrësit nga veprimet diskriminuese të punëdhënësit.

Në përgjigje të ankesës për diskriminim të G.Gj., Bashkia Berat është përgjigjur se ankimi nuk pranohej për shkak se G.Gj., nuk legjitimohej në ngritjen e ankimit dhe mjetet ligjore administrative, nuk përfshinin objektin e ankimit të tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të datës 27.11.2000 për “*Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Deklarata e ILO-s mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar;
- Vendimin Nr. 827, datë 15.12.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së bashkisë dhe të njëjste shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021”.

KONKLUZIONE

Komisioneri vlerësoi se ankuesi është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt, pasi ai nuk ka pasur në mënyrë efektive të ushtrijë të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në lidhje me arsyet e dhënies së masës disiplinore në marrëdhëniet e punës. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Kryetarit të Bashkisë, E.D., dhe Drejtorit të Komanduar, L.B.

Komisioneri vlerësoi se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat nuk është bërë një analizë e thelluar dhe e plotë, për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë mbi pretendimet për diskriminim të subjektit ankues dhe të merreshin masa për trajtimin e padrejtë dhe të pabarabartë të Drejtorit të Komanduar kundër G.Gj.

Nga Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtori i Komanduar nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlijnin faktin se dhënia e masës disiplinore, mostrajtimi i ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimi i statusit të nëpunësit civil të ankuesit kanë ardhur për arsye të ligjshme.

Subjekti ankues, në cilësinë e punëmarrësit, është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore, trajtimit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil, nga ana e Drejtorit të Komanduar, L.B., dhe Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D., në cilësinë e punëdhënësit.

Komisioneri krijon bindjen se G.Gj., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme në procedurën e ndjekur për dhënien e masës disiplinore, mostrajtimin të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të nëpunësit civil. Duke i’u referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, prezumimit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet e tij politike dhe faktit që Bashkia Berat nuk arriti të provojë se nuk ka patur një trajtim të pafavorshëm dhe se dhënia e masës disiplinore, mostrajtimi i ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimi i nëpunësit civil ka patur një shkak të ligjshëm, krijohet bindja se veprimet e Bashkisë Berat kanë qenë të motivuara politikisht. Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore. Komisioneri gjykon se, për sa i përket ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, G.Gj., nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Berat. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të shtetasit G.Gj., nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat, E.D., dhe Drejtorit të Komanduar të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të

Investimeve, L.B., për shkak të bindjes politike gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore, trajtimit të ankesave për diskriminim dhe moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil.

16. F.H., kundër Bashkisë Klos

VENDIM NR. 104, DATË 10.06.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

F.H., ka qenë punonjës pranë Bashkisë Klos. Fillimisht, ankuesi ka filluar punë në pozicionin Inspektor pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor dhe më pas ka kaluar në pozicionin Polic Pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Me ndryshimin e strukturës organizative të Bashkisë Klos, emërtimi i pozicionit të punës Polic Pyjesh, u ndryshua në Specialist i Mesëm (Monitorimi i Pyjeve).

Bashkia Klos ka informuar ankuesin se ka filluar procedura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për arsye se nuk plotëson kriterin arsimor për pozicionin e punës, pasi nga verifikimet e dosjes individuale rezulton që nuk ka arsimin përkatës në pozicionin aktual të punës, dhe ka mospërputhje të gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës.

Kryetari i Bashkisë Klos ka nxjerrë Vendimin për largimin nga detyra të Specialistit të Mesëm (Monitorimi i Pyjeve) të F.H., për arsye të mungesës së arsimit përkatës, si dhe të mospërputhjes së gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 12;
- Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm krahasuar me punonjësit e tjerë që vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit në pozicionin si specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve).

Nga ana e Bashkisë Klos nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin kriterin e arsimit të duhur për pozicionin specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve) apo për ligjnin faktin se largimi i ankuesit dhe vazhdimi i marrëdhënieve të punësimit me punonjësit e tjerë të ishte i drejtë dhe i arsyeshëm.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia, dështoi të provonte përpara Komisionerit se:

- Kishte ndryshuar kriterin e arsimit për punonjësit në pozicionin e specialistit të mesëm (monitorimi i pyjeve).
- Ankuesi nuk kishte arsimin përkatës, sipas parashikimeve ligjore të mirë përcaktuara.
- Gjatë procesit të verifikimit të dosjeve kishte marrë masa për të vendosur në ligjshmëri marrëdhëniet e punësimit për të gjithë punonjësit që nuk kishin arsimin përkatës.
- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Klos, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.

Pra, ndërprerja e marrëdhënies së punës me ankuesin edhe pse është bërë për arsye të mungesës së arsimit përkatës, është bërë në mungesë të kriterëve të paracaktuara, të qarta dhe transparente. Punonjësit duhet të kenë dijeni në lidhje me bazën e cilave kriterë do të bazohet vendimmarrja e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhur në rastin e ankuesit. Diploma e ankuesit ka qenë e ditur që në çastin e lidhjes së kontratës së punës me F.H., datë 09.03.2017. Fakti që kjo diplomë është marrë në konsideratë nga punëdhënësi në kohën e lidhjes së kontratës, nuk i jep të drejtë punëdhënësit që gjatë ecurisë së marrëdhënieve të punës të ndryshojë kriterin e arsimit për vendin e punës, pa vënë në dijeni punëmarrësin dhe më pas ta konsiderojë si shkak të justifikuar për të zgjidhur marrëdhëniet e punës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të F.H., nga ana e Bashkisë Klos, për shkak të bindjes politike.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Klos të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

17. E.Rr., kundër Bashkisë Lezhë

VENDIM NR. 155, DATË 20.08.2021

Shkaku: Bindja Politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi, në vitin 2014, ka nisur marrëdhënien e punës në ish-Komunën Dajç, në pozicionin: Jurist dhe Shef i Inspektoriatit të Ndërtimit. Referuar librezës së punës rezulton që ka qenë i punësuar në ish-Komunën Dajç, deri në fund të vitit 2015, dhe pas kalimit të ish-Komunave në varësi të Bashkisë Lezhë, në të njëjtin pozicion që kishte filluar marrëdhënien e punës. Në vitin 2016 është emëruar në pozicion Specialist i Arsimit dhe Kulturës në Njësinë Administrative Dajç dhe ka vazhduar marrëdhëniet e punësimit deri në vitin 2020, kur i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me Bashkinë Lezhë, për arsye të shkurtimit të vendit të punës. Gjatë vitit 2019 është zhvilluar takimi mes palëve dhe është mbajtur procesverbal, në të cilin E.Rr., në mes të tjerash, ka deklaruar se: “..Unë shkoj edhe punëtor shërbimesh të paktën mos të jem pa punë”. Me Urdhrin “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me E.Rr.,” të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe i janë dhënë shpërblimet për lejen vjetore të pakryer dhe për vjetërsi në punë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit 12;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Deklarata e ILO-s mbi kriteret themelore dhe të drejtat në punë;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore ”.

KONKLUSIONE

Në kuadër të ristrukturimeve, punëdhënësi duhet që fillimisht të sistemojë punonjësit ekzistues në përputhje me kualifikimin e kërkuar nga vendi i punës. Bazuar në aktet e administruara, Bashkia Lezhë, rezulton të ketë patur mundësi për të sistemuar ankuesin në një nga pozicionet e lira “punëtor shërbimesh” dhe më pas nëse do të rezultonin akoma vende të lira, mund t’i plotësonte ato me punonjës të rinj, të cilët plotësojnë kriteret e vendit të punës.

Bashkia Lezhë nuk arriti të japë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm se përse nuk e ka emëruar ankuesin si punëtor shërbimesh, në kushtet kur ka patur mundësi reale për të vazhduar marrëdhënien e punës me ankuesin.

Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Lezhë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për mosemërimin e ankuesit si punëtor shërbimesh, mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

Në konkluzion sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Lezhë ka diskriminuar ankuesin E.Rr., në të drejtën për punësim. Për rrjedhojë, Bashkia Lezhë ka shkelur nenet 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika 1 dhe nenin 12, pika 1, gërma “b”, të Ligjit Nr. 10 221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuesit konsiston pikërisht në mosemërimin e ankuesit si punëtor shërbimesh. Për rrjedhojë, edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e mosemërimin të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e emëruar ankuesin si punëtor shërbimesh ose në një pozicion të barazvlefshëm me të, brenda Njësisë Administrative Dajç. Komisioneri çmon se emërimi i ankuesit në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjestim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase, që në rastin konkret ka qenë mosemërimi i ankuesit në pozicionin si punëtor shërbimesh.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit E.Rr., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Lezhë.
- Në referim të pikës 1, Bashkia Lezhë të marrë masa për rivendosjen në vend të drejtës së shkelur duke e emëruar ankuesin si punëtor shërbimesh ose në një pozicion të barazvlefshëm me të, brenda Njësisë Administrative Dajç.

18. A.L., kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Lezhë

VENDIM NR. 180, DATË 23.09.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Vendimi i KMD është lënë në fuqi nga Gjykata, me vendim të formës së prerë.

A.L., është diskriminuar nga DRAP Lezhë, në marrëdhëniet e punësimit, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Subjekti ankues është me profesion mësuese e lëndës matematikë-fizikë prej 29 vitesh, nga të cilat 10 vitet e fundit ushtron këtë profesion pranë një shkolle 9-vjeçare. Pasi DRAP Lezhë, ka shpallur të lirë pozicionin e drejtorit të kësaj shkolle, ankuesja ka konkuruar për këtë pozicion, sipas procedurave të konkurimit.

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor pranë Shkollës sipërcituar, ka njoftuar nëpërmjet e-mailit kandidatët konkurent, se në listën e kandidatëve të kualifikuar rezultojnë:

1. E.Rr., vlerësuar me 105.6 pikë.
2. L.M., vlerësuar me 100.6 pikë.
3. A.L., (subjekti ankues), vlerësuar me 95.3 pikë.
4. M.Q., vlerësuar me 71.6 pikë.

Bazuar në përlllogaritjen që Komisioni u ka bërë kandidatëve, nuk është zbatuar procedura e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 2, datë 28.01.2020 “*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar*”, gjë që ka passjellë pikëzim më të ulët të ankuses, pasi pesëfishimi që i është bërë pikëve të dosjeve të aplikantëve ka thelluar diferencën (psh. një kandidat duke patur një pikë më shumë në dokumentacion, kur pesëfishohet ka 5 pikë më shumë, ndërkohë që për intervistën është ndjekur standard tjetër (ai që përcaktohet në Udhëzimin përkatës), duke bërë që në përfundim të përlllogaritjes rezultati të dalë i deformuar dhe jo i saktë.

Një përlllogaritje e tillë nga Komisioni është e qëllimshme, për të favorizuar kandidaten E.Rr., e cila në përfundim të procedurës u shpall fituese, për faktin se ajo është aktiviste dhe mbështetëse e subjektit politik Partia Socialiste, faktuar me daljet haptazi në përkrahje të PS edhe gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021. (nëpërmjet fotove të marra nga rrjeti social Facebook, ku rezulton se ka qenë pjesëmarrëse në aktivitetet politike të PS).

Po kështu, ankuesja ka provuar se edhe drejtuesit e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë janë pjesë e strukturave të PS dhe kjo është arsyeja që kandidatja E.Rr., është favorizuar prej tyre për t’u zgjedhur drejtore e shkollës 9-vjeçare, në ndryshim nga ajo që nuk ka asnjë aktivizim politik dhe

nuk ka përkrahur asnjë forcë politike, gjë e cila, sipas saj, e ka penalizuar në këtë procedurë konkurimi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 99, datë 27.02.2019 “*Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*”;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 për MASR.

KONKLUZIONE

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se ankuesja ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e DRAP Lezhë, trajtim i cili kishte lidhje me bindjet politike të saj. Bazuar në veprimet dhe procedurën e ndjekur nga DRAP Lezhë, Komisioneri vlerësoni se:

- Pas ankimimit të ankueses, (*por dhe kryesisht, në rastet kur konstaton parregullsi në procedurën e ndjekur*), DRAP Lezhë kishte detyrimin që, bazuar në kompetencat e tij funksionale, jo thjesht të kërkonte *formalisht* nga ZVAP Shkodër të ndërmerre masa për vlerësimin e dosjeve konform përcaktimeve të Udhëzimit respektiv, por të mbante qëndrim konsekuent në kontrollin dhe zbatimin e parimit të ligjshmërisë, duke ushtruar përgjegjshmëri dhe autoritet institucional.
- DRAP Lezhë, me të drejtë ka konstatuar se, mënyra e përlllogaritjes së pikëve të dosjeve të kandidatëve, duke e shumëzuar rezultatin me 5 (pesë) ishte e gabuar, dhe se vlerësimi i dosjeve të secilit kandidat nuk duhet të kalonte 30 pikë, dhe se po ashtu, vlerësimi përfundimtar i kandidatëve nuk duhet të kalonte 40 pikët maksimale, sipas Shtojcës 5, të Udhëzimit.
- Pavarësisht këtij konstatimi, dhe standardit të ndryshëm të përlllogaritjes së pikëve të dosjeve me atë të pikëve të intervistës së strukturuar (*dhe pasi ZVAP Shkodër është urdhëruar nga DRAP Lezhë, ky i fundit ka përsëritur të njëjtën procedurë pa ndrequr asnjë pasojë të krijuar, duke ridërguar të njëjtat dosje kandidatësh, me të njëjtin sistem pikëzimi dhe mënyrë vlerësimi*).

- DRAP Lezhë ka vijuar me fazën tjetër të procedurës së vlerësimit të kandidaturave, duke legjitimuar kështu parregullsitë të cilat vetë i kishte evidentuar dhe kërkuar që të ndreqeshin.
- DRAP Lezhë me veprime konkludente të vetëdijshme dhe në mungesë të përgjegjshmërisë institucionale e ligjore ka emëruar kandidaten E.Rr., në pozicionin e drejtorit të Shkollës, pavarësisht faktit të pranuar dhe të deklaruar prej saj, se përllogaritja e pikëve të dosjes ishte bërë në mënyrë të gabuar dhe të pa mbështetur në përcaktimet ligjore të Udhëzimit përkatës të MASR.
- Komisioneri konstaton se, nëse vlerësimi do të ishte kryer sipas përcaktimeve të aktit nënligjor specifik, E.Rr., nuk do të ishte kualifikuar në kandidatet me më shumë pikë, pasi do të renditej e treta, ndërsa ankuesja ndër dy kandidaturat.
- Për sa më sipër, me mënyrën gabuar të përllogaritjes së pikëve të dosjeve, ankuesja është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme krahasuar me E.Rr., duke sjellë për rrjedhojë s'kualifikimin e ankueses nga e drejta e përzgjedhjes për pozicionin e drejtorit të Shkollës.
- DRAP Lezhë ka pranuar se në raste të tjera, lidhur me emërimin e drejtorëve të IPAP, përsa i takon procedurës së ndjekur për pikëzimin e dosjeve të aplikantëve, mënyra e përllogaritjes së pikëve ka qenë konform shtojcës 5 të Udhëzimit. Pra jo më shumë se 30 pikë për secilin kandidat, dhe jo më shumë se 40 pikë në total në vlerësimin përfundimtar për secilin prej tyre.
- Për rrjedhojë, të gjitha këto fakte provojnë trajtimin e pafavorshëm që i është bërë ankueses, duke e s'kualifikuar nga gara e mëtejshme, nga njëra anë, dhe trajtimin preferencial që i është bërë kandidates E.Rr., me qëllim favorizimin e saj në mënyrë që të renditej në dy kandidaturat me më shumë pikë, duke passjellë edhe përzgjedhjen e saj si drejtore e shkollës 9-vjeçare, Shkodër.

Komisioneri vlerëson se, referuar standardit të mbajtur nga DRAP Lezhë, për këtë rast, kemi haptazi trajtim të pafavorshëm të ankueses, në raport me kandidaten E.Rr., me qëllim favorizimin e kësaj të fundit për kualifikimin e saj me më shumë pikë.

Komisioneri konkludoi se, subjekti ankues është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me përcaktimet ligjore dhe standardin e krijuar për emërimin e drejtorëve të IPAP, nga ana e DRAP Lezhë, përsa i takon procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër.

Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara si deklaratimet e ankueses për mospasje të bindjeve politike dhe mos angazhim të saj në asnjë strukturë apo forcë politike, dhe po ashtu, rezultuan të provuara bindjet politike dhe angazhimi politik nëpër aktivitete të PS, për drejtoren e emëruar të IPAP, Shkodër, drejtoren e ZVAP Shkodër dhe drejtorin e DRAP Lezhë.

Dijenja e DRAP Lezhë për bindjet dhe angazhimin politik të E.Rr., fakt për të cilin është favorizuar krahasuar me ankuesen, e cila është disfavorizuar pikërisht për shkak të mos pasjes angazhim politik, rezultojnë të provuara nga këto fakte:

- Drejtuesi i DRAP Lezhë B.P., drejtuesja e ZVAP Shkodër B.N., si dhe kandidatja e emëruar drejtore e shkollës 9-vjeçare Shkodër E.Rr., janë në vartësi hierarkike institucionale përsa i përket marrëdhënieve të punës dhe përsa i përket bindjeve, angazhimit qytetar e politik i përkasin forcës politike që qeveris vendin.
- Ky angazhim politik dhe elektoral (*citojmë zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021*) nga të sipërpërmendurit është i njohur dhe i ekspozuar publikisht.
- Kështu, E.Rr., ka qenë pjesëmarrëse koherente si para dhe pas emërimit si drejtore, në aktivitetet elektorale të zhvilluara dhe publikuara nga drejtuesi politik i PS për Qarkun e Shkodrës I.B.
- Këto fakte, të lidhura edhe me momentet që kanë shoqëruar procedurën e tejzgjatur, me shtyrje, pezullime, shpalljen tre herë të vakancës, në shkelje të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 “*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar*”, mungesa e shpjegimeve të arsyeshme nga DRAP Lezhë, për veprimet e kryera; krijojnë bindjen se favorizimi që i është bërë E.Rr, dhe disfavorizimi dhe trajtimi i pabarabartë i ankueses, janë ndikuar dukshëm nga motive të përkatësisë dhe angazhimit politik e partiak.

Në përfundim, bazuar në analizimin e fakteve, provave dhe bazës ligjore sipërcituar, Komisioneri vlerësoi se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me përcaktimet ligjore dhe standardin e krijuar për emërimin e drejtorëve të IPAP, nga ana e DRAP Lezhë, përsa i takon procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare, Shkodër, duke u diskriminuar për shkak të mospasjes së bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të ankueses A.L., për shkak të bindjeve politike, nga ana e DRAP Lezhë.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga DRAP Lezhë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të ankueses.

19. D.M., kundër Bashkisë Kukës

VENDIM NR. 186, DATË 30.09.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Subjekti ankues është diskriminuar nga Bashkia Kukës, në marrëdhëniet e punësimit, për shkak të bindjeve politike.

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Kukës (Bashkinë), në detyrën “Specialist i Kontrollit të Sigurisë Ushqimore”, për rreth 4 (katër) vite.

Që pas muajit qershor 2019, kur drejtues i Bashkisë u shpall S.Gj., në institucion filluan të bëheshin edhe ndryshimet politike të stafit dhe ankuesi ka pasur presione verbale të vazhdueshme për të paraqitur dorëheqjen, për shkak se bindjet e tij politike ishin të ndryshme nga ato të drejtuesit të Bashkisë.

Gjatë periudhës korrik 2019 - mars 2021 i janë bërë disa njoftime nga ana e Bashkisë për largimin nga puna, për shkak se nuk ka pranuar të bëhet pjesë e takimeve politike të Partisë Socialiste, dhe as pjesë e propagandës së Bashkisë.

Largimi i ankuesit nga puna është i padrejtë dhe i motivuar vetëm nga shkaqe politike, pasi ai ka bindje të djathta, ndryshe nga bindjet politike të drejtuesit të Bashkisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokollit 12;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Deklarata e ILO-s mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Rezultoi se zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kukës

nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së kontratës së punës, qoftë për sa i përket ndryshimeve strukturore të Bashkisë, mosrealizimit të detyrave funksionale apo mosrespektimit të orarit zyrtar, shkeljes së etikës dhe disiplinës në punë.

Komisioneri vlerësoi se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për largimin nga puna, rezultuan të paprovuara. Në këto kushte, provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e tij nga puna është bërë në shkelje të plotë të procedurës ligjore që duhet ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Komisioneri, duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankuesit nga puna, konstatoi se D.M. është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e tij nga puna është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive, i motivuar nga bindjet politike të tij.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kukës.
- Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, Komisioneri kërkoi nga ana e Bashkisë Kukës, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me D.M.

20. G.M., kundër Administratorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

VENDIM NR. 206, DATË 26.10.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi, është diskriminuar nga Administratori i UAMD-së, në marrëdhëniet e punësimit, duke e kaluar atë në një pozicion më të ulët, veprim i ardhur për shkak të bindjeve të tij politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka mbajtur detyrën “Specialist” në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD).

Ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me motive të pabazuara dhe të pavërteta. Memoja mbi të cilën është bazuar kjo vërejtje, nuk sqaron se cilat detyra konkretisht nuk ka zbatuar ankuesi dhe as ka faktuar ndonjë shkelje të tij.

Ankuesi ka provuar se sjelljet diskriminuese të Administratorit të UAMD kundrejt tij, e kanë burimin tek bindjet politike dhe pjesëmarrja e tij në fushatën elektorale për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021, pasi ka bindje të kundërta me ato të Administratorit dhe Partisë Socialiste.

Ankuesi ka faktuar se diskriminimi nga Administratori, ka vijuar ndaj tij duke e kaluar atë në një pozicion më të ulët me detyrë “Mirëmbajtës”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolle 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007);
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Rregullore e UAMD-së, miratuar me Vendimin nr. 154, datë 26.11.2018, të Senatit Akademik.

KONKLUSIONE

Rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pasi masat disiplinore të marra kundrejt tij, nuk janë motivuar nga një shkak i ligjshëm, apo të jenë të arsyetuara dhe të justifikuara e të kenë ndjekur një qëllim të ligjshëm. Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara bindjet politike të pretenduara nga ankuesi si anëtar dhe aktivist i LSI Durrës.

Marrja e dy masave disiplinore kundrejt ankuesit, jo vetëm që nuk rezultoi që këtë ndodhur për ndonjë shkak ligjor e të përligjur, por nga faktet dhe aktet e administruara, Komisioneri konstaton se Administratori, deklaroi motivacione dhe shkaqe të ndryshme që kanë shërbyer për dhënien e tyre.

Duke i'u referuar faktit se ankuesi është anëtar dhe aktivist i subjektit politik LSI dhe faktit që Administratori, nuk arriti të provojë se dhënia e dy masave disiplinore ndaj ankuesit, ka ndodhur për një shkak të ligjshëm dhe janë respektuar kërkesat ligjore, krijohet dyshimi i arsyeshëm se veprimet e punëdhënësit kanë qenë të motivuara politikisht.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar, mendohet se ushtrimi i funksioneve publike në institucione si administrata e universiteteve, (përfshirë administratën e UADM-së), dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

Subjekti ankues ka provuar e dokumentuar bindjet dhe angazhimin e tij politik në këtë subjekt (LSI) nga viti 2016 e në vijim, si dhe ekspozimin e tyre publikisht dhe haptazi, gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021.

Në mungesë të një justifikimit ligjor dhe objektiv lidhur me veprimet e Administratorit të UAMD-së, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e tij, mbetet shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

Komisioneri ka konstatuar se veprimet e punëdhënësit/Administratorit të UAMD-së, në dëm të subjektit ankues kanë ardhur pas ekspozimit të tij publikisht në aktivitetet gjatë fushatës politike në mbështetje të kandidatëve të LSI për qarkun e Durrësit, në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021. Masat disiplinore të marra kundrejt tij datojnë menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

Në këtë mënyrë plotësohet edhe elementi tjetër i nevojshëm për të përcaktuar nëse diskriminimi ka ndodhur, pra lidhja shkakësore, pasi në mungesë të një justifikimi për ligjshmërinë e veprimeve nga ana e Administratorit, në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënien e dy masave disiplinore ndaj ankuesit, si dhe vetë përmbajtjen e këtyre dy masave; shkaku i mbrojtur, pra bindjet politike të ankuesit mbeten i vetmi shpjegim i arsyeshëm për veprimet e padrejta të Administratorit të UAMD-së.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, Administratori ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën e tij për punësim, pasi të dy masat disiplinore të ndërmarra kundrejt tij, nuk kanë ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk kanë ndodhur për arsye të justifikuara dhe objektive, si dhe nuk kanë ndjekur një qëllim të ligjshëm, por trajtimi i tij i padrejtë dhe i pafavorshëm është bërë për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të ankuesit G.M., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e punëdhënësit, Administratorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD).
- Në referim të pikës 1 të Vendimit, Administratori i UAMD-së, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

21. K.K., kundër Bashkisë Selenicë

VENDIM NR. 101, DATË 08.06.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues është diskriminuar nga Bashkia Selenicë, në marrëdhëniet e punës, për shkak të bindjes politike të tij.

FAKTET

Subjekti ankues, ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Selenicë, nga viti 2015 deri në vitin 2021. Në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, ka mbajtur pozicionin e specialistit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave. Urdhri “Për përfundimin e marrëdhënieve të punës në Shërbimin Civil”, për ankuesin, i Kryetarit të Bashkisë është në shkelje flagrante të ligjit.

Motivacioni i cituar për largimin e ankuesit nga shërbimi civil “Për rezultate jo të kënaqshme në punë, në pozicionin e specialistit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave” është i pavërtetë dhe i pabazuar në dokumentacion, pasi ai nuk ka marrë asnjë vlerësim pune “jo kënaqshëm”, përkundrazi është vlerësuar për punë të mirë në Institucion.

Lirimi i tij nga detyra, është bërë pa asnjë dokumentacion në lidhje me hetimin administrativ të ndërmarrë ndaj tij, pa asnjë shkelje, vërejtje apo masë disiplinore, ky është një urdhër i cili nuk krijon asnjë pasojë juridike pasi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe është bërë vetëm për shkak të bindjeve të tij politike, të ndryshme nga ato të Kryetarit të Bashkisë, duke qenë se ishte aktivizuar në një subjekt politik në opozitë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolle 12;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Deklarata e ILO-s mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/çështja Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë (Bączkowski and others v. Poland)/ çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar;
- Karta Sociale Evropiane;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga Shërbimi Civil”, e ndryshuar.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Selenicë:

- Nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar se ankuesi nuk ka përmbushur detyrat e tij funksionale.
- Nuk depozitoi dokumentacion provues/vlerësim performance që të faktonte pretendimin e saj kundrejt ankuesit për rezultate “jo-kënaqshëm” në punë.
- Nuk depozitoi asnjë shkresë ku të provohej fakti se ankuesi ishte vënë në dijeni dhe ishte njohur me vlerësimin “jokënaqshëm” për punën e tij, si dhe kishte patur mundësinë për t’u shprehur dhe mbrojtur efektivisht lidhur me këtë pretendim të Bashkisë, pretendim i cili i ishte bërë me dije ankuesit vetëm nëpërmjet urdhrimit të lirimimit nga shërbimi civil.
- Nuk vuri në dispozicion dokumentacion ku të evidentoheshin dëmet e pretenduara financiare që i kishin ardhur Bashkisë si rezultat i performancës së tij të dobët në punë.
- Megjithëse Bashkia është shprehur se përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil me ankuesin ka ardhur në mbështetje të pikave 6 dhe 7 të nenit 50 dhe pikës a/1 të nenit 66, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, pra, si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, në pjesën urdhëruese të saj, ka cilësuar se lirimi nga shërbimi civil ka ardhur “për rezultate jokënaqshëm në punë”, të tij. Komisioneri vlerëson se argumentimi i Bashkisë është konfuz, kontradiktor dhe tërësisht i pabazuar në ligj.
- Bashkia nuk paraqiti asnjë provë se ndërprerja e marrëdhënieve të punës/lirimi nga shërbimi civil me ankuesin ishte ristrukturimi, sikundër citohet shprehimisht tek baza ligjore mbi të cilën është mbështetur lirimi i ankuesit, dhe as provoi e dokumentoi faktin se lirimi nga shërbimi civil i ankuesit kishte ardhur “për rezultate jo kënaqshëm në punë”.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se lirimi nga shërbimi civil i ankuesit është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin/Bashkinë me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia nuk arriti të provojë motivacionin e lirimimit nga shërbimi civil, qoftë për sa i përket performancës së dobët, rezultateve jokënaqshëm në punë, mosrealizimit të detyrave funksionale apo dëmin financiar të shkaktuar nga ankuesi kundrejt punëdhënësit.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për lirimin e ankuesit nga shërbimi civil, rezultuan të paprovuara. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Selenicë.

Komisioneri ka gjykuar se veprimet e punëdhënësit/Bashkisë në dëm të subjektit ankues kanë ardhur pas ndërrimit të titullarit të Bashkisë, pas zgjedhjeve vendore 2019.

Në përfundim të analizimit e vlerësimit të rrethanave, parashtrimeve, fakteve e provave të depozituara nga palët, Komisioneri ka konstatuar se Bashkia Selenicë ka diskriminuar subjektin ankuesi në të drejtën e tij për punësim, pasi lirimi i tij nga shërbimi civil nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm por është bërë për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit ankuesit K.K., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Selenicë.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Selenicë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

22. F.Rr., kundër Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë

VENDIM NR. 165, DATË 13.09.2021

Shkaku: Bindje politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë në të drejtën për punësim për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar dhe aktivist i LSI.

FAKTET

Rezulton se F.Rr., ka qenë punonjës pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë dhe ka punuar në pozicionin e Përgjegjës të Burimeve Njerëzore pranë kësaj shoqërie. Ankuesi përgjatë datave 09-31.03.2020, ai ka qenë duke kryer lejen vjetore të parapambetur (të vitit 2019). Në vijim, ankuesi është urdhëruar të ndërpresë lejen vjetore të prapambetur e të rikthehet në punë.

Në vijim, ndaj tij është dhënë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” me motivacionin “*moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave*”. Më pas, është dhënë masa disiplinore “*zgjdhje e menjëherëshme e marrëdhënies së punës*” me motivacionin “*moskryerje e detyrave*”. Në të njëjtën datë, ai ka paraqitur pranë punëdhënësit ankimin administrativ, ku

kundërshton masat disiplinore të dhëna ndaj tij, duke kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë absolute të akteve dhe shfuqizimin e tyre. Punëdhënësi nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankimit të F.Rr., dhe në vijim ka urdhëruar lirim të tij nga detyra.

Ankuesi i ka kërkuar punëdhënësit akte provuese, mbi të cilat mbështetej vendimmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Berat-Kuçovë. Punëdhënësi i ka vënë në dispozicion F.Rr., vetëm procesverbalin e takimit të datës 01.04.2020, si dhe një kopje të aktit nëpërmjet së cilit është ngritur Komisioni Disiplinor.

Ankuesi pretendon se po diskriminohet nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Berat-Kuçovë për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar dhe aktivist i LSI. F.Rr., thekson faktin se Drejtori i Shoqërisë ka dijeni mbi bindjet e tij politike, pasi ankuesi ka patur aktivitet dhe angazhim politik si në të kaluarën për subjektin politik LSI, ashtu sikurse aktualisht. Ai sqaron se në zgjedhjet e ardhshme për pushtetin qendror, që do të zhvillohen në datën 25.04.2021, subjekti politik që ai përfaqëson e ka caktuar anëtar në KZAZ Nr. 66, në Berat.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokollin 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës³ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë;
- *“Karta Sociale Evropiane”* e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë, pasi ndaj ankuesit nuk janë zbatuar procedurat përkatëse nga ana e punëdhënësit për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”, si dhe zgjidhja e menjëherëshme të kontratës së punës nuk është kryer mbi shkelje konkrete të ankuesit, të cilat duhet të ishin të dokumentuara nga ana e shoqërisë në akte ligjorisht të vlefshme. Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe specifikisht referuar Kartës së Anëtarësimit, të lëshuar në datën 02.07.2013, rezulton se ankuesi F.Rr., është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Njëkohësisht, referuar Vërtetimit të datës 01.02.2021, të lëshuar nga subjekti politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” rezulton se ankuesi është anëtar i kësaj forcë politike me numër anëtarësie 49639 dhe ka marrë pjesë aktivisht në veprimtaritë në shkallë

³ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

kombëtare të organizuara nga kjo parti. Ai është aktivizuar publikisht nëpërmjet pjesëmarrjes në mitingje elektorale, takime politike në ambiente të hapura dhe salla të mbyllura, ka kryer anketime dhe publikime të programit të LSI, si dhe shpërndarjen e materialeve publikuese në terren.

Rezulton se aksioneri kryesor i Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., është Bashkia Berat, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, E.D. Ndërkohë që, rezulton se, edhe aksioneri tjetër i kësaj shoqërie, Bashkia Kuçovë, përfaqësohet nga Kryetari i Bashkisë, K.H., i cili është zgjedhur në këtë funksion në qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie nga Partia Socialiste e Shqipërisë, në kuadër të koalicionit Aleanca për Shqipërinë.⁴ Në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, është organi më i lartë vendim-marrës i Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë.

Në prapësimet e tij, Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., nuk e ka kundërshtuar ndonjëherë faktin se nuk ka dijeni mbi bindjet politike të ankuesit, por thekson faktin se shkak për largimin e tij të menjëhershëm nga puna nuk ka qenë bindja e tij politike, por shkeljet e kryera nga ana e tij Komisioneri konstatoi gjithashtu se nuk ekziston asnjë akt shkresor, ku shkeljet në fjalë të rezultojnë të materializuara apo dokumentuara.

Komisioneri vlerëson gjithashtu se moszbatimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore të sipërcituar, ka bërë të pamundur që ankuesi të paraqesë observacionet dhe shpjegimet e tij për të sqaruar situatën në tërësi dhe për t’u mbrojtur para punëdhënësit.

Në vijim të masës disiplinore, nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm Nr. 73, datë 01.04.2020, të Drejtorit të Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., F.Rr., i është dhënë masa vijuese disiplinore “Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënies së punës” me motivacion “moskryerje e detyrave” me rastet e përsëritjes së shkeljes. Komisioneri konstatoi se procesverbali i mbledhjes, i cili është akti mbi të cilin është mbështetur largimi nga puna, është i nënshkruar vetëm nga sekretarja e Arkivë-Protokollit, por jo nga pjesëmarrësit në mbledhje. Njëkohësisht, ky procesverbal nuk është i regjistruar dhe nuk mban numër protokollit. KMD vlerësoi se ky procesverbal nuk mund të konsiderohet si provë e vlefshme, mbi bazën e së cilës mund të vërtetohen shkeljet e kryera nga ankuesi.

Në vijim, Ujësjetllës Kanalizime Berat- Kuçovë sh.a., ka nisur sërish procedurat e largimit nga puna për F.Rr., pavarësisht akteve të mëparshme për largim të menjëhershëm nga puna që kishte nxjerrë paraprakisht për ankuesin. Aktualisht rezulton se kjo shoqëri nuk ka shpallur pavlefshmërinë e akteve të nxjerra si rrjedhojë e fillimit të këtyre procedurave për herë të dytë dhe për punonjësin rezultojnë dy procedura për largimin e tij nga puna.

Në rastin konkret bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Komisioneri gjykon se F.Rr., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Berat-Kuçovë.

⁴ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e sistemuar ankuesin në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij. Komisioneri çmon se sistemimi i ankuesit në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjestim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga LMD, i ndryshuar, nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të F.Rr., për shkak të bindjes politike, nga Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., të marrë masa për sistemimin e ankuesit në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij.

23. S.L., kundër Bashkisë Vau i Dejës

VENDIM NR. 203, DATË 15.10.2021

Shkaku: Bindje politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

S.L., është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës i cili ka zgjidhur kontratën e tij të punës, pa asnjë shkak të justifikuar përveçse atij politik.

FAKTET

Sipas shpjegimeve nkuesi ka punuar prej 6 vitesh në pozicionin e edukatorit pranë Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”, Vau i Dejës, Shkodër. S.L., pretendon se gjatë gjithë periudhës që ka punuar në këtë pozicion pune, ka patur vlerësime pozitive për punën e kryer dhe ndaj tij nuk është dhënë ndonjë masë disiplinore.

Në vijim, ankuesi njoftohet për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, brenda një afati 2 mujor, duke filluar nga momenti i marrjes dijeni mbi shkresën e sipërcituar⁵.

⁵ Marrja dijeni nga ana e S.L., pretendohet se ka qenë në datën 15.01.2021.

S.L., pretendon se nuk ka asnjë motivacion tjetër për zgjidhjen e kontratës së tij të punës, përveçse atij politik, duke arsyetuar se ai është anëtar dhe aktivist i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, dhe si i tillë diskriminohet për shkak të bindjeve të tij nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, i cili është përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste. Ndër të tjera, ankuesi pretendon se i është bërë presion në mënyrë të vazhdueshme për të votuar për subjektin politik Partia Socialiste dhe për një kandidat të kësaj force politike, por ai nuk ka pranuar. Ankuesi pretendon gjithashtu se në vendin e tij është emëruar një punonjëse, që nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë dhe nuk ka kualifikimet e S.L.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), neni 5;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

KONKLUZIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Bashkisë Vau i Dejës, pasi atij i është zgjidhur kontrata e punës dhe është larguar nga pozicioni i punës “kujdestar konvikti” pa asnjë motivacion dhe në kushtet kur, struktura e Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “Ndre Mjeda”, Bushat, nuk ka ndryshuar dhe numri i pozicioneve të kujdestarëve nuk është suprimuar, por është i njëjtë me strukturën paraardhëse. Njëkohësisht, në vend të tij është emëruar një punonjëse e re.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe specifikisht referuar Kartës së lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, rezulton se ankuesi S.L., është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike. Njëkohësisht, në referencë të dy Kartave të Anëtarësimit të lëshuara nga Partia Demokratike, rezulton se ankuesi ka qenë anëtar i Kuvendit Kombëtar të kësaj force politike. Rezulton gjithashtu se ankuesi, i cili është banor i fshatit Pleshë, Njësia Administrative Bushat, mban edhe pozicionin e sekretarit të grup/seksionit Bushat Dega, Vau i Dejës.

Komisioneri çmon se Bashkia Vau i Dejës ka patur dijeni mbi përkatësinë politike të ankuesit, pasi në asnjë shkresë të dërguar nga ana e saj në adresë të KMD-së, nuk është mohuar një fakt i tillë, ndërkohë që është fakt i njohur që Kryetari i kësaj Bashkie është përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste. Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se në bashki të tilla si ajo e Vaut të Dejës, ku

numri i popullsisë nuk është i madh, banorët e njohin mirë njëri tjetrin dhe kanë dijeni mbi përkatësinë politike të njëri tjetrit⁶.

Njëkohësisht, Bashkia Vau i Dejës në asnjë rast nuk e ka justifikuar me fakte dhe prova të mbështetura, largimin nga puna të ankuesit. Largimi i tij nga puna është justifikuar për efekt të ristrukturimit të institucionit, ndërkohë që rezulton se në bazë të Vendimit Nr. 79, datë 24.12.2020, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrative të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2021” nuk ka patur ndryshime strukturore në Konviktin e Shkollës së Mesme Kombëtare “Ndre Mjeda”, Bushat dhe numri i punonjësve është i njëjtë.

Njëkohësisht, në Aktin Nr. 324 Prot., datë 29.12.2020, “Raport i Komisionit të Ristrukturimit mbi zhvillimin dhe realizimin e procedurës së ristrukturimit dhe sistemimit të nëpunësve civilë në administratën e Bashkisë Vau i Dejës dhe Njësive Administrative në varësi, bazuar në strukturën e re organizative” është raportuar se ekzistojnë disa vende vakante në strukturën e Bashkisë Vau i Dejës. Për sa më sipër, në këtë Raport është evidentuar se për vitin 2021, ekzistojnë 16 vende të lira pune në nivel ekzekutiv dhe 18 vende të lira pune në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues pranë këtij institucioni, fakt që dëshmon për rritje të numrit të pozicioneve të punës. Por, pavarësisht tyre, ankuesi është larguar nga puna dhe nuk është sistemuar në punë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se S.L., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të S.L., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Vau i Dejës.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për sistemimin e ankuesit në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij.

24. F.B., kundër Bashkisë Berat

VENDIM NR. 211, DATË 29.10.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

F.B., është diskriminuar në të drejtën e tij për punësim nga Bashkia Berat për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi sqaron se ka punuar pranë Bashkisë Berat, që prej muajit shkurt të vitit 2014, në pozicione të ndryshme pune⁷. Përgjatë periudhës 01.02.2014 - 31.12.2014, F.B., ka punuar në pozicionin e inspektorit të tatim taksave të pasurisë dhe taksës bujqësore. Në vijim, nga data 01.02.2015 deri në datën 01.01.2017 ka punuar pranë kësaj Bashkie si specialist taksash dhe tarifash, në Rajonin Nr. 2. Më pas, përgjatë periudhës 01.01.2017 - 18.04.2017, ai ka punuar si agjent i taksave dhe tarifave pranë këtij institucioni.

Në datën 19.04.2017, F.B., është emëruar Administrator i lagjes Nr. 2, të Bashkisë Berat, ku ka vijuar të punojë deri në datën 06.08.2019, pasi nëpërmjet Urdhërit Nr. 567, datë 05.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, ankuesi është shkarkuar nga detyra, pa asnjë motivacion.

F.B., sqaron se është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe arsyeja e largimit të tij nga puna ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me bindjet e tij politike, pasi Kryetari i Bashkisë Berat që ka ardhur në detyrë pas zgjedhjeve vendore të vitit 2019, është përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁸ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”;
- “*Karta Sociale Evropiane*” e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Bashkisë Berat, pasi atij i është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të menjëherëshme dhe është shkarkuar nga detyra e Administratorit të Lagjies nr. 2, të Njesisë Administrative Berat, pa asnjë motivacion, nëpërmjet Urdhërit Nr. 567, datë 05.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat. Vetëm 3 ditë, pas shkarkimit të ankuesit, në ish-pozicionin e tij të punës është emëruar J.M.

Bindjet politike të ankuesit vertetohen mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri çmon se Bashkia Berat ka patur dijeni mbi përkatësinë politike të ankuesit.

⁷ Referuar librezës së punës, ankuesi ka filluar punë që prej vitit 2006, por me një shkëputje 1 mujore nga puna.

⁸ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

Bashkia Berat në asnjë rast nuk e ka justifikuar me fakte dhe prova të mbështetura, largimin nga puna të ankuesit, në kushtet kur, në Urdhërin Nr. 567, datë 05.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat është vendosur zgjidhja e kontratës së tij të punës dhe në të nuk ka asnjë motivacion për largimin e tij.

Komisioneri gjykon se prezenca në punë e punonjësve të tjerë që mund të kenë bindje dhe anëtarësi opozitare me titullarët e subjektit politik në pushtet nuk përbën fakt bindës se largimi nga puna i F.B., nuk është bërë për shkak të bindjeve politike.

Lidhur me pretendimin e Bashkisë Berat se marrëdhënia e punës ndërmjet Kryetarit të Bashkisë Berat dhe Administratorëve të Njësive Administrative është e vecantë dhe jo e njëjtë me punonjësit e tjerë të administratës së bashkisë, KMD gjykon se funksionet e administratorëve të lagjeve janë funksione të natyrës administrative, të cilat e bëjnë njësinë e lagjies, pjesë përbërëse të strukturës administrative të Bashkisë Berat.

Njëkohësisht, vëmë në dukje se sipas strukturës dhe organikës së Bashkisë Berat, të miratuar me Vendimin Nr. 827, datë 15.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë Berat, *“Për miratimin e strukturës dhe organigramës së bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2021”*, rezulton se administratorët e njësive administrative dhe ato të lagjeve nuk janë pjesë përbërëse e kabinetit të Kryetarit, anëtarët e së cilit, për analogji me parashikimet e Vendimit Nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”* kanë status politik dhe marrëdhënia e tyre e punës është e një natyre të veçantë.

Administratorët janë punonjës që nuk gëzojnë status të veçantë, i cili e bën punësimin e tyre, të lidhur dhe të kushtëzuar me qëndrimin në detyrë ose jo të Kryetarit të Bashkisë.

Në kushtet kur, ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me Ligjin Nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret, bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Komisioneri gjykoi se F.B., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Berat.

Nëpërmjet këtij parashikimi ligjor, në rastet kur konstatohet se ndërprerja e marrëdhënies të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit, një nga mënyrat e dëmshpërblimit është rikthimi i punonjësit në gjendjen e mëparshme. Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit. Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuesit konsiston pikërisht në

përfundimin e marrëdhënies së punës dhe largimin e saj nga puna. Si rrjedhim, edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e sistemuar ankuesin në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij. Komisioneri çmon se sistemimi i ankuesit në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjestim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të F.B., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Berat.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të F.B., për shkak të moshës, nga Bashkia Berat.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Berat të marrë masa për sistemimin e ankuesit në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij.

25. M.Xh., kundër Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme

VENDIM NR. 243, DATË 14.12.2021

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është pezulluar nga struktura e shërbimit, ku bën pjesë, si pasojë e procedimit penal të filluar ndaj saj dhe të marrjes në cilësinë e të pandehurës, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Edhe pse akuzat ndaj saj janë rrëzuar me Vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, urdhëri i pezullimit të saj nuk është shfuqizuar dhe ankuesja nuk është rikthyer në detyrën e saj, të mëparshme duke u diskriminuar për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja ka punuar në pozicionin e inspektorit të parandalimit, pranë Sektorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, pranë Bashkisë Berat. Në vijim, ajo është emëruar Shefe pranë të njëjtit Sektor dhe më pas është

komanduar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, pranë Bashkisë Berat.

Ankuesja është pezulluar nga struktura e shërbimit, ku bën pjesë, si pasojë e procedimit penal të filluar ndaj saj dhe të marrjes në cilësinë e të pandehurës, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Akuzat ndaj saj janë rrëzuar me Vendimin Nr. 72, datë 29.04.2021, e Gjykatës së Apelit Vlorë. Pavarësisht sa më sipër, urdhëri i pezullimit të saj nuk është shfuqizuar dhe ankuesja nuk është rikthyer në detyrën e saj, të mëparshme. M.Xh., pretendon zbatimin e dy standardeve nga ana e subjekteve përkatëse, pasi punonjës të tjerë të larguar nga puna, janë rikthyer në punë, edhe pse çështjet gjyqësore në ngarkim të tyre nuk kanë përfunduar ende, ndërkohë që ajo mbetet ende e pezulluar edhe pse me vendim gjyqësor është pushuar procedimi penal ndaj saj.

Për këtë arsye, ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të bindjes politike të saj. M.Xh., thekson faktin se nuk është marrë me aktivitet politik, por i përket shtresës së të përndjekurve politikë, duke nënkuptuar bindjet e saj të djathta, si dhe është kryetare e Shoqatës Kombëtare të të Pushkatuarve, të Dëbuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve Politike, në qarkun Berat.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar. (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005), *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, dhe *D.H., and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007);
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁹ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” i ndryshuar;
- Ligji Nr.139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9385/2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pasi Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së për pezullimin e saj nga detyra nuk është shfuqizuar edhe pse procedimi penal në ngarkim të saj është pushuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

⁹ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

Përsa i përket bindjeve politike të ankueses, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përkatësisht vendimit Nr. 3382, datë 29.09.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilës është kryer regjistrimi i personit juridik “Shoqata Kombetare e të Pushkatuarve, të Dëbuarve, të Internuarve dhe të Përndjekurve politikë”, rezulton se ankuesja është anëtare themeluese dhe Kryetare e kësaj shoqate. Në vitin 2013, ajo ka qenë e zgjedhur si kandidate për deputete për Qarkun Berat, si përfaqësuese e Partisë Balli Kombëtar Demokrat, me sigël “PBKD”. Në këto zgjedhje, ky subjekt politik ka garuar në koalicionin e djathtë Aleanca për Punësim, Mirëqënie dhe Integrim. Edhe në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25.04.2021, ky subjekt politik ka qenë pjesë e Aleancës për Ndryshim, ku sërishit bënin pjesë forcat politike të djathta. Ky fakt që përforcon bindjen e KMD-së për kahun e djathtë të bindjeve politike të ankueses M.Xh. Për sa më sipër, rezulton se Kryetari i Bashkisë Berat, E.D., është zgjedhur në këtë funksion, në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga Partia Socialiste e Shqipërisë, në kuadër të koalicionit Aleanca për Shqipërinë¹⁰.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së ka tagrën e institucionit vendimarrës, lidhur me çështjen e shkarkimit dhe pezullimit të M.Xh.

Nga hetimi administrativ rezultoi se ky institucion pavarësisht se u informua zyrtarisht nga ana e ankueses, mbi vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Vlorë, nëpërmjet së cilës ankuesja lirohej nga akuza për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, sërishit nuk veproi për të shfuqizuar urdhërin e pezullimit të saj apo të kryente përpjekje institucionale për t’u informuar nga organet gjyqësore mbi këtë vendimmarrje, si dhe të vinte në veprim Bashkinë Berat, për të iniciuar procedurën për të shfuqizuar Urdhërin e DPMZSH-së.

Për sa më sipër, Bashkia Berat në asnjë rast nuk e ka justifikuar me fakte dhe prova të mbështetura, vazhdimin e pezullimit të ankueses tej momentit të daljes së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për pushimin e procedimit penal në ngarkim të saj.

Komisioneri ka gjykuar se shfuqizimi i Urdhërit Nr. 330/2020, të DPMZSH-së duhej kryer në muajin maj 2021, moment në të cilin procedimi penal Nr. 576/2019 në ngarkim të ankueses, është pushuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe jo në muajin tetor 2021, pra rreth 5 muaj më vonë. Në kushtet kur, ndaj ankueses po shqyrtohej hetimi Nr. 600/2018 nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, DPMZSH mund të miratonte akt vijues për pezullim në detyrë, por jo të përdorte në vijimësi një akt, i cili nuk kishte si objekt këtë procedim penal ndaj ankueses. Hetimi i sipërcituar ka patur të njëjtin person të kallëzuar, objekt të njëjtë dhe subjekte të njëjta kallëzuese. Në këto kushte, me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, ky procedim penal është pushuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Përveç sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se në momentin, kur në ngarkim të ankueses nuk ekzistonte më asnjë akuzë penale dhe duhej kryer menjëherë shfuqizimi i urdhërit të pezullimit të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, mbështetur në shkresën Nr. 4825, datë 28.09.2021, të

¹⁰ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al.

Kryetari të Bashkisë Berat me lëndë “*Kërkesë për largim nga detyra për punonjësen M.Xh.*”, ankuesja është shkarkuar nga detyra nëpërmjet Urdhërit Nr. 6427/1, datë 18.10.2021, të këtij titullari.

Motivacioni i largimit të saj nga detyra ka qenë i njohur edhe më parë nga institucionet përkatëse, të cilët vetëm në muajin tetor 2021, e kanë shkarkuar ankuesen. Në këtë kontekst, Komisioneri ka vënë re tendencën negative të institucioneve të sipërcituara ndaj ankueses, duke përshkallëzuar veprimet e tyre ndaj saj, deri në largim nga puna.

Komisioneri konstaton se fillimisht ankuesja është liruar nga detyra e në vijim, është shfuqizuar akti i pezullimit të saj, për shkak të akuzës penale që ka patur në ngarkim.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja është diskriminuar për shkak të bindjes së saj politike, pasi është supozuar se ka bindje të djathta, pasi i përket shtresës së të përndjekurve politikë, nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të M.Xh., për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, pranë Ministrisë së Brendshme.

IV. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE

26. M.Q., kundër Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë Tiranë

VENDIM NR. 135, DATË 22.07.2021

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë dhe gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja është diskriminuar nga parashikimi i VKM Nr. 780, datë 26.12.2018, përmes mohimit të përfitimit të përgjysmimit të tarifës studimore, krahasuar me studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në universitetet publike, pavarësisht se plotësonte kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), pikërisht për faktin se ajo kishte diplomë bachelor të një universiteti jopublik/privat.

FAKTET

Subjekti ankues, ka përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë pranë Fakultetit të Shkencave Humane, në Kolegjin Universitar Jopublik dhe zotëron diplomën “Bachelor” në Shkenca Komunikimi, me mesatare 9.2.

VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”, pika 1/f shprehimisht citon se: “Studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të miratuar nga institucionet e arsimit të lartë publik: f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)”.

Ankuesja ka aplikuar pranë Fakultetit për të përfituar nga kjo VKM, duke qenë se plotësonte kriterin e mesatares 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) por nuk është klasifikuar përfituese pasi Fakulteti i ka komunikuar se kjo VKM, zbatohet vetëm për kategorinë e studentëve që kanë mesataren e kërkuar por që njëherësh kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në universitetet publike.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolle 12 i saj;
- “Karta Sociale Evropiane”, e rishikuar;

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969);
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së, çështja Ponomaryovi kundër Bullgarisë, me kërkesues A.Ponomaryov dhe V.Ponomaryov;
- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”.

KONKLUZIONE

Në analizë të informacionit të administruar, Komisioneri konstatoi se:

VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”, në pikën 1, germa f) të tij përcakton se: “1. Studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve, të miratuar nga institucionet e arsimit të lartë publik: ... f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).”

Në pikën 2, të kësaj VKM-je përcaktohet se: “Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi, paguajnë tarifën vjetore të studimeve në masën 50%, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë”.

Komisioneri vlerësoi se:

Fakulteti, në praktikën e ndjekur lidhur me pagesat e tarifave vjetore në masën 50%, për studentët që përfitonin nga parashikimi ligjor i pikës 1, germa f) të kësaj VKM-je, ka zbatuar përcaktimet ligjore të këtij akti, të cilat janë detyruese për të. Në këtë kontekst, Fakulteti nuk ka trajtuar në mënyrë diferencuese subjektin ankues, për sa kohë ky diferencim nuk vjen nga mënyra apo procedura e ndjekur për zbatimin e tij, por nga vetë akti, të cilin ka qenë i detyruar ta zbatojë.

Lidhur me kriterin e vendosur, në germën f), të pikës 1, të VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”, Komisioneri gjykon se institucioni përgjegjës, për nxjerrjen e këtij akti është Këshilli i Ministrave.

Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe më pak i favorshëm, krahasimisht për dy kategoritë e studentëve, prezumohet se ka ardhur pikërisht si rezultat i zbatimit të këtij akti nënligjor.

Komisioneri konsideron se, parashikimi i lehtësive financiare, për kategorinë e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e dytë, dhe kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve me mesatare vjetore 9 (nëntë) – 10 (dhjetë) është një masë pozitive me qëllimin për të nxitur dhe siguruar një arsim cilësor, mirëpo nuk është gjithëpërfshirës. Kjo për shkak se, përcaktimi i bërë në pikën 1, germa f) e VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 *“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”*, trajton haptazi në mënyrë të diferencuar dhe të pabarabartë kategorinë e studentëve që ndjekin ciklin e dytë të studimeve në IAL Publike dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, nga kategoria e studentëve që ndjekin studimet në IAL publike dhe kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Publike, pasi kriteri i mesatares duhet përmbushur nga të dyja kategoritë e studentëve.

Në analizë të parashtrimeve të KM-së është argumentuar si qëllim kryesor legjitim, detyrimi dhe për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve publike të arsimit të lartë me fonde nga buxheti i shtetit, me qëllim për të siguruar arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, në kuadër të politikës së përgjithshme shtetërore.

Nga krahasimi i bërë ndërmjet këtyre dy kategorive përfituese të studentëve, Komisioneri konstaton se pikërisht parimi i gjithëpërfshirjes nuk është zbatuar në këtë rast.

Gjithashtu, nga analiza e të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, evidentohet se parimi që i udhëheq është se, politika kombëtare/shtetërore promovon në thelb trajtimin e barabartë në çështje, që lidhen me edukimin.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Komisioneri, trajtimin që VKM-ja i bën dy kategorive të studentëve, objekt krahasimi në këtë çështje, nuk e gjen të mbështetur në parimin për trajtim të padiferencuar dhe të barabartë.

Përjashtimi dhe diferencimi që VKM-ja sipërcituar u bën kategorisë së studentëve të IAL Jopublike/Private, bazuar vetëm në faktin se kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve të larta, në këto institucione jopublike/private, është në kundërshtim me frymën dhe parashikimet në legjislacionin për arsimin e lartë.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se:

Përcaktimi i bërë në germën f) të pikës 1, të kësaj VKM-je, nuk përlij faktin se vendosja kriterit përjashtues të tarifës vjetore të studimeve në masën 50%, për studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet jopublike/private të arsimit të lartë, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe të justifikuara objektivisht.

Komisioneri gjykoi se kriteri përcaktues sipërcituar, për përfitimin e pagesës së tarifës vjetore të studimeve në masën 50% të saj, lidhet domosdoshmërisht me faktin që studentët që ndjekin ciklin e dytë të studimeve të larta, duket të kenë mbaruar ciklin e parë të studimeve të larta në IAL Publike, (pavarësisht faktit se kriteri i mesatares (9-10) është i njëjtë dhe plotësohet nga të dyja

kategoritë njëlloj), dhe ka karakter diskriminues ndaj studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, duke i trajtuar haptazi ata në mënyrë të diferencuar dhe të pabarabartë.

Komisioneri vlerësoi se, *diferenca në trajtim e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) – 10 (dhjetë) në IAL Publike dhe ndjekin ciklin e dytë të studimeve po në IAL Publike, me studentët që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) – 10 (dhjetë) në IAL JoPublike/Private dhe ndjekin ciklin e dytë të studimeve në IAL Publike;*... nga ana e KM nëpërmjet pikës 1/f, të VKM-së sipërcituar, nuk ndjek një qëllim të ligjshëm dhe si pasojë nuk justifikohet objektivisht.

Komisioneri gjykoi se ankuesja, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues nga ana e VKM-së, lidhur me përfitimin nga përgjysmimi i tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL, nëpërmjet vendosjes së kriterit që studentët përfitues duhet domosdoshmërisht të kenë mbaruar ciklin e parë të studimeve në IAL Publike. Përcaktimi i bërë në gërmën f), të pikës 1, të VKM në fjalë, i vë haptazi në pozita të pafavorshme ankuesen dhe gjithë kategorinë e studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL Jopublike/Private, me mesatare nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), për shkak të gjendjes së tyre arsimore, duke i ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pa përligjur objektivisht, si dhe në kundërshtim me frymën dhe parashikimet e vetë Ligjit Nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*.

Komisioneri vlerësoi që, në gërmën f), të pikës 1, të kësaj VKM-je të hiqet fjala “publike”, dhe të reflektohet ndryshimi si më poshtë: *“Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)”*.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, M.Q., dhe gjithë kategorisë së studentëve, të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve të larta në IAL Private, me mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), dhe ndjekin ciklin e dytë të studimeve të larta në IAL Publike, për shkak të “gjendjes arsimore”, nga përcaktimi i pikës 1/f, të VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 *“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”*, nga ana e Këshillit të Ministrave.
- Komisioneri kërkoi nga Këshilli i Ministrave të rishikojë VKM-në Nr. 780, datë 26.12.2018 *“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në insitucionet publike të arsimit të lartë”*, duke ndryshuar gërmën f), të pikës 1, të saj.

27. B.I., kundër Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës

VENDIM NR. 94, DATË 31.05.2021

Shkaku: Gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues, pasi ka aplikuar pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë për të ndjekur ciklin e dytë të studimeve Master, është shpallur fitues vetëm në programin e studimeve Master Profesional Publik dhe jo në programin Master Shkencor Civil, duke u diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, në fushën e arsimit, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë në UT.

FAKTET

Ankuesi, ka përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Në vijim, ka aplikuar pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë për të ndjekur ciklin e dytë të studimeve Master dhe si preferencë të parë ka vendosur programin Master Shkencor Civil. Në përfundim, është shpallur fitues vetëm në programin e studimeve Master Profesional Publik dhe jo në programin Master Shkencor Civil.

Situata e mësipërme dhe skualifikimi i tij, ka ardhur si pasojë e urdhërit Nr. 40, datë 30.09.2020, të Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, në të cilin janë përcaktuar kriteret e pranimit të aplikimeve për ndjekjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë në vitin akademik 2020-2021. Në përmbajtje të urdhërit të sipërcituar, është vendosur që: *“Kuotat fillestare do të plotësohen duke u dhënë prioritet aplikantëve që kanë përfunduar studimet ‘Bachelor’ në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si dhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet ‘Bachelor’ në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.*

Kuotat e paplotësuara nga kategoria e mësipërme, do të plotësoheshin nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në degën Drejtësi; si edhe në degën “Ekonomi” për “Master Profesional EU Business Law.

Kuotat e paplotësuara nga kategoritë e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera jopublike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në degën Drejtësi.

Pra, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, janë përzgjedhur fillimisht si kandidat fitues, aplikantët që kanë përfunduar studimet Bachelor në këtë fakultet dhe ata jashtë vendit, e më pas i është dhënë mundësia kandidatëve që vijnë nga fakultete të tjera të Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera të Shqipërisë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim miratuar në 1960 (Konventa e UNESCO-s);
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969);
- Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut (1948);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr. 17, datë 30.07.2019 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019 ‘Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”;
- Statuti i Universitetit të Tiranës;
- Rregullorja e Universitetit të Tiranës.

KONKLUZIONE

Në rastin konkret, Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, nëpërmjet Urdhrit Nr. 40, datë 30.09.2020, ka përcaktuar kriteret e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, nëpërmjet të cilave u ka dhënë prioritet fillimisht aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit, e në përfundim kuotat e paplotësuara nga kategoritë e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin Drejtësi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi që Urdhri Nr. 40, datë 30.09.2020 i Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës nuk është në një linjë me Rregulloren e Universitetit të Tiranës, miratuar me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, i cili nuk bën diferencim në faktin se në cilin Universitet kanë mbaruar studimet kandidatët, por bazohet vetëm në kriterin e mesatares, kriter i përligjur ky edhe nga akte të tjera ligjore duke nisur që nga Kushtetuta e RSH-së.

Kushtëzimi me faktin që duhet të kesh përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve pranë FDUT-së, do të sillte si pasojë detyrimin e studenteve që preferojnë të vazhdojnë studimet master pranë FDUT, që medoemos të ndjekin studimet e ciklit të parë pranë këtij Fakulteti.

Në këtë kontekst, nga ana e FDUT-së, nuk u paraqitën fakte, prova që të tregojnë para Komisionerit se ku është mbështetur Fakulteti për të arritur në përfundimin se trajtimi i barabartë i të gjithë studentëve, pavarësisht ku ata kanë studiuar, duke u bazuar vetëm në merita, siç është nota mesatare, çënon cilësinë e tij. Përkundrazi Komisioneri vlerëson faktin se mbështetja tek kriteri i notës mesatare do ishte një arsye që do çonte në rritjen e cilësisë.

Sa më sipër Komisioneri vlerësoi se kufizimet e bazuara në faktin që studentët kanë mbaruar apo jo studimet e ciklit të parë pranë FDUT, nuk janë proporcionale me qëllimin që mendohet të arrihet. Si pasojë këto kritere vlerësohen si diskriminuese.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se ankuesi, diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të gjendjes së tij arsimore, përmes vendosjes së kriterit që aplikantët duhet të jenë të diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në Fakultetin e Drejtësisë të UT, duke sjellë skualifikimin e tij për programin e preferuar të ciklit të dytë të studimeve.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të gjendjes arsimore, në fushën e arsimit, të B.I., nga ana e Fakultetit të Drejtësisë në UT.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të vendbanimit, të B.I., nga ana e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë në UT.
- Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Drejtësisë të marrin masat për hartimin e kritereve për programet e ciklit të dytë të studimeve në mënyrë që aplikantët të konkurojnë në kushte të barabarta dhe bazuar në kritere aftësie.

V. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË SHTATZËNISË

28. R.T., kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

VENDIM NR. 145, DATË 06.08.2021

Shkaku: Shtatëzënia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

R.T., është larguar nga puna gjatë kohës që ishte me leje barrëindjeje, duke e diskriminuar atë për shkak të shtatëzënisë.

FAKTET

R.T., në datë 16.09.2016, ka lidhur marrëdhëniet e punës me ish-ZQRPP dhe ka nënshkruar disa kontrata Individuale të punës, me kohëzgjatje të përkohshme, në detyrën e Specialistes në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Marrëdhënia e punës ndërmjet ankueses dhe ASHK-së, është rinovuar kështu disa herë dhe ka vazhduar për gati 4 vite, pavarësisht se kontratat nga ana e ASHK janë bërë me afate të shkurtra me justifikimin e kohëzgjatjes së projekteve.

Referuar Raportit për Leje Barrëindje ankuesja, R. T., është trajtuar me leje paralindje, nga data 16.10.2019 - 19.11.2019. Ndërkohë kontrata e punës midis R.T., dhe ASHK ka përfunduar me përfundimin e afatit të kontratës, me datë 15.11.2019, pra gjatë periudhës që ajo ka qenë me raport barrëindjeje, të paguar nga DRSSH Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Nr. 183 “Mbrojtja e amësisë, 2000”, ratifikuar me Ligjin me Nr. 8829, datë 05.11.2001, nga Republika e Shqipërisë;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Direktiva e Këshillit të Evropës 2000/78/KE;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

KMD bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe provave, arriti në përfundimin që kemi të bëjmë me një trajtim të pafavorshëm dhe të paligjshëm të saj nga ana e ASHK-së.

Pavarësisht faktit që sipas ASHK-së ndërprerja e Kontratës Individuale të Punës, ka ardhur pas përfundimit të saj, Komisioneri vërejti se zgjidhja e marrëdhënieve të punës gjatë kohës së shtatzënisë, ka ndodhur në kohë të papërshtatshme.

Nga ana e ASHK-së, nuk u vunë në dispozicion prova dhe argumente me anë të të cilave Komisioneri të konstatojë faktin se në ASHK, nuk ka patur pozicione të lira pune, në të cilat mund të emërohej ankuesja, pas përfundimit të lejes së shtatzënisë. Gjithashtu, nga ana e ASHK-së nuk u vu në dispozicion të Komisionerit informacion nëse projekti në të cilin ishte e punësuar më parë ankuesja kishte përfunduar dhe rikthimi në punë i saj ishte bërë i pamundur.

Referuar informacionit të administruar, gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, pas largimit të ankuses nga puna, në ASHK kanë vijuar emëtime të reja të punonjësve dhe projekti nuk është ndërprerë.

Në kushtet kur, nga ana e ASHK-së nuk u arrit të provohej që vendimmarrja e saj është e drejtë dhe e bazuar në ligj, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës gjatë kohës që ankuesja ishte me leje barrë lindjeje, dhe nga ana tjetër ankuesja provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm, nga ana e ASHK-së, pikërisht për shkakun e pretenduar prej saj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, R.T., për shkak të “shtatzënisë”¹¹, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me kërkesën e paraqitur nga R.T., për punësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

¹¹ Lejes së lindjes, ardhur si pasojë e shtatzënisë së saj.

VI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË

29. V.G., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës

VENDIM NR. 93, DATË 28.05.2021

Shkaku: Gjinia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Vendim me gjobë

Ankuesja është diskriminuar për shkak të gjinisë në të drejtën për punësim, pasi është transferuar nga ana e punëdhënësit.

FAKTET

Ankuesja ishte punonjëse e Policisë së Shtetit prej rreth 24 vitesh. Në muajin Mars 2019, ka konkuruar dhe përfunduar trajnimin e gradës policore “Komisar”, në Akademinë e Sigurisë.

Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri është vënë në dijeni se ankuesja është thirrur nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPP për të diskutuar rreth fitimit të gradës policore “Komisar” dhe emërimit në një nga pozicionet e lira të punës. Gjatë takimit të zhvilluar në DPP, ankuesja është bërë me dije se në DVP Durrës, nuk kishte pozicione të lira që korrespondojnë me gradën “Komisar” dhe nëse ajo do të binte dakord, mundësia për të fituar gradën ishte transferimi në një Drejtori Vendore tjetër, ku ka vende të lira. Në këto kushte, ankuesja pavarësisht faktit se nuk ka dashur të transferohet në një drejtori tjetër vendore, ka rënë dakord me transferimin kudo që të jetë në të gjithë territorin e Shqipërisë, me kushtin që të fitojë gradën “Komisar”. Për këtë, ajo ka nënshkruar edhe një shkresë ku ka pranuar transferimin me kushtin e fitimit të gradës policore “Komisar”.

Në këtë kuadër, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ankueses i është dhënë grada policore “Komisar” dhe për nevoja pune është transferuar, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

Gjithashtu, në kushtet, që ka qënë e detyruar nga situata në të cilën ndodhej, ka pranuar që të emërohet kudo në strukturat e Policisë së Shtetit në të gjithë territorin e Shqipërisë, me kushtin që të përfitojë edhe gradën “Komisar”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut (1948),
- Konventa e OKB-së “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”;

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore (2004);
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016-2020 dhe Plani i saj i Veprimit;
- Rregullorja e Policisë së Shtetit (miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015).

KONKLUZIONE

Refruar informacionit të administruar, nga ana e DPP-së apo DVP-së Durrës, nuk u vunë në dispozicion prova dhe fakte me anë të të cilave Komisioneri të konstatojë faktin se në DVP Durrës, nuk ka patur pozicione të lira pune për gradën “Komisar”, në të cilat mund të emërohej ankuesja, në mënyrë që KMD të mund të gjykonte që mos emërimi i saj dhe transferimi në DVP Lezhë të kishte ardhur për arsye të përligjura dhe të justifikuara.

Rezultoi se para dhe pas transferimit të ankueses në DVP Lezhë, ka patur pozicione të lira pune për gradën policore “Komisar” në DVP Durrës, në të cilat nuk është emëruar ajo, por janë emëruar punonjës meshkuj. Një ndër rastet konkrete, është dhe ai i transferimit nga DVP Fier në DVP Durrës, në një pozicion pune që përkon me gradën policore “Komisar”, i një punonjësi mashkull, i cili ka përfunduar konkurimin për gradën policore “Komisar” në të njëjtën kohë me ankuesen dhe ky pozicion nuk i është ofruar ankueses.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, DPP dhe DVP Durrës dështuan të provonin përpara Komisionerit se:

- Mosemërimi i ankueses në një pozicion të lirë në DVP Durrës, kishte ardhur si rezultat i mungesës së pozicioneve vakante në këtë drejtori vendore;
- Ankueses i është kthyer përgjigje në vijimësi nga ana e DPP-së dhe DVP-së Durrës, lidhur me kërkesat e saj për emërimin në një pozicion pune në DVP Durrës, i cili të përkonte me gradën policore “Komisar”;
- Transferimi në DVP Lezhë kishte ardhur si rezultat i mungesës së pozicioneve të lira të punës për gradën policore “Komisar”, në DVP Durrës;
- Transferimi nga DVP Fier në DVP Durrës, në një pozicion pune që përkon me gradën policore “Komisar”, i një punonjësi mashkull, i cili ka përfunduar konkurimin për gradën policore “Komisar” në të njëjtën kohë me ankuesen, kishte ardhur për një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv;
- Nuk janë emëruar punonjës të tjerë meshkuj në pozicione me gradën policore “Komisar”, në DVP Durrës, gjatë kohës që ankuesja ka parashtruar kërkesat e saj për emërim.

Në përfundim, Komisioneri konstatoi se, pavarësisht faktit që në DVP Durrës ekzistonin pozicione të lira pune, nuk është emëruar ankuesja, por janë emëruar dhe transferuar punonjës meshkuj, nga brenda dhe jashtë DVP-së Durrës.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, për shkak të gjinisë.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të shtetases V.G., në punësim, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, për shkak të gjinisë.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetases V.G., në punësim, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Durrës të marrin masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në një pozicionin pune në DVP Durrës, i cili të përshtatet me gradën policore “Komisar”.

30. E.SH., kundër A.GJ., Shef i Forces së Sigurisë Portuale Shëngjin

VENDIM NR. 259, DATË 29.12.2021

Shkaku: Gjinia
Forma: Shqetësim seksual
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është diskriminuar për shkak të gjinisë, në formën e shqetësimit seksual, nga A.Gj., Shef i Forcës së Sigurisë Portuale Shëngjin.

FAKTET

Ankuesja E.Sh., e datëlindjes 17.05.1991, lindur e banuese në Lezhë, ka filluar punë pranë Portit Detar Shëngjin në datën 08.06.2015. Ajo ka punuar në pozicione të ndryshme pune pranë kësaj shoqërie. Fillimisht emërimi i saj në detyrë në Sektorin e Sigurisë, është bërë nëpërmjet Urdhërit Nr. 29, datë 08.06.2015, të Drejtorit të Portit Detar Shëngjin.

Në vijim, rezulton se nëpërmjet shkresës Nr. 19, datë 15.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm, ankuesja E. Sh. dhe kolegu i saj, Gj. H., janë pezulluar nga detyra, për mosrespektimin dhe shkeljen e Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Punës, shkeljen e disiplinës në punë, si dhe kompromentimin e sigurisë së

portit. Mbështetur në raportet e shërbimit të datës 15.02.2017, të mbajtur nga punonjësit e sigurisë, M. P. dhe E. Gj., rezulton se pezullimi i dy punonjësve është bërë për shkak të një incidenti të ndodhur ndërmjet tyre në datën 15.02.2017. Në mars 2017, nëpërmjet një Aktmarrëveshje Mirëkuptimi Nr. 34 Prot., datë 09.03.2017, palët ranë dakord për faljen e njëri-tjetrit, në lidhje me këtë incident të ndodhur, në prani edhe të familjarëve të tyre. Në këtë Aktmarrëveshje është sqaruar fakti se incidenti ka qenë sporadik dhe se nuk ka patur lidhje me punën, pavarësisht se ka ndodhur në punë. Sipas Akt marrëveshjes rezulton se palët janë pajtuar dhe deklarojnë se nuk kanë më mosmarrëveshje me njëri-tjetrit, si dhe nuk kërkojnë hetime apo që kjo çështje të ndiqet nga organet e drejtësisë.

Në vijim, me anë të Urdhërit Nr. 12, datë 13.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm, ankuesja ka kaluar në pozicionin e specialistes së Emergjencave Civile dhe Ndotjeve Detare, në Portin Detar Shëngjin sh.a. Me anë të Urdhërit Nr. 34, datë 31.07.2017, të titullarit të Portit Detar Shëngjin sh.a, ankuesja ka kaluar në Sektorin e Emergjencave Civile, në zyrën e Kamerave në Sektorin e Sigurisë. Në vijim, ankuesja është emëruar operatore ngarkim-shkarkimi, nëpërmjet Urdhërit Nr. 32, datë 16.02.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Portit Detar Shëngjin. Lëvizja e fundit e ankuses është kryer nëpërmjet Urdhërit Nr. 61, datë 01.06.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm, ku ajo ka kaluar në pozicionin e punonjësës së sallës operative, pranë Portit Detar Shëngjin sh.a.

Në ankesën e saj drejtuar KMD-së, E. Sh., pretendon diskriminim për shkak të gjinisë, në formën e shqetësim seksual nga ana e eprorit të saj të drejtpërdrejtë, A.Gj. Si pasojë e këtij diskriminimi nga ana e eprorit të saj, të cilit ajo pretendon se nuk i është përgjigjur, E. Sh., pretendon se ka patur pasoja të tilla si masa disiplinore e dhënë ndaj saj dhe mospagesa e orëve të natës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokollit 12 i saj.
- Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës *“Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”*¹²;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹³ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar.
- Rekomandimit CM / Rec (2019)1 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës *“Për parandalimin dhe luftimin e seksizmit”*;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 *“Për barazinë gjinore në shoqëri”*.

¹²<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>

¹³ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

KONKLUSIONE

Komisioneri gjykoi se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i E. Sh., pasi asaj nuk i janë paguar orët e natës ose të turnit të tretë nga ana e punëdhënësit Porti Detar Shëngjin sh.a., për muajt janar, shkurt, prill, maj, qershor korrik gusht, shtator, tetor 2020, si dhe ankesa e saj kundër A.Gj., që përmban edhe pretendim për diskriminim nga ky i fundit nuk është shqyrtuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Portit Detar Shëngjin sh.a. edhe pse ekziston detyrimi i tij ligjor për ta marrë në shqyrtim këtë kërkesë, sipas dispozitave përkatëse të LMD, i ndryshuar.

Cila është arsyeja e këtij qëndrimi të A.Gj., me ankuesen? Për t'i dhënë përgjigje rastit konkret Komisioneri është mbështetur në bisedat e zbardhura në Aktin e Ekspertimi (Teknik kompjuterik telefoni dhe kartë SIM), të Qendrës së Ekspertimeve Kompjuterike Ligjore Tiranë. Këto biseda ndërmjet E. Sh., me A.Gj., janë shkëmbyer në aplikacionin WhatsApp, si dhe në 43 mesazhe (sms). Nga analizimi i bisedave të tyre, Komisioneri konstatoi një marrëdhënie aspak normale ndërmjet eprorit dhe vartëses së tij, për sa i përket mënyrës së tyre të komunikimit. Në kushtet kur, ankuesja në datën 04.10.2021, ka qenë e detyruar të japë dorëheqjen e parevokueshme nga detyra, që ka mbajtur pranë Portit Detar Shëngjin tregon se ajo ka qenë nën një trysni tepër të madhe psikologjike dhe problematikat me A.Gj., janë thelluar më tepër se më parë.

Lidhur me çështjen, që ka lidhje me masën disiplinore *“vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”* me motivacion *“mosparaqitje në punë në mënyrë të pajustificuar dhe thyerje te etikës në punë”*, dhënë ndaj E. Sh, Komisioneri gjykon se masa disiplinore është marrë menjëherë pas ndërprerjes së komunikimit ndërmjet tyre dhe shkeljet e kryera nga ankuesja përkojnë me momente të bisedave të saj me A.Gj., kur ky i fundit ka shprehur kërkesa të natyrës seksuale ndaj saj.

Komisioneri gjykoi se ankuesja E.Sh., është diskriminuar për shkak të gjinisë, në formën e shqetësimit seksual, nga ana e A.Gj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, në formën e shqetësimit seksual, të E.Sh., nga A.Gj., me detyrë Shef i Sigurisë së Portit Detar Shëngjin sh.a.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjinisë, të E.Sh., nga Drejtori i Përgjithshëm i Portit Detar Shëngjin sh.a., Gj.P.
- Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi të marrën masa të menjëherëshme për evidentimin, llogaritjen dhe pagesën e të gjithë orëve të natës për E.Sh.

31. L.GJ., kundër Bashkisë Kukës

VENDIM NR. 143, DATË 05.08.2021

Shkaku: Gjinia, bindjet politike
Forma: Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja L.Gj., është diskriminuar duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes së ankesës për shkeje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjinisë dhe bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja L.Gj., është në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Kukës me detyrë “Punonjëse Sociale” Ajo punon në këtë pozicion pune që prej vitit 2019, ndërsa është në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Kukës që prej vitit 2007, ku ka punuar në pozicione të ndryshme pune. Në vitin 2017, L.GJ., ka përfituar rritje në pagë bazuar në një Vendim të Këshillit të Ministrave, duke u paguar me shtesë për pozicionin në masën 38.000 lekë. Në muajin janar të vitit 2020, ankuesja ka konstatuar, se pa asnjë njoftim paraprak, paga e saj kishte pësuar ulje. Që prej muajit shkurt 2020 e në vazhdim, ankuesja është paguar me shtesë për pozicion, në vlerën 32.000 lekë. Ankuesja ka kërkuar nga Bashkia Kukës, informacion në lidhje me arsyet e cënimit që i ishte bërë pagës së saj. Bashkia Kukës, i ka kthyer përgjigje ankueses, ku ndër të tjera e informon se: “... *Arsyeja e ndryshimit të pagës është mungesa e fondeve në dispozicion, problem i mbartur ndër vite, por që tani nuk do mbulohen më nga të ardhurat e bashkisë, siç është proceduar vitet e kaluara*”. Duke pretenduar se është viktimë e sjelljeve diskriminuese nga ana e Bashkisë Kukës, ankuesja ka paraqitur ankesë për diskriminim pranë Komisionerit, duke pretenduar se është cënuar parimi i trajtimit të barabartë në lidhje me pagën, për shkak të gjinisë dhe bindjeve politike. Gjatë kohës që ankesa ka qenë në shqyrtim pranë Komisionerit, ndaj ankueses është dhënë masa disiplinore “*paralajmërim për largim nga puna*”, për thyerje të Kodit të Etikës në komunikim me kolegët dhe eprorët. Ankuesja pretendoi se, masa disiplinore “*paralajmërim për largim nga puna*” kishte ardhur si pasojë e paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, L.Gj., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme në lidhje me uljen e pagës, nga ana e Bashkisë Kukës. Pretendimi i Bashkisë Kukës për mungesë fondesh për të mbuluar funksionet e deleguara në fushën e kujdesit social, rezultoi i pabazuar. Komisioneri vlerësoi se nuk jemi në kushtet e ekzistencës së lidhjes shkakësore midis shkakut të pretenduar të gjinisë dhe diferencës në trajtim të ankueses, pra të uljës në pagë. Një ankesë për pagë të ulët, nuk përbën një ankesë për diskriminim, nëse nuk provohet se paga është më e ulët në krahasim me punjës të tjerë të cilët kryejnë detyra të njëjta ose të ngjashme dhe ndryshimi i vetëm midis tyre është shkak i mbrojtur. Në rastin objekt shqyrtimi, rezultoi vërtetë që ankuesja ka pësuar ulje në pagë në raport me punonjës të tjerë social të cilët paguhen më shumë se ankuesja, por këta punonjës mbartin të njëjtin shkak si ankuesja, pra janë gra. Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *a priori* në përfundimin se jemi përpara diskriminimit gjinor, për sa kohë që nuk provohet lidhja shkakësore, pra se arsyeja për këtë trajtim të padrejtë që i është bërë ankueses është pikërisht gjinia dhe fakti se ajo është grua.

Komisioneri arriti në përfundimin se, L.Gj., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme gjatë procesit disiplinor dhe marrjen e masës disiplinore ndaj saj, nga ana e Bashkisë Kukës. Procedura e shqyrtimit të kësaj mase disiplinore nga punëdhënësi nuk ka garantuar të drejtën e ankueses që të dëgjohet, të mbrohet dhe të parashtrojë faktet dhe provat në mbështetje të pretendimeve të saj. Cënimi i këtyre garancive konsiderohen shkelje flagrante të procedurës së parashikuar nga neni 37 i Kodit të Punës. Në kushtet kur masa disiplinore është produkt i një procesi disiplinor që nuk ka respektuar garancitë dhe procedurën e përcaktuar nga ligji, atëherë kjo masë disiplinore nuk mund të shërbejë si një provë e vlefshme për të vërtetuar shkeljen e pretenduar. Edhe gjatë shqyrtimit të ankesës përpara Komisionerit, Bashkia Kukës nuk provoi shkeljet e pretenduara.

Fakti që, ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë procedurës për dhënien e masës disiplinore “paralajmërim për pushim nga puna”; Fakti që masa disiplinore e marrë ndaj ankueses është e pabazuar në fakte dhe prova dhe nuk rezultoi e provuar që ankuesja të ketë konsumuar shkeljet e pretenduara nga bashkia; Fakti që, masa disiplinore është dhënë në kundërshtim flagrant me nenin 37 të Kodit të Punës, duke cënuar të drejtën e ankueses për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur; Fakti që, masa disiplinore ndaj ankueses është dhënë menjëherë pasi ajo ka paraqitur ankesën për diskriminim në pagë për shkak të gjinisë dhe bindjeve politike; Fakti që, Bashkia Kukës ka patur dijeni për paraqitjen e ankesës për diskriminim; krijojnë prezumimin se masa disiplinore “*paralajmërim për largim nga puna*”, jo vetëm që është e pabazuar, por është pasojë negative që ka ardhur si rezultat i paraqitjes së ankesës për diskriminim kundër Bashkisë Kukës, pranë Komisionerit. Bashkia Kukës, kishte barrën e provës që të provonte se masa

disiplinore ndaj ankueses nuk është bërë për shkak të ankimit të saj për diskriminim pranë Komisionerit, ose që masa disiplinore është dhënë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses se masa disiplinore është dhënë për shkak të ankesës për diskriminim para Komisionerit. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e Bashkisë Kukës, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për dhënien e masës disiplinore ndaj ankueses, “*paralajmërim për largim nga puna*”, mbetet fakti i paraqitjes së ankesës për diskriminim para Komisionerit.

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesja L.Gj., është diskriminuar nga ana e Bashkisë Kukës, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes pranë Komisionerit të ankesës për shkeje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjinisë dhe bindjeve politike, në fushën e punësimit.

Ankuesja pretendoi se ulja në pagë, ka si bazë edhe faktin se për shkak të mbimerit “Gjana” një mbimër që lidhet me një përfaqësues dhe ish deputet e ministër, të Partisë Demokratike dhe jo me fakte konkrete, ankuesja prezumohet nga drejtuesit e bashkisë se ka bindje të djathta, por sipas saj ajo nuk ka lidhje me asnjë parti politike. Ky pretendim i ankueses është i pamjaftueshëm për të ngritur një prezumim për diskriminim bazuar në bindjet politike, pasi pretendimin e saj ankuesja nuk e shoqëron më asnjë fakt apo provë lidhur me bazueshmërinë e tyre. Komisioneri në lidhje me këtë moment vlerësoi edhe faktin se ulja në pagë nuk është bërë vetëm për ankuesen por edhe për punonjës të tjerë social. Komisioneri vlerësoi se, në kushtet kur, bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi politik ka ndodhur, Bashkia Kukës nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja nuk përbën diskriminim për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankueses L.Gj., në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Kukës.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses L.Gj., për shkak të *gjinisë* dhe *bindjeve politike*, nga ana e Bashkisë Kukës, në lidhje me uljen në pagë.
- Bashkia Kukës, të marrë masa për shfuqizimin e vendimit Nr. 37, datë 29.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë “*Për dhënien e masës disiplinore*” ndaj ankueses.

VII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE

32. Gj.N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

VENDIM NR. 32, DATË 22.02.2021

Shkaku: Gjendja e rëndë shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Gj.N., i është mohuar e drejta për shërbim shëndetësor duke u diskriminuar për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.

FAKTET

Gj.N., është shtruar në Urgjencen Polivalente të QSUT-së, me diagnozë shtrimi “status epileptik”. Në vijim është vendosur që pacienti të transferohet pranë Shërbimit të Neurologjisë e më pas ai është kaluar në reanimacion i intubuar për shkak të problemeve me pulmonet. Gj.N., ka qendruar një muaj i intubuar.

Me Vendimin Nr. 86, datë 15.10.2018, e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së është vendosur që Gj.N., me diagnozë “*epilepsi e gjeneralizuar dhe me bazë hipertensionit*” të dërgohet në një klinikë jashtë shteti për trajtim mjekësor të specializuar. Edhe pse është depozituar dokumentacioni i plotë nga familjarët pranë MSHMS dhe ka kaluar një periudhë pothuajse 2 vjeçare nga miratimi i këtij vendimi, ky institucion nuk ka vepruar për ta dërguar Gj.N., për kurim në një institucion të specializuar jashtë shtetit. Gj.N., jeton me të atin pensionist dhe nuk ka asnjë burim financiar të mjaftueshëm për të mbuluar vetë shpenzimet mjekësore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14;
- Karta Shqiptare e të Drejtave të Pacientit;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri gjykoi se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i Gj.N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Rezultoi se pacienti Gj.N., e gëzon shkakun e mbrojtur “gjendja e rëndë shëndetësore”, pasi në kushtet, kur ndihma dhe kujdesi shëndetësor në vendin tonë nuk kanë qenë të mjaftueshëm për ta kuruar atë, nëpërmjet Vendimit Nr. 86, datë 15.10.2018, të Komisionit Ndërspitalor, është vendosur kurimi i tij jashtë shtetit, në rastin konkret në Turqi, në bazë të një marrëveshjeje që shteti shqiptar ka lidhur me atë turk, për kurimin e shtetasve shqiptare në këtë vend. Megjithëse, QSUT e ka dërguar vendimin e sipërcituar dhe Epikrizën e pacientit Gj.N., pranë Ministrisë së Shëndetësisë brenda muajit tetor 2018, ky institucion nuk ka proceduar për më shumë se 2 vjet, duke u justifikuar se nuk kishte kontakt të ankuesit/pacientit për të komunikuar me të dhe për ta vënë në dijeni që duhet të plotësohte dokumentacion vijues për të birin, që duhet të kurohej në shtetin turk.

Komisioneri gjykoi se nga përmbajtja e shkresave zyrtare të Ministrisë e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, në asnjë rast nuk justifikohet mosveprimi i këtij institucioni. QSUT disponon numër kontakti të K.N., babait të pacientit, fakt që është lehtësisht i verifikueshëm në kartelen mjeksore të pacientit dhe aktin e plotësuar ne urgjencë.

Komisioneri gjykoi se mosveprimi i Ministrisë së Shëndetësisë, duke u justifikuar me faktin se nuk vihej dot në kontakt me ankuesin K.N., për ta informuar mbi procedurat që duhej të ndiqte për kurimin e djalit të tij jashtë shtetit, e kanë vendosur në një pozitë tepër të disfavorshme pacientin Gj.N., i cili ishte në “*gjendje të rëndë shëndetësore*” dhe kurimi i tij jashtë shtetit konsiderohej si mënyra e vetme e trajtimit të tij.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Gj.N., është diskriminuar për shkak të “gjendjes së rëndë shëndetësore”.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të Gj.N., për shkak të “gjendjes së rëndë shëndetësore”, nga Ministria e Shëndetësië dhe Mbrojtjes Sociale.

VIII. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

33. Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a.

VENDIM NR. 10, DATË 21.01.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër.

FAKTET

Fondacioni “Së bashku”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare Qendër Shkodër, një ambient ku ofron shërbimet e saj Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., diskriminon personat me aftësi të kufizuar

Zyra Postare Qendër Shkodër, është një nga vendet e ushtrimit të aktivitetit të Postës Shqiptare sh.a. Ajo është e vendosur në katin e parë të një pallati dhe është në pronësi të Postës Shqiptare sh.a. Në pjesën hyrëse të saj janë të vendosura shkallë, ndërsa në pjesën anësore të hyrjes për në zyrën postare është vendosur një rampë. Rampës i mungojnë elementë të aksesueshmërisë siç janë parrmakët mbështetës në gjatësinë e rampës. Rezultoi se Zyra Postare Qendër Shkodër nuk përmbush gjithashtu edhe aspekte të tjera të aksesueshmërisë, siç është: ekzistenca e vijave relievo që kanë si qëllim të drejtojnë dhe orientojnë personat me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë; një plan orientues për lëvizje në këtë ndërtesë ku ofrohen shërbimet.

Në Zyrën Postare Qendër Shkodër investimi i fundit është kryer në vitin 2017, me qëllim krijimin e kushteve bashkëkohore për marrjen e shërbimit dhe janë zgjeruar hapësira duke shtuar sallat e shërbimit.

Pranë kësaj zyre postare ofrohen shërbime të ndryshme postare dhe financiare, si pagesa e aftësisë së kufizuar, ndihma ekonomike, të cilat kanë një efekt të drejtpërdrejtë tek personat me aftësi të kufizuara. Pranë zyrës postare ofrohen edhe shërbime të tjera postare dhe financiare që prekin aspekte të ndryshme të jetës, të tilla si si tarifa shkollimi, pagesat e ujit, energjisë elektrike, si dhe pagesa për institucione të ndryshme shtetërore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolle Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUSIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se Zyra Postare Qendër Shkodër, nuk përmbush të gjitha standartet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Posta Shqiptare sh.a nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve të ofruara prej saj. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër.

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe (edhe pse në rastin konkret nuk është në përputhje me standartet e kërkuara), nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Posta Shqiptare sh.a., nuk

ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuar.

Posta Shqiptare sh.a edhe pse ka investuar për krijimin e kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve në këtë zyrë postare, ky investim nuk ka adresuar në mënyrë të barabartë nevojat midis personave me aftësi të kufizuara dhe pjesës tjetër të qytetarëve që nuk kanë aftësi të kufizuara. Përveç vendosjes së rampës, e cila nuk është plotësisht sipas standarteve të miratuara të aksesueshmërisë, Posta Shqiptare sh.a., nuk ka investuar në asnjë drejtim tjetër për të siguruar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe nevojave të tyre për përshtatje. Në godinën ku ofrohen shërbimet nga Zyra Postare Qendër Shkodër janë kryer investime pasi ishin miratuar standartet e aksesueshmërisë dhe Posta Shqiptare sh.a., nuk i ka marrë në konsideratë këto standarde me qëllim eliminimin e pengesave apo barrierave ekzistuese. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme ka të bëjë me individin. Kjo do të thotë që detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrë *ex ante*. Për këtë arsye, subjektet, kanë për detyrë të sigurojnë aksesueshmërinë para se të marrin kërkesa për të hyrë në një vend ose për të përdorur/marrë një shërbim, nga ana e individit. Detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, kjo do të thotë që subjekti i detyruar për sigurimin e aksesueshmërisë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri arriti në përfundimin se mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në Zyrës Postare Qendër Shkodër, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a në këtë zyrë postare. Komisioneri vlerësoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Shkodër.
- Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa për plotësimin e të gjitha standarteve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe Nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
- Marrja e masave si më sipër, duhet të realizohet brenda një afati prej 3 (tre) muajsh, nga dita e komunikimit të këtij vendimi.
- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që marrja e masave për sigurimin e aksesueshmërisë së Zyrës Postare Qendër Shkodër të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

- Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a., që brenda 6 (gjashtë) muajve të hartojë një plan masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

34. Z.F., kundër Bashkisë Sarandë

VENDIM NR. 234, DATË 10.12.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe Shërbime
Statusi: Zbatuar

Subjekti ankues është person me aftësi të kufizuar (tetraplegjik) dhe është diskriminuar nga ana e Bashkisë Sarandë, për shkak të aftësisë së kufizuar, lidhur me prishjen e rampës hyrëse nga një subjekt privat, duke pamundësuar hyrjen e tij në banesë.

FAKTET

Subjekti ankues, Z.F., në vitin 2015 ka blerë një apartament në lagjen Nr. 1, Sarandë, sipas kushteve të rëna dakord dhe të nënshkruara nga të dyja palët, në Kontratën e Sipërmarrjes.

Në momentin e blerjes së apartamentit dhe garazhit nga ankuesi, kushtet e specifikuar sipas Kontratës së Sipërmarrjes kanë qenë të respektuara dhe të zbatuara. Në objektin e kësaj Kontrate, specifikohet se: *“Ashensori do të ketë përmasa minimale me hapje të derës 90 cm, me gjatësi 1,40 cm x 1,20 cm. Objekti do të ketë hyrje dhe nga vendi i parkimit për hyrje të personave me aftësi të kufizuar si dhe djathtas hyrjes kryesore, ku objekti ndodhet në nivelin e rrugës”*.

Deri në vitin 2018 ka qenë e ndërtuar një rampë në krahun e djathtë të portës hyrëse në pallat, e cila shfrytëzohej prej ankuesit për të shkuar në apartament. Në muajin qershor 2021, ai ka konstatuar se rampa ishte hequr nga personi që zotëron një biznes privat në katin e parë të ndërtesës, gjë që bën të pamundur lëvizshmërinë e tij si invalid (me karrocë).

Ankuesi i është drejtuar Bashkisë Sarandë, duke i kërkuar që të marrë masa për detyrimin e pronarit të lokalit për rindërtimin e rampës, pasi zgjerimi i ambjenteve të biznesit të tij, ka çënuar hapësirën e përbashkët në të cilën ishte e vendosur rampa dhe në këto kushte ai e ka të pamundur të aksesojë banesën e tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM Nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUSIONE

Komisioneri *së pari*, ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Sarandë, lidhur me mosveprimin e saj për të ndërhyrë dhe zgjidhur problematikën e aksesueshmërisë për në banesën e tij, si dhe në raport me të drejtat dhe lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipërcituar.

Së dyti, Komisioneri, vlerësoi nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Bashkisë, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, analizimit të fakteve, provave të shqyrtuara, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që ankuesi është person me aftësi të kufizuar, i cili lëviz me karrocë me rrota, atij i është mohuar dhe shkelur e drejta ligjore lidhur me aksesueshmërinë në banesë, masë e cila duhet të ishte marrë nga ana e Bashkisë.

Bashkia Sarandë nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë konkretisht për zgjidhjen e kësaj shtate, dhe se Bashkia nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënlige në fuqi, për të garantuar aksesin

e ankuesit për në banesën e tij, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë efektive dhe përfundimtare.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Sarandë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, përse i takon mosmarrjes të masave për zgjidhjen efektive të ankesës së tij, lidhur me realizimin e aksesueshmërisë së lëvizjes së tij për në banesë.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Sarandë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Sarandë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

35. Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” kundër Bashkisë Durrës

VENDIM NR. 192, DATË 11.10.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Shërbime
Statusi: Në gjykatë

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, është diskriminuar nga ana e Bashkisë Durrës ku ajo ka selinë, pasi nuk është pajisur me një ambient pune ku të ushtrojë veprimtarinë e saj, sipas përcaktimeve ligjore specifike.

FAKTET

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” (Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Durrës, nëpërmjet Vendimit Nr. 6179, datë 07.03.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Përfaqësuesi i Shoqatës i është drejtuar disa herë Bashkisë Durrës për pajisjen me zyrë për përdorim të Shoqatës, për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë së saj, por nuk ka gjetur mbështetje dhe zgjidhje nga ana e Bashkisë. Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” njeh rolin aktiv të shoqatave në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve. Në këtë kontekst, shteti/Bashkia financon veprimtarinë e Shoqatës sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të saj mjedise pune, të cilat ua jep në

përdorim dhe ajo duke mosvepruar i ka mohuar Shoqatës një të drejtë që buron nga parashikimet ligjore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM Nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Komisioneri konstaton se, referuar periudhës kohore kur janë nënshkruar një pjesë e kontratave të qirasë, kohëzgjatjes së tyre, si dhe periudhave kohore kur janë paraqitur kërkesat e Shoqatës pranë Bashkisë për pajisjen me ambiente pune, për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, Bashkia ka pasur mundësi konkrete për të përmbushur detyrimin e saj ligjor lidhur me kërkesën e përsëritur të Shoqatës.

Në mënyrë të përsëritur, Shoqata ka kërkuar nga Bashkia që të përmbushë detyrimi ligjor ndaj saj, për pajisjen me zyrë pranë ambjenteve të ish-URT-së, pasi kishin konstatuar se kishte një ambjent bosh, të cilin janë shprehur se edhe pse ishte i papërshtatshëm dhe kishte nevojë për riparime, do ta pranonin në funksion të përmbushjes së ushtrimit të funksionit të Shoqatës.

Nga evidentimi i kohëzgjatjes së kontratave të qirasë të nënshkruara mes Bashkisë dhe subjekteve fizike e juridike të sipërcituara në vendim, vërehet se mund të ishte krijuar mundësia e sistemimit

dhe zgjidhjes së problematikës për dhënien e një ambienti/zyre në favor të Shoqatës. Kështu, shumë prej kontratave të qirasë janë lidhur me kohëzgjatje një vjeçare, dhe ky fakt duhet të ishte analizuar dhe mbajtur në konsideratë nga ana e Bashkisë. Në përfundimin e afatit të përcaktuar, me ndonjë nga subjektet, mund të ishte lidhur kontratë e re me Shoqatën. Evidentohet gjithashtu se, edhe pas datës së fundit kur Bashkia ka informuar Shoqatën se, sapo të krijoheshin ambiente të lira do të informoheshin dhe do t'u viheshin në dispozicion, ajo ka patur mundësi sistemimi në një nga ambientet e ish-URT-së për Shoqatën dhe nuk e ka bërë.

Bazuar në sa më sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Bashkisë Durrës nuk është përbushur vullneti i saj i shprehur, për të vënë në dispozicion të Shoqatës mjedise për ushtrimin e aktivitetit të tyre dhe as është konsideruar mundësia që atyre t'u vihej në dispozicion një ambient që mund të lirohej në përfundimin e afatit kontraktual me ndonjë nga subjektet sipërcituar.

Nga analizimi i situatës, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, Bashkia Durrës, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme subjektin ankues, Shoqatën Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në raport me mundësinë e tyre konkrete, për dhënien e një ambienti pa kundërshpërblim, për ushtrimin e funksionit të Shoqatës.

Fakti i posedimit të shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, Shoqatës, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata kishin shprehur vullnetin për të gjetur ambiente në pronësi të saj, për përdorim pa kundërshpërblim nga ana e Shoqatës.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve (Shoqatave), duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Durrës, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, Shoqatën Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për posedimin e një ambienti të përshtatshëm pa kundërshpërblim, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referim të pikës 1, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Durrës, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

36. Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Durrës dhe Operatorëve që ofrojnë shërbimin e transportit publik, Durrës

VENDIM NR. 26, DATË 16.02.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Vendim me gjobë

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në transportin publik të Bashkisë së Durrësit për personat me aftësi të kufizuar, i ka diskriminuar këto persona në të mira dhe shërbime.

FAKTET

Gjatë shqyrtimit të ankesës, është evidentuar se mjetet e transportit dhe stacionët e autobuzëve, në Bashkinë Durrës, janë të pa aksesueshëm. Pra, në shërbimin e transportit publik, nuk garantohej aksesueshmëria fizike e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Mos ofrimi i lehtësive për këtë kategori individësh me aftësi të kufizuara fokusohej në disa aspekte:

- Mungesa e rampave të cilat janë të nevojshme për ta bërë transportin publik të aksesueshëm;
- Mungesa e zbatimit të standardeve teknike për aksesueshmërinë e stacionëve të autobuzave të transportit publik;
- Mungesa e afishimit të orareve dhe të itinerareve në stacionet e autobuzëve përbën pengesë për personat që nuk flasim dhe dëgjojnë;
- Gjatë lëvizjes së autobuzit nuk njoftohet vendodhja e stacioneve me anë të një shpjegimi audio.

Rastet e parashtruara reflektojnë pikërisht mosofrimin e këtyre lehtësive në transportin urban qytetas në qytetin e Durrësit. Gjatë hetimit administrativ të kësaj ankese, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa u konsideruan edhe Shoqëritë e transportit “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”, autobusët e të cilëve rezultuan se ofronin shërbimin urban qytetas në linjat qytetase, të cilat lidhen me ofrimin e lehtësive për sa i përket aksesueshmërisë fizike në autobus.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”;
- Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”.

KONKLUZIONE

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë Durrës, rezultoi se një pjesë e mjeteve të transportit publik të operatorëve urban të shoqërive “*M... B... sh.p.k.*,” dhe “*I... T... sh.p.k.*,” të kontraktuar nga Bashkia Durrës, ishin të pajisur me platformën lëvizëse, që siguron aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar në autobusë, ndërkohë për pjesën tjetër të këtyre automjeteve nuk u vu në dispozicion informacioni i plotë nëse janë të pajisur me një pajisje të tillë. Mungesa e një platforme lëvizëse në autobusët e këtyre shoqërive, pengon aksesin fizik në automjetet urbane qytetase, të individëve me aftësi të kufizuar, duke kufizuar mundësinë e tyre për të vetëvepruar.

Komisioneri vlerësoi se grupi i personave me aftësi të kufizuara, janë trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i kishte vendosur ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar që marrin shërbime pranë “*M... B... sh.p.k.*,” dhe “*I... T... sh.p.k.*,” të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Nga faktet dhe provat e administruara nuk rezultoi që Bashkia Durrës të kishte marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike.

Komisioneri arriti në përfundimin se mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në autobuzët dhe stacionet e qytetit të Durrësit, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara në transportin publik në këtë qytet. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerësoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arriti në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë dhe se Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “*M... B... sh.p.k.*,” dhe “*I... T... sh.p.k.*,” janë në shkelje të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.

- Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatorët e shërbimit urban qytetas “M... B... sh.p.k.,” dhe “I... T... sh.p.k.,”.
- Bashkia Durrës, të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, në mjetet e transportit të shërbimit urban qytetas dhe përshtatjen e stacionëve të autobuzëve për personat me aftësi të kufizuar.
- Shoqëritë e transportit qytetas “M... B... sh.p.k.,” dhe “I... T... sh.p.k.,”, të marrin të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.
- Rekomandohet Bashkia Durrës që marrja e masave për sigurimin e aksesueshmërisë së transportit publik, si në mjetet e transportit por edhe në stacionet tyre, të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

37. F.S., dhe F.E., Bashkisë Vlorë dhe Shoqërisë së Transportit Qytetas “Urban Trans Vlorë” sh.p.k.

VENDIM NR. 174, DATË 20.09.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik të Bashkisë së Vlorë për personat me aftësi të kufizuara i vendos këtp persona në kushte diskriminuese për shkak të AK.

FAKTET

Gjatë përdorimit të transportit urban, ankuesit e janë detyruar që këtë shërbim ta marrin me pagesë nga ana e shoqërive të transportit qytetas, duke mos i njohur Librezën e lëshuar nga ana e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, si dhe duke mos zbatuar Ligjin “Për statusin e të verbërit”, i cili parashikon transportin falas për personat e verbër.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit Nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
- Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara, të verbër, nuk kanë përfituar nga transporti urban pa pagesë në linjën e ofruar nga operatori “Urban Trans Vlora” sh.p.k., nga ana e Bashkisë Vlorë nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situatë.

Komisioneri konstatoi se Bashkia Vlorë nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare. Për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se ankuesve, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të F.S., dhe F.E., nga ana e Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë së transportit qytetas “Urban Trans Vlora” sh.p.k.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë së transportit qytetas “Urban Trans Vlora” sh.p.k., për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kategorisë së personave të verbër.

- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar).
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar).
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

38. S.L., kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 142, DATË 03.08.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Mohim i përshtatjes së arsyeshme
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Subjekti ankues, në ditën e zgjedhjeve për Kuvend, datë 25.04.2021 është paraqitur pranë qendrës së saj të votimit në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi” dhe ka konstatuar mungesën e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në qendrën e votimit, duke bërë të pamundur ushtrimin e të drejtës së votës nga ana e personave PAK.

FAKTET

Subjekti ankues, në ditën e zgjedhjeve për Kuvend, datë 25.04.2021 është paraqitur pranë qendrës së saj të votimit Nr. 1887/1 në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi”. Problematika që ajo kishte evidentuar lidhej me:

1. Mungesën e rampës në hyrje të Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, e cila ishte jashtë çdo standardi teknik që parashikohet në Rregulloren “Për përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuar”.
2. Nuk kishte përparësi në rradhë si person me aftësi të kufizuar.
3. Dhoma e fshehtë ishte e papërshtatur dhe nuk ishte vendosur siç duhet. Për këtë shkak, ankuesja është asistuar nga një person, i cili ka plotësuar fletën e votimit në lartësi, çka ka pamundësuar që ajo të kontrollojë nëse u përbush vullneti i saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

KONKLUSIONE

Në rastin konkret, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që votuesve me aftësi të kufizuara duhet t’i krijoheshin kushtet për të votuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjidhjen e kësaj situate janë ndërmarrë hapa për t’i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Gjatë procedurës të shqyrtimit të ankesës, nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk u parashtrua asnjë pretendim në lidhje me faktin, nëse ofrimi i përshtatjes së arsyeshme për rastin e ankueses apo votuesve të tjerë me aftësi të kufizuara, përbënte një barrë disproporcionale dhe të padrejtë, pra një barrë të tepruar, edhe pse ligjërisht është detyrim i saj. Në këtë kuptim dhe referuar legjislacionit të analizuar, janë pikërisht organet e vetëqeverisjes vendore ato të cilat kanë detyrimin për ti ofruar përshtatjen e arsyeshme dhe aksesueshmërinë e nevojshme, personave me aftësi të kufizuara të cilët duhet të ushtrjnë të drejtën e votës.

Rezultoi se, Bashkia Tiranë, në cilësinë e autoritetit, i cili duhet të siguronte aksesueshmërinë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka marrë asnjë masë lidhur me këtë. Sigurimi i qendrave të votimit me aksesueshmërinë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, është e vetmja mënyrë që ankuesja dhe votuesit e tjerë në të njëjtat kushte me të do të mund të ushtronin të drejtën e votës në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykoi se kërkesa për sigurimin e elementëve të aksesueshmërisë është një përshtatje e domosdoshme për ankuesen dhe personat të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të. Në kushtet kur rezultoi se vendosja e elementëve të aksesueshmërisë në godinën e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, nuk përbën një barrë të tepruar, për Bashkinë Tiranë, Komisioneri arriti në përfundimin se Bashkia Tiranë e ka vendosur ankuesen përballë një situate diskriminuese, jo

vetëm duke mos i siguruar elementët e aksesueshmërisë në qendrën e votimit, por edhe duke konsumuar diskriminim në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Tiranë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të, sa i përket aksesueshmërisë dhe mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të shtetasve S.L., dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, *në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme*, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të S.L., dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, në zgjedhjet e ardhshme, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Tiranë, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse.
- Të rekomandojë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e kriterëve, sa i takon personave me aftësi të kufizuara, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme.

39. D.N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

VENDIM NR. 144, DATË 05.08.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim në formën e rëndë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Subjektit ankues, shtetasi D.N., është diskriminuar atë për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, pasi nuk ka marrë sasinë e rekomanduar nga mjeku, të medikamentit Faktor IX, duke ndikuar në përshpejtimin e invalidizimit të tij.

FAKTET

Subjekti ankues, është i diagnostikuar me Hemophilia B, forma e rëndë, që në vegjëli. Hemophilia është një sëmundje e rrallë e cila mjekohet me Faktor IX dhe VIII. Për trajtimin e Hemophilia B, forma e rëndë, nga e cila vuan dhe ankuesi, nevojitet mjekimi me Faktor IX. Mungesa e profilaksisë i ka shkaktuar atij, dëme në artikulacione, ku shpesh dëmtimi i tyre është i pariparueshëm.

Ankuesi është trajtuar me gjak të freskët për 9 (nëntë) ditë, në pavionin e Hematologjisë në QSUT, si pasojë e një hemorragjie të rëndë në pjesën Abdominale (Gastrohemorragji). Në fletë-daljen e marrë nga spitali, mjeku ka theksuar faktin që ai duhet të ndiqet rregullisht dhe shumë strikt nga Qendra e Hemofilisë në QSUT. Gjithashtu, thekson se mungesa e trajtimit të rregullt me Faktor IX, ka sjellë pasoja shumë të rënda në gjendjen shëndetësore të ankuesit, duke i dëmtuar artikulacionet dhe duke bërë që ai të jetë pjesë e grupit të I-rë, të personave me aftësi të kufizuara. Nga mjeku, është rekomanduar që ankuesi të marrë një sasi prej 6000 UI Faktor IX, ndërsa nga Farmacia e QSUT-së i është dhënë një sasi prej 450 UI Faktor IX. Gjithashtu, me të njëjtën situatë ankuesi është përballur edhe në një datë tjetër, ku nga mjeku Hematolog ishte përshkruar marrja e një sasive prej 6000 UI, ndërsa nga Farmacia e QSUT-së sërish i është dhënë vetëm 3000 njësi Faktor IX.

Nga informacioni dhe provat e administruara, rezultoi se ankuesi nuk merr sasinë e rekomanduar nga mjeku hematolog të medikamentit Faktor IX.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ);
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Evropiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 307, datë 21.05.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, i ndryshuar
- Vendimi Nr. 483, datë 29.6.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2020”;
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Sëmundjeve të Lindura të Gjaktut (2009 –2010)¹⁴, të MSHMS.

¹⁴http://www.nationalplanningcycles.org/sites/default/files/planning_cycle_repository/albania/the_national_strategy_for_the_management_of_congenital_blood_2009-2010.pdf

KONKLUSIONE

Nga analizimi i provave të paraqitura nga pala ankuese rezulton se shtetasi D.N., nuk ka marrë sasinë e rekomanduar nga mjeku të medikamentit Faktor IX. Pikërisht, një gjë e tillë ka ndikuar në përshpejtimin e invalidizimit të ankuesit. Për sa më sipër, Komisioneri gjykoj se institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masat e nevojshme për sigurimin e plotë të sasisë së Medikamentit Faktor IX për ankuesin, aq më tepër kur predispozicioni i pacientëve me këtë sëmundje është invalidizimi i tyre.

Gjatë shqyrtimit të ankesës Nr. 120, datë 13.08.2018, të shtetasit B.N., (familjar i ankuesit), çështjes së iniciuar kryesisht me Urdhërin Nr. 247, datë 12.12.2018 dhe ankesës Nr. 80, datë 08.07.2019, të shtetasit K.M., Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka evidentuar se arsyet që kanë çuar në mos sigurimin e Medikamentit Faktor IX, ka qënë fakti që këto medikamente siguroheshin përmes kontratave të prokurimit me operatorë ekonomikë privatë apo përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende të tjera, kryesisht donacione.

Në rastin e çështjeve të sipërcituara, personat vuanin nga hemofili e tipit A në formë të rëndë dhe B, si dhe ishin invalid. Në përfundim të tajtimit të këtyre çështjeve, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar si pasojë e mosgarantimit të trajtimit në sasisë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor. Në të tre rastet e shqyrtuara, Komisioneri ka udhëruar institucionet përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT për marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e trajtimit me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor.

Vlen të sille në vëmendje fakti që vendimet e Komisionerit janë kundërshtuar gjyqësisht dhe në përfundim të shqyrtimit në një prej rasteve (Vendimit Nr. 80, datë 08.07.2019, të shtetasit K. M.), gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka rrëzuar kërkesë padinë e QSUT-së dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionerit duke marrë formë të prerë. *(Shih vendimin Nr. 395, datë 10.02.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë, për shkak se nuk është apeluar nga QSUT).*

Mungesa e fondeve buxhetore dhe mos siguri i sasisë së mjaftueshme të medikamentit Faktor IX, ka qënë faktor disavantazhues për D.N., Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT kanë patur barrën e provës para Komisionerit për të provuar se pavarësisht kufizimeve buxhetore, fondet e administruara janë përdorur në mënyrën më të mirë për të siguruar medikamentin Faktor IX për pacientët me Hemofili B, gjë të cilën nuk e kanë bërë në këtë shqyrtim administrativ të ankesës së D.N.

Pra në përfundim, Komisioneri konstatoi se:

1. Pavarësisht faktit që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT, kanë patur dijeni në vazhdimësi për mungesën e sasisë së nevojshme për trajtimin e pacientëve Hemofilik me medikamentin Faktor IX, nuk kanë marrë asnjë masë për zgjidhjen e kësaj situate.
2. Edhe pse MSHMS dhe QSUT, u vunë në dijeni të faktit që pas ankesës së paraqitur, D.N., sërish nuk u trajtua me sasinë e nevojshme të medikamentit Faktor IX nga Farmacia e QSUT-së, nuk morën asnjë masë për t'i dhënë një zgjidhje situatës së krijuar.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, ndaj ankuesit është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë, pasi përmbushen parashikimet e sipërcituara në nenin 3/1 të LMD-së, së ndryshuar.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, të D.N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).
- Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë.
- Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, të D.N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).
- Marrjen e masave të menjëherëshme nga të dy institucionet e mësipërme, për trajtimin e pacientit D.N., me sasinë e rekomanduar nga mjeku hematolog të Medikamentit Faktor IX.

40. Shoqata “Shpresë për të verbërit”, kundër Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë “Shpresa-AL” sh.p.k.

VENDIM NR. 146, DATË 06.08.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik të Bashkisë së Kamëz për personat me aftësi të kufizuar i vendos këtu persona në kushte diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar..

FAKTET

Nga ana e punonjësve të Shoqërisë së Transportit “Shpresa-AL” sh.p.k., ankuesit janë bërë dije se me ndryshimet e bëra në Ligjin “Për statusin e të verbërit”, tashmë të verbërit përfitojnë kompensim dhe nuk mund të udhëtojnë falas në transportin qytetas.

Në përfundim të ankesës së sipërcituar, u evidentua se shoqëria e transportit, nuk i ka njohur Librezën e lëshuar nga ana e Shoqatës së tyre, por vetëm librezën e lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës, si dhe nuk ka zbatuar Ligjin Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit Nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
- Udhëzimi Nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Kamëz nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se kësaj kategorie personash me aftësi të kufizuara, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Bashkia Kamëz, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen dhe personat e verbër të përfaqësuar pranë Komisionerit nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, sa i takon ofrimin e transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.
- Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar).
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar).
- Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

41. B.S., kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë

VENDIM NR. 241, DATË 14.12.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Përfshirja nga e drejta për të përfituar trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, gjatë ciklit të dytë të studimeve (Master), i diskriminon këto persona për shkak të aftësisë së kufizuar.

FAKTET

Në vitin 2014 ankuesi është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, për të ndjekur ciklin e studimeve Bachelor në degën Filozofi-Sociologji. Referuar Diplomës Universitare të B.S., rezulton që ai ka përfunduar studimet Bachelor në vitin 2018. Pra, studimet e ciklit të parë Bachelor për ankuesit kanë zgjatur për katër vite akademike, 1 (një) vit më shumë nga kohëzgjatja normale e tyre. Për këtë arsye ankuesi, ka përfutuar edhe për 1 (një) vit shtesë, trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së Nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar. Në vijim, ankuesi ka vijuar ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në programin e studimit Mësues në Shkenca Sociale, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Sipas informacionit, në 2 (dy) vitet e para, ankuesi ka përfutuar trefishin e pagesës për shkak të verbërisë. Më pas ankuesi, nuk ka arritur të përfundojë ciklin e dytë të studimeve Master, brenda kohëzgjatjes normale. Për të përmbyllur studimet i është dashur që në vitin e tretë të kërkojë sërish pagesë për shkak të verbërisë. Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, nuk i është dhënë e drejta e përfitimit të pagesës për 1 (një) vit plus, duke bërë që ai të mos përfundojë programin e studimeve Master.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, B.S., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, në raport me lehtësirat e parashikuara

drejtpërdrejtë VKM-ja “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, e ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

Komisioneri vlerësoi se, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, përmes mohimit të të drejtës për të përfituar pagesën e verbërisë gjatë ndjekjes së ciklit të dytë të studimeve edhe për një vit shtesë, megjithëse aktet nënligjore të sipërcituara, subjekt i të cilit është, ia njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin e shtetit, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e ankuesit.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, B.S., në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës ligjore për përfitimin e të mirave nga zbatimi i VKM-së Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të saj.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, B.S., në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror, të marrin masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

IX. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË VENDBANIMIT

42. Qendra “Konsumatori Shqiptar” në bashkëpunim me Qendrën “Durrës Aktiv” kundër Bashkisë Durrës

VENDIM NR. 61, DATË 13.04.2021

Shkaku: Vendbanimi
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Vendim me gjobë

Banorët e zonës së ish-Kënetës në Durrës janë diskriminuar për shkak të moskrijimit të kushteve për një jetesë sa më cilësore nga Bashkia Durrës, pasi nuk janë planifikuar investime në kanalizime, ndriçim dhe gjelbërim.

FAKTET

Zona e ish-Kënetës në Bashkinë Durrës është një nga zonat e populluara nga një komunitet i ardhur aty prej shumë vitesh nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga shoqatat ankuese, nga media por dhe nga vetë Bashkia Durrës rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga të dyja palët në proces që në zonën e ish-Kënetës, nuk është investuar për sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, në sigurimin e ndriçimit publik dhe në investime për sigurimin e hapësirave të gjelbëra publike. Situata e rënduar mjedisore e banorëve të kësaj zone është bërë publike që në datë 15.09.2017, kur në emisionin “Stop” në TV Klan banorët e zonës kanë denoncuar situatën dhe kanë kërkuar nga Bashkia Durrës, që të sistemojë kanalizimin e ujërave të zeza dhe pastrimin e gjelbërimit të zonës. Pra, situata e vështirë mjedisore e kësaj zone ekziston prej shumë vitesh dhe Bashkia Durrës nuk ka dhënë asnjë informacion, nëse në këtë zonë janë kryer apo mendohet të realizohen ndonjëherë investime në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe pastrimin e gjelbërimit të zonës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolli 12 i saj;
- Karta Sociale Evropiane, e rishikuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Pika 34, e Komentit të Përgjithshëm Nr. 20, të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe dokumentacion për ankesën sipërcituar, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte mundësi të shqyrtonte këtë ankesë, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të argumentuar në ligj, për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri konstaton se Bashkia Durrës me dijeninë e plotë dhe pas sanksionit me gjobë të dhënë nga Komisioneri me Vendimin Nr. 43, datë 11.03.2021, nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga Komisioneri.

Lidhur me sa më sipër, Bashkia Durrës nuk provoi para Komisionerit se:

- Ka kryer investime në zonën e ish-Kënetës, lidhur me sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, sigurimin e ndriçimit publik dhe gjelbërimin e zonës krahasuar me investimet e bëra në lagjet e tjera të Bashkisë.
- Ka planifikuar investime afatshkurtra dhe afatmesme për sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, sigurimin e ndriçimit publik dhe gjelbërimin e zonës krahasuar me investimet e bëra në lagjet e tjera të Bashkisë.

Në këtë kontekst, nga analizimi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se banorët e zonës së ish-Kënetës, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Bashkisë Durrës, trajtim i cili ka lidhje me vendbanimin tyre.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të banorëve të zonës së ish-Kënetës, në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”, për shkak të vendbanimit, nga ana e Bashkisë Durrës.
- Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa për rregullimin e problematikës së banorëve të zonës së ish-Kënetës nga ana e Bashkisë Durrës.

X. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS

43. Çështje kryesisht “Mbi vendosjen e kriterit të moshës “jo më shumë se 30 vjeç”, për pranimin në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë e Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë.”

VENDIM NR. 189, DATË 06.10.2021

Shkaku: Mosha
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në Gjykatë

Kriteri i moshës 18-30 vjeç i vendosur për pranimin në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë e Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë”, diskriminon për shkak të moshës, kategorinë e personave mbi 30 vjeç, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion.

FAKTET

Me urdhrin Nr. 629, datë 10.07.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është urdhëruar shpallja e aplikimeve për konkurim për pranim dhe ndjekjen e studimeve në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë për vitin akademik 2020-2021. Në pikën 5, germa “b” të këtij urdhëri, ndër kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë aplikanti, është që të ketë mbushur moshën 18 vjeç dhe të jetë nën 30 vjeç. Vendosja e kriterit në lidhje me moshën e aplikantëve, parashikuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bazohet në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”. Në këtë urdhër, në pikën 2, germa “a” parashikohet: “... 2. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 38, pika 2 e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, kriteret e veçanta për pranimin në Akademinë e Sigurisë, janë si më poshtë: ... a) Të jenë në moshë jo më shumë se 30 vjeç; ...”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, Nr. 20, datë 11.07.2006, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;
- Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 16.09.2015;
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”.
- Çështjet C-258/2015, *Gorka Salaberria Sorondo v. Academia Vasca de Policía y Emergencias*, 15 nëntor 2016 dhe C- 416/13, *Mario Vital Pérez v. Ayuntamiento de Oviedo*, 13 nëntor 2014, të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

KONKLUZIONE

Duke vendosur si kriter se, personat mbi moshën 30 vjeç nuk mund të aplikojnë për t’u bërë punonjës policie dhe pjesë e policisë së shtetit, Komisioneri arrin në përfundimin se, kriteri i vendosur nga germa “a”, e pikës 2, të Urdhrit Nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, prek kriteret e përzgjedhjes dhe rekrutimit për këtë kategori punonjësish, të cilët i përkasin sektorit publik. Aplikantët të cilët janë mbi 30 vjeç janë në një situatë të ngjashme me atë të aplikantëve më të rinj të cilët janë jo më shumë se 30 vjeç, të cilët marrin pjesë në të njëjtat procedura për pranimin dhe konkurimin në Akademinë e Sigurisë për t’u bërë punonjës të policisë. Komisioneri arriti në përfundimin se kriteri “jo më shumë se 30 vjeç”, trajton në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme personat të cilët janë “më shumë se 30 vjeç” në raport me personat të cilët janë “jo më shumë se 30 vjeç”. Komisioneri vlerësoi se, qartazi, një kriter/rregullim i tillë, përbën një diferencë në trajtim që bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek moshën.

Bazuar në shpjegimet e Ministrisë së Brendshme, kriteri i vendosur në lidhje me moshën jo më shumë se 30 vjeç, është vendosur me qëllim *garantimin e një procesi të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme në Policinë e Shtetit*. Ministria e Brendshme, gjithashtu, shpjegoi se, arsyet e vendosjes së kriterit në lidhje me moshën e aplikantëve jo më shumë se 30 vjeç, ishin dy; *së pari*, personat mbi këtë moshë *nuk rezultojnë të përshtatshëm për detyrat e këtij niveli dhe së dyti*, këta persona *nuk premtorin për të bërë karrierë, në nivelet më të larta të Policisë së Shtetit*.

Në mënyrë të veçantë, neni 6, pika 2, e Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon se, trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, ndër të tjera moshën, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj. Si pasojë, diferencat në trajtim mbi bazën e moshës mund lejohen në rrethana të caktuara. Në këto raste, kufizimet që kanë si shkak

moshën, duhet të vlerësohet rast pas rasti dhe një vlerësim i tillë duhet të marrë parasysh të gjitha faktet dhe provat përkatëse, përfshirë natyrën e detyrave, të personave të përfshirë. Nuk është shkak i mbrojtur mbi të cilin bazohet diferenca në trajtim, por është karakteristika që lidhet me atë shkak, e cila duhet të përbëjë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme. Ministria e Brendshme nuk shpjegoi se, *cila është ajo karakteristikë*, e cila për shkak të natyrës apo kushteve në të cilat ushtrohet veprimtaria e punonjësve të rolit bazë apo të kontigjentit fillestar në Policinë e Shtetit. Ministria nuk ofroi asnjë shpjegim se ku konsistonte papërshtatshmëria e personave mbi moshën 30 vjeç, për të kryer detyrat e nivelit bazë. Ministria gjithashtu nuk ofroi asnjë shpjegim se mbi çfarë bazash kishte arritur në përfundimin se përse personat mbi moshën 30 vjeç, nuk premtinin për të bërë karrierë në nivelet më të larta. Komisioneri vlerësoi se, Ministria e Brendshme nuk identifikoi asnjë karakteristikë, e cila mund të lidhej me moshën, si një nga shkaqet e mbrojtura, për të vlerësuar më pas nëse kjo karakteristikë përbën ose jo një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme; nëse qëllimi i trajtimit të diferencues ishte i përligjur dhe nëse kjo kërkesë ishte proporcionale në raport me qëllimin që synohet të arrihet.

Ministria e Brendshme nuk vuri në dispozicion asnjë provë nëpërmjet të cilës të tregojë se limiti i moshës i vendosur si kriter për të aplikuar në Akademinë e Sigurisë është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme, për të arritur qëllimin e synuar atë të garantimit të një procesi të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme. Ministria e Brendshme nuk ofroi asnjë informacion apo shpjegim se përse, fazat e konkurimit dhe testimet e parashikuara nga Rregullorja e Policisë së Shtetit, por edhe procedurat standarte për pranimin në Akademinë e Sigurisë, nuk sigurojnë rekrutimin dhe pranimin e aplikantëve të cilët janë të përshtatshëm për kryerjen e detyrave për këtë nivel detyrash. Bazuar në fazat e konkurimit nëpër të cilat kalojnë aplikantët që duan të pranohen në Akademinë e Sigurisë, rezulton se aplikanti i nënshtrohet një sërë testimesh, për të vlerësuar përshtatshmërinë e tij.

Në lidhje me pretendimin tjetër të paraqitur nga Ministria e Brendshme, se personat mbi 30 vjeç, nuk premtojnë për të bërë karrierë në nivelet më të larta të policisë, Komisioneri vlerësoi se, një pretendim i tillë është i paqartë, pasi nuk jepet asnjë arsye se përse personat mbi mbi këtë moshë nuk premtojnë për të bërë karrierë. Shkolla Bazë e Policisë për “Patrullë e Përgjithshme”, e cila formon punonjës të rolit bazë, rezulton të ketë një kohëzgjatje totale 11 mujore, në përfundim të të cilës, pasi kursantët përfundojnë me sukses shkollimin, emërohen si punonjës policie. Pas emërimit si punonjës policie, fillon edhe marrëdhënia e punësimit dhe fillon ecuria në karrierë. Nëse mungesa e premisë vjen si pasojë e kohës që i duhet punonjësit për t’u formuar si punonjës policie në Shkollën Bazë dhe më pas për të ndjekur hapat dhe fazat e karrierës, në raport me moshën e daljes në pension, që për punonjësit e policisë në vitin 2020 është, 65 vjeç për burrat dhe për 61 vjeç për gratë, atëherë Ministria e Brendshme, nuk dha asnjë shpjegim se përse personat mbi moshën 30 vjeç, nuk premtinin për karrierë. Ecuria në karrierë deri në nivelet më të larta, nuk mund të përbëjë një qëllim në vetvete, pasi jo të gjithë personat që bëhen pjesë e Policisë së Shtetit mund të kenë aspirate për të arritur nivelet më të larta brenda kësaj organizatë.

Referuar çështjeve të trajtuara nga GjDBE dhe fakteve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, Komisioneri konstatoi se:

Ministria e Brendshme nuk arriti të shpjegojë se ku konsiston papërshtatshmëria e aplikantëve të cilët janë mbi 30 vjeç dhe nëse papërshtatshmëria lidhet me aspektin e aftësive fizike apo është e natyrave të tjera, në lidhje me psikologjinë apo me aspekte të inteligjencës. Ministria e Brendshme nuk ofroi asnjë shpjegim se si personat me moshë mbi 30 vjeç, nuk premtinin për karrierë. Nga ana e Ministrisë së Brendshme nuk u pretendua se papërshtatshmëria e aplikantëve mbi moshën 30 vjeç kishte të bënte me faktin e ata nuk zotërojnë kapacitetin e duhur fizik për ushtrimin e detyrave. Ministria e Brendshme, pretendoi vetëm se, aplikantët mbi këtë moshë kishin rezultuar të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të nivelit bazë që është “Patrulla e Përgjithshme”, por nuk dha asnjë arsye se pse personat mbi 30 vjeç janë të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të këtij niveli, Pra, çfarë natyre kanë detyrat që do të ushtrohen nga punonjësit e policisë së këtij niveli dhe për cilat arsye ato nuk mund të përmbushen nga personat mbi moshën 30 vjeç, duke shtuar këtu se nuk u ofrua asnjë shpjegim se përse testimet që kryhen gjatë konkurimit janë të pamjaftueshme për të vlerësuar në lidhje me përshtatshmërinë e aplikantëve me moshë mbi 30 vjeç.

Ecuria në karrierë në nivelet më të larta në Policinë e Shtetit nuk mund të shërbejë si një qëllim i ligjshëm në vetvete. Megjithatë, edhe nëse qëllimi do të ishte që të sigurohej një periudhë e arsyeshme punësimi përpara daljes në pension, deri në arritjen e kësaj moshe, që për punonjësit e policisë aktualisht është 65 për burrat dhe 61 për gratë, Komisioneri vlerësoi se, përcaktimi i moshës maksimale për rekrutimin e punonjësit të policisë, jo më shumë se 30 vjeç, nuk mund të justifikohet, pasi deri në mbushjen e moshës për pension ka një kohë të konsidrueshme që personi mund të punojë. Komisioneri arriti në përfundimin se, Ministria e Brendshme nuk paraqiti asnjë provë që të vërtetonte, se mosha limit e vendosur, është e përshtatshme dhe e nevojshme, për të arritur qëllimin e synuar atë të garantimit të karrierës, jo domosdoshmërisht në nivelet e larta apo të garantimit të një periudhe të arsyeshme punësimi përpara daljes në pension.

Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme nuk pretendoi dhe as nuk rezultoi nga informacioni i vendosur në dispozicion të Komisionerit, se rekrutimi i personave jo më shumë se 30 vjeç, mund të kishte *si qëllim për të siguruar kapacitetin operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor*, qëllim ky i cili është konsideruar nga GjDBE si një objektiv legjitim. Pasja e aftësive apo e një kapaciteti të caktuar fizik, është një karakteristikë e lidhur me moshën, sikurse është konstatuar nga praktika e mësipërme, tashmë e konsoliduar edhe në raste të tjera nga GjDBE, në lidhje me kufizimin e moshës së daljes në pension të pilotëve (*çështja C-447/09, Prigge dhe të tjerë kundër Deutsche Lufthansa AG, 13 shtator 2011*) apo në lidhje me vendosjen e moshës limit jo më shumë se 30 vjeç për rekrutimin e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (*çështja C-229/08, Wolf kundër Stadt Frankfurt am Main, 12 janar 2010*).

Ministria e Brendshme nuk pretendoi se vendosja e kriterit të moshës jo më shumë se 30 vjeç ishte vendosur për shkak se për kryerjen e detyrave nga ana e punonjësve të policisë së nivelit bazë kërkohen aftësi fizike të veçanta. Komisioneri kryesisht shteroi dhe analizoi edhe këtë aspekt të çështjes. Disa nga detyrat që kryen punonjësi i policisë, si mbrojtja e jetës, shëndetit, pronës publike dhe private apo mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike, mund të kërkojnë pasjen e një niveli të caktuar të kapacitetit fizik apo aftësi fizike në caktuar, me qëllim kryerjen e detyrave që policisë

së shtetit i ngakohen nga ligji. Rrjedhimisht pasja e një niveli të caktuar aftësish fizike për kryerjen e detyrave të punonjësit të policisë së shtetit mund të konsiderohet një kërkesë e vërtetë dhe profesionale e domosdoshme, me qëllim ushtrimin e këtij profesioni. Por, duhet që, kjo kërkesë, të jetë e përligjur dhe të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj. Nga informacioni i administruar nuk rezultoi asnjë e dhënë që të tregonte se përse personat mbi 30 vjeç nuk posedojnë këto aftësi të nevojshme fizike, që mund të nevojiten për ushtrimin e detyrave të këtij niveli dhe se si diferenca në trajtim e vendosur, nëpërmjet përcaktimit të një moshe maksimale për rekrutimin e punonjësve të policisë të nivelit bazë, është e përshtatshme dhe e domosdoshme për arritjen e qëllimit.

Zbatimi i parimit të barazisë, në rastin konkret në lidhje me moshën, nuk kërkon rekrutimin ose mbajtjen në punë, të personave që nuk janë të përshtatshëm për kryerjen e detyrave. Megjithatë, për sa kohë që trajtimi i ndryshëm i përligjur, ndër të tjera në lidhje me moshën, përbën një shmangie nga ky parim, atëherë edhe justifikimi ose përligja e trajtimit të ndryshëm, duhet të interpretohet ngushtësisht. Bazuar në provat dhe informacionin e administruar, nuk rezultoi e provuar se ku konsiston papërshtatshmëria e personave që janë më shumë se 30 vjeç, që duan të bëhen punonjës policie, në raport me ata që synojnë të njejtën gjë, por që janë jo më shumë se 30 vjeç. Në këto kushte, Ministria e Brendshme, nuk arriti të provojë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin më pak të favorshëm të personave të cilët janë mbi 30 vjeç në raport me personat jo më shumë se 30 vjeç, gjatë procesit të pranimit dhe konkurimit në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë, që përbën Shkollën Bazë të Policisë. Komisioneri arriti në përfundimin se, kriteri/rregullimi, që bëhet nga pika 2 (a), e Urdhrit Nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, trajton në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme personat të cilët janë “më shumë se 30 vjeç” në raport me personat të cilët janë “jo më shumë se 30 vjeç” dhe se një trajtim i tillë nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të kategorisë së personave “mbi 30 vjeç” për shkak të moshës, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion, përmes zbatimit të pikës 2 (a), të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”.
- Ministria e Brendshme, të marri masa për rishikimin e Urdhrit Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”, duke hequr kriterin kufizues në lidhje me moshën e personave që aplikojnë për pranim në Akademinë e Sigurisë, të vendosur në pikën 2 (a) të urdhrit të sipërcituar.

X. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR “ÇDO SHKAK TJETËR”

44. L.B., dhe A.N., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe M.I., Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, pranë QSUNT

VENDIM NR. 108, DATË 14.6.2021

Shkaku: Ankesat për shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve nga ana e punedhësit; Gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë dhe Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Në Gjykatë

Ankuesit L.B., dhe A.N., u diskriminuan në vendin e punës nga M.I., në cilësinë e eprores së tyre, për shkak të ankesave që ata kishin kundrejt saj, për shkelje të ligjeve dhe rregulloreve ndërsa QSUNT në cilësinë e punëdhënësit dështoi që të merrte masa efektive për t'i mbrojtur. L.B., u viktimizua si pasojë e paraqitjes së ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit pranë Komisionerit, duke iu zgjidhur kontrata e punës nga ana e QSUNT. A.N., është diskriminuar nga M.I., Shefe e Shërbimit për shkak të gjendjes arsimore duke u trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak se është specializante ndërsa QSUNT dështoi që të shqyrtonte në mënyrë efektive ankesën e bërë nga A.N., për shqetësim në vendin e punës nga ana e Shefes së Shërbimit M.I.

FAKTET

Ankuesi L.B., punon në QSUNT në pozicionin mjek pedagog, në Shërbimin e Laboratorit të Anatomisë Patologjike, në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent, që prej vitit 2005. Në datë 24.12.2020, ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e kontratës së shërbimit të nënshkruar midis tij dhe QSUNT.

Ankuesja A.N., është në QSUNT me statusin e mjekut specializant për ndjekjen e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, në programin e studimit të ciklit të tretë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë në degën Anatomico-Patologjike, për periudhën 15.5.2018 deri më datë 14.5.2022

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Rregullore e Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerëson se, marrëdhënia juridike midis ankuesit L.B., dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, pavarësisht se emërtimi formal i kontratës së nënshkruar nga palët është kontratë shërbimi. Puna ose shërbimi i ofruar nga ankuesi për QSUNT ofrohet në kuadër të organizimit dhe urdhrave të QSUNT-së. Pra, është QSUNT që ka kontrollin e punës. Kjo nënkupton që ankuesi është në varësinë e QSUNT, për sa i përket orarit dhe disiplinës në punë. Disiplinimi dhe orari i punës përcaktohet edhe në nenin 3, të kontratës që palët kanë nënshkruar. Puna ose shërbimi i ofruar nga ankuesi bëhet për përfitim të QSUNT dhe ankuesi e ofron shërbimin ose kryen punën që i ngarkohet, personalisht. Një nga aspektet me rëndësi në përcaktimin e faktit nëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune, është shpërblimi për punën ose shërbimin. Në rastin objekt shqyrtimi, shpërblimi i ankuesit bëhet në mënyrë periodike, kundrejt listëprezencave të mbajtura nga QSUNT dhe ky shpërblim nuk është i kërkueshëm nga ankuesi përmes faturave ose në përfundim të kontratës për punën e kryer ose shërbimin e ofruar. Referuar kontratës së nënshkruar nga palët, ankuesit i njihen të drejta të tilla si pushimi javor, dhe vjetor i paguar si dhe pushimi në ditët e festave zyrtare.

Bazuar në Rregulloren e Studimeve të Specializimeve Afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë mjeku specializentë angazhohet me kohë të plotë 40 orë në javë pranë strukturave ku është përcaktuar. Për punën dhe shërbimet e ofruara gjatë kohës që mjeku specializant kryen specializimin afatgjatë, atij i garantohet shpërblimi për punën/shërbimin e ofruar. Për rastin e ankueses A.N., janë njësoj të zbatueshme kriteret dhe arsyetimi i tyre si në rastin e ankuesit L.B. Ankuesja A.N., e kryen punën dhe shërbimin e saj pranë QSUNT, nën organizimin dhe urdhrat e kësaj të fundit, konform orarit dhe disiplinës të caktuar prej QSUNT; ankuesja e kryen punën/shërbimin personalisht dhe përfiton një shpërblim periodik; ankuesja gjithashtu si mjekë specializante është përfituese e pushimit javor dhe vjetor të paguar dhe përfiton pushim për ditët e festave zyrtare. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se natyra juridike e marrëdhënies së krijuar midis ankueses A.N., dhe QSUNT është një marrëdhënie juridike punësimi, dhe për rrjedhojë, pretendimet për diskriminim të ankueses do të trajtohet në kuadër të pretendimeve për diskriminim në fushën e punësimit.

Komisioneri gjykon se, diferencat në trajtim bazuar në faktin se, personat kanë paraqitur ankesa që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve nga ana punëdhënësit, duhet të gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se të dy ankuesit e mbartin këtë shkak.

Duke mbajtur në konsideratë se gjendja arsimore, si shkak diskriminimi, ka të bëjë ndër të tjera me nivelin individual të arsimit, Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankueses A.N., për

diferencë në trajtim për shkak të statusit të saj si mjekë specializante, gëzojnë mbrojtje në kuadër të shkakut të gjendjes arsimore dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme se ankuesja e mbart këtë shkak.

Rezultoi e provuar se, ankuesit i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm nga ana e M.I., Shefe e Shërbimit dhe QSUNT. Konkretisht, rezultoi e provuar se:

- Ankuesi L.B., dhe A.N., i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në kuadër të vendosjes së mungesave në listë prezenca dhe heqjen e ditëve të punës.
- Ankuesja A.N., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me kushtet e punës si mjekë specializante dhe se ankesa e saj për fyerje dhe sjelljeve të padëshiruara nga ana e Shefes së Shërbimit nuk është trajtuar në mënyrë efektive.
- Ankuesi L.B., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në kuadër të procedurave të ndjekura për zgjidhjen e kontratës me QSUNT.

Në kushtet kur, nga njëra anë rezulton e provuar se, ankuesit i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e M.I., Shefe e Shërbimit dhe QSUNT në lidhje me vendosjen e mungesave në listë prezenca dhe heqjen e ditëve të punës, dhe nga na tjetër, rezulton i provuara shkakut i diskriminimit i pretenduar nga ankuesit, QSUNT dhe M.I., Shefe e Shërbimit kishin barrën e provës për të provuar, që për veprimet e tyre kundrejt ankuesve ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Në rastin konkret, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesit janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankuesve është kryer për shkak se kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura kundër eprorit të tyre, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve. Në këto kushte M.I., Shefe e Shërbimit dhe QSUNT kishin barrën e provës që të provonin, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhnin poshtë pretendimet e ankuesve se këto veprime janë kryer për për shkak se kanë paraqitur ankesa dhe kanë marrë pjesë në procedura kundër eprorit të tyre, që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve. Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e tyre, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankuesve, mbetet shkakut i diskriminimit i pretenduar nga ankuesit.

Rezultoi se, vetëm mjekët specializantë përfshihen në shërbimin e recepsionit. Referuar planeve të punës për vitin 2021, specializantët figurojnë të angazhuar në një proces pune i cili figuron i pa emërtuar. Por, në krahasim me kopje të planeve të ngjashme të punës të Shërbimit të Anatomisë për vitin 2019, rezulton se procesi i cili, tashmë nuk emërtohet në planet e punës së shërbimit, rezulton të ketë të bëjë me shërbimin e recepsionit. Një konstatim i tillë bie në kundërshtim me pretendimet e M.I., se mjekët me statusin e specializantit kryejnë të njëjtat procese sikundër mjekët e tjerë të shërbimit. Në rastin konkret, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja për trajtimin e saj dhe të mjekëve të tjerë specializantë ndryshe nga mjekët e tjerë të shërbimit, janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankueses është kryer për shkak të gjendjes së saj arsimore. Në këto

kushte M.I., Shefe e Shërbimit nuk arriti të provojë se: nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis përfshirjes vetëm të mjekëve specializantë në bërjen e recepsionit, proces i cili sikundër shpjegimeve të dhëna nga M.I., nuk rezulton të jetë pjesë e proceseve që zhvillohen nga mjekët e shërbimit dhe gjendjes së tyre arsimore; ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, se përse bërja e recepsionit, që në fakt nuk është pjesë e proceseve që kryehen nga mjekët e shërbimit, kryehet vetëm nga mjekë specializantë, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankueses se këto veprime janë kryer për shkak të gjendjes së saj arsimore. Në bazë të Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Anatomisë Patologjike, ndarja e punës për personelin, është përgjegjësi e Shefit të Shërbimit.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja A.N., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të gjendjes së saj arsimore, pasi QSUNT ka dështuar që të trajtojë në mënyrë efektive ankesën e saj për sjellje të padëshiruara dhe fjalë fyese nga ana e M.I., Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike. Komisioneri gjykon se, QSUNT, nëpërmjet mosveprimit të saj për të shqyrtuar në mënyrë efektive pretendimet e ankueses për sjellje të padëshiruara, që i kanë cënuar asaj dinjitetin dhe kanë krijuar një mjedis armiqësor, përçmues dhe ofendues, ka dështuar për të mbrojtur në mënyrë efektive ankuesen nga sjellje diskriminuese.

Rezultoi e provuar se, ankuesi L.B., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga gjatë procedurës së zgjidhjes së kontratës dhe se arsyet e pretenduara për zgjidhjen e kontratës, nuk rezultuan të bazuara. Zgjidhja e kontratës i është njoftuar ankuesit me datë 24.12.2020, ndërkohë që njoftimi i Komisionerit për paraqitjen e ankesës me pretendim diskriminimi kundër QSUNT dhe M.I., nga ana e ankuesit, i është komunikuar këtyre subjekteve në datë 18.12.2020. Komisioneri arrin në përfundimin se, zgjidhja e kontratës së punës me ankuesin përbën një trajtim të disfavorshëm të ankuesit që ka ardhur si pasojë e ankesës për diskriminim të paraqitur pranë Komisionerit. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se, QSNUT e ka diskriminuar ankuesin duke e viktimizuar atë për shkak të ankesës që ai ka paraqitur pranë Komisionerit.

Sa i takon pretendimeve për diskriminim të ankuesit L.B., për diskriminim për shkak të *bindjeve fetare dhe gjendjes martesore*, mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u arrit të provohej trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe i pafavorshëm, i ankuesit lidhur me këto shkaqe.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesve L.B., dhe A.N., nga ana e M.I., me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të ankesave që përfshijnë shkelje të pretenduara të ligjeve ose rregulloreve nga ana punëdhënësit.
- Konstatimin e diskriminimit të ankueses A.N., nga ana e M.I., me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të gjendjes arsimore.

- Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankuesit L.B., nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në lidhje me momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit L.B., nga ana e M.I., me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të bindjeve fetare dhe gjendjes martesore.
- Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për rivendosjen në vend të cënimeve që ankuesit kanë pësuar në pagë, për shkak të heqjes së ditëve të punës.
- Në referencë të pikës 2, të këtij vendimi, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për trajtimin efektiv të ankesave për shqetësim në vendin e punës dhe parashikimin në rregulloret e saj të brendshme të proceduravë të posaçme për trajtimin e ankesave për diskriminim.
- Në referencë të pikës 2, të këtij vendimi, nga ana e M.I., me detyrë Shefe e Shërbimit të Anatomisë Patologjike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për ndërprerjen e trajtimit diferencues të mjekëve specializantë dhe mjekëve të tjerë të shërbimit dhe sigurimin e kushteve të barabarta në përfshirjen e mjekëve specializantë në proceset klinike.
- Në referencë të 3 të këtij vendimi, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të merren masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të L.B., duke e rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës.

45. A.M., kundër Shkollës së Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër

VENDIM NR. 80, DATË 18.05.2021

Shkaku: “Çdo shkak tjetër” (Për shkak të kallëzimit penal të bërë për Drejtoren e shkollës).

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në marrëdhëniet e punësimit, duke u larguar nga puna për shkak të kallëzimit penal të bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër kundër Drejtores së shkollës.

FAKTET

A.M., prej 17 vitesh ushtron profesionin e mësuesit në shkollën profesionale “Hamdi Bushati”. Në fund të vitit 2019 ka bërë kallëzim penal për drejtoreshën e shkollës për shpërdorim detyrë dhe abuzim me fondet publike dhe prokuroria ka vendosur hapjen e çështjes penale. Që nga ajo periudhë, drejtoresha e shkollës ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj tij, duke i dhënë disa masa disiplinore “Vërejtje” dhe në fund të vitit 2020 i ka dhënë masën disiplinore “Largim nga puna” me efekt të menjëhershëm.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Protokolle 12 i saj;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- “Karta Sociale Evropiane”, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Konventa Nr. 111 Organizata Ndërkombëtare e Punës ILO;
- Udhëzimit Nr. 11, datë 03.03.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”.

KONKLUZIONE

Pasojat negative në marrëdhëniet e punësimit të ankuesit nga ana e punëdhënësit, rezultojnë se në rend kronologjik ato kanë ardhur pas kontradiktave të muajit shtator dhe kallëzimit penal të bërë nga A.M., në datë 06.11.2019, kundër drejtoreshës së shkollës.

Komisioneri vlerëson se ankuesi është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt, pasi ai nuk ka patur në mënyrë efektive të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në lidhje me arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. Nga faktet dhe provat e administruara, rezultojnë se masat disiplinore, janë marrë të gjitha nga ana e drejtoreshës së shkollës, pa njoftuar fillimisht ankuesin, pa pasur një sinjalizim apo koordinim me nëndrejtorin që mbulon kulturën profesionale, i cili ka për detyrë që të mbikëqyr zbatimin e procesit mësimor dhe të monitorojë dokumentacionin shkollor, dhe pa pasur një propozim për dhënie mase disiplinore siç parashikohet në nenin 27, pika 3 të Rregullores së Brendshme të Shkollës “Hamdi Bushati”, datë 21.09.2017, në të cilën përcaktohet se: “Detyrat e kryetarit të degës financës-administrimit ... – Ndjek zbatimin e disiplinës në Shkollë dhe në rast të moszbatimit të tyre propozon masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi duke ia paraqitur titullarit”.

Komisioneri kërkoi nga ana e shkollës “Hamdi Bushati” informacion në lidhje raste të ngjashme të zgjidhjes së kontratës së punës apo dhënies së masave disiplinore me punonjës të tjerë me motivacion të ngjashëm me ankuesin, për të parë mënyrën dhe procedurat që shkolla kishte ndjekur. Në lidhje me këtë moment, shkolla “Hamdi Bushati” deklaroi se nuk ka pasur asnjë rast

të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe dhënies së masave disiplinore, gjatë periudhës nga data 01.10.2019 e në vijim.

Referuar sa më lart, në analizë të legjislacionit sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, procedura e ndjekur për largimin e A.M nga puna nga ana e drejtores së shkollës, është haptazi në shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë e normojnë marrëdhëniet e punës: punëmarrës-punëdhënës, siç janë: Dispozita e nenit 144 të Kodit të Punës dhe të nenit 35/3 të Udhëzimit Nr. 11, datë 03.03.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, në të cilën përcaktohet se: *“Mësimdhënësi ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i ofruesit të AFP-së, përpara se ky i fundit të nisë procedurën për largimin e tij”*.

Komisioneri arrin në përfundimin se shtetasi A.M., është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e Shkollës së Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër, trajtim i cili ka ardhur si pasojë pas kontradiktave dhe kallëzimit penal të bërë nga ankuesi kundër drejtores së shkollës.

Komisioneri vlerëson se ankuesi në vijimësi, është vënë në dijeni nga ana e AKPA-së, se bazuar në legjislacionin e sipërcituar, është drejtuesi i institucionit që ka tagrin ligjor për dhënien e masave disiplinore dhe AKPA-ja në kryerjen e funksioneve të saja nuk ka kompetencë rishikimin e masave disiplinore të personelit mësimdhënës.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nuk është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e AKPA-së.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të A.M., në të drejtën për punësim, nga ana e Shkollës së Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër për shkak të kontradiktave dhe kallëzimit penal të bërë nga ankuesi kundër drejtores së shkollës.
- Në referim të pikës 1, Shkolla e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkodër të marrë masa për rikthimin e A.M., në pozicionin e mëparshëm të punës.

46. S.S., kundër shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier

VENDIM NR. 40, DATË 08.03.2021

Shkaku: Çdo shkak tjetër/ankimimi për diskriminim pranë KMD-së
Forma: Diskriminim në formën e viktimizimit dhe në formën e rëndë të tij
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja është diskriminuar nga shkolla 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë, Fier, në marrëdhëniet e punësimit, për shkak të ankimit të saj për diskriminim kundrejt Drejtorit të Shkollës.

FAKTET

Subjekti ankues, S.S., është me profesion mësuese e lëndës gjuhë-letërsi prej 25 vitesh. Për një periudhë 15 vjeçare ka punuar në shkollën 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier. Ankuesja ka provuar se, pas ankesës së mëparshme pranë KMD, me datë 31.12.2019, ku më parë kishte pretenduar diskriminim nga ana e Drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë, Fier, pasi diskriminimi ndaj saj, jo vetëm nuk është ndërprerë nga ana e Drejtorit, por ka vazhduar në formën më të rëndë, atë të viktimizimit, duke e pushuar nga puna, për shkak të ankimit për diskriminim pranë Institucionit të KMD-së.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolle 12 i saj;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë;
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 Prill 2000, paragraf 44 (ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44). Po kështu, GJEDNJ, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 Prill 2002, paragraf 88 (ECtHR, *Pretty v. the United Kingdom* (No. 2346/02), 29 April 2002);
- “*Karta Sociale Europiane*”, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH, i ndryshuar*”;
- Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020 “*Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerësoi se për sa i takon përkeqësimit të pasojave negative në marrëdhëniet e punësimit të ankueses nga ana e punëdhënësit, Shkollës, rezultoi se në rend kronologjik ato kanë ardhur pas ankesës së saj me pretendim diskriminim nga Shkolla, dhe gjatë periudhës së shqyrtimit nga ana e Komisionerit. Ankuesja është larguar nga puna me datë 18.09.2020, ndërkohë që KMD është shprehur me vendim me datë 28.10.2020.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Shkollës nuk u arrit të provohej:

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankueses nuk kanë ndodhur pas ankimimit të saj për diskriminim të Drejtorit të Shkollës pranë KMD-së, apo që ato të kishin një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale të justifikuar dhe objektive.
- Përkundrazi, u provua e kundërta, që ndaj ankueses është dhënë masa disiplinore “Largim nga puna”, pikërisht gjatë periudhës kur ankesa e saj ishte në shqyrtim pranë Komisionerit.
- Shkolla nuk arriti të dokumentojë ligjshmërinë e ngritjes së dy komisioneve: Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës, të cilët, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duhet të ngriheshin me urdhër të titullarit të institucionit në fillim të vitit shkollor 2020-2021.
- Nuk u soll dokumentacion provues lidhur me sa kishte kërkuar Komisioneri/urdhërat për ngritjen e këtyre komisioneve. Shkolla depozitoi vetëm procesverbalet e mbajtura në takimet e tyre.
- Që Komisioni i Etikës kishte zbatuar afate të arsyeshme njoftimi për ankuesen për dëgjuesën e saj në këtë Komision. Ajo ishte njoftuar nëpërmjet emailit vetëm një ditë përpara për t’u paraqitur në takim.
- Që mënyra dhe orari i njoftimit të ankueses për t’u paraqitur në Komisionin e Etikës, nëpërmjet emailit të orës 21:04 është e përshtatshme. Ora 21:04 nuk është brenda orarit zyrtar të punës, dhe afati i caktuar nga Komisioni për të nesërmen është i paarsyeshëm, në kontekst të respektimit të afatit kohor për të realizuar mbrojtjen e saj.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstaton se, lidhur me Komisionin Disiplinor:

- Shkolla nuk depozitoi asnjë dokument, urdhër për procedurën e ndjekur për ngritjen e Komisionit të Disiplinës.
- Të dyja komisionet e kanë paragjykuar haptazi ankuesen, pasi rezultoi se, vetë anëtarët e të dyja komisioneve kanë marrë në shqyrtim edhe deklaratat e veta lidhur me ngjarjen e datës 09.09.2020, duke e gjykuar në mënyrë tërësisht subjektive atë.
- Bazuar në procesverbalin e mbajtur në Komisionin e Disiplinës, rezultoi se, drejtuesi i Komisionit që mban detyrën e Drejtorit të Shkollës, ka cituar se janë marrë në konsideratë deklaratat e dorëzuara nga mësuesit cituar më lart në vendim (ndër të cilët janë edhe të gjithë anëtarët e Komisionit Disiplinor), si dhe ka cituar se: “*Mësuesja S.S., ka thyer Urdhrin Nr. 493, datë 30.07.2018 për mospërdorimin e telefonit celular*”.

Lidhur me këtë shkelje të pretenduar nga ana e Komisionit të Disiplinës, Komisioneri vlerëson se është e pabazuar dhe jo logjike për arsye se:

- Nëpërmjet Urdhri Nr. 493, datë 30.07.2018, urdhërohet ndalimi i përdorimit të telefonit celular gjatë procesit mësimor nga mësuesit dhe nxënësit në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar.
- Ngjarja e shqyrtuar në komision daton më 09.09.2020.
- Bazuar në Urdhri e përbashkët me Nr. 71, datë 25.02.2020 “Për miratimin e strukturës së viti shkollor 2020-2021 në sistemin arsimor parauniversitar”, është përcaktuar se, në arsimin parauniversitar, mësimet fillojnë më datë 14.09.2020.

Pra, pretendimi i Komisionit se ankuesja ka shkelur urdhrin për mos përdorimin e celularit gjatë procesit mësimor nuk qëndron, është i pabazuar në dokumentacion dhe alogjik, pasi ankuesja celularin nuk e ka përdorur gjatë procesit mësimor, por në oborrin e Shkollës, në ambjentet e jashtme të saj, më datë 09.09.2020, kur ende nuk kishte filluar procesi mësimor.

Ankueses nga ana e Komisionit nuk i është vënë në dispozicion paraprakisht asnjë dokument, në mënyrë që ajo të njihej me pretendimet, përmbajtjen dhe provat e paraqitura kundër saj dhe të kishte mundësi të paraqiste observacionet si dhe të mbrohej efektivisht, në respektim të parimit të barazisë së armëve në këtë proces disiplinor të ndërmarrë kundrejt saj.

Nga ana tjetër, vetë Komisioni i Disiplinës nëpërmjet dhënies së masës disiplinore “Largim nga puna” të ankueses dhe propozimit për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës, drejtuar titullarit të Shkollës, ka shkelur përcaktimet e Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka përcaktuar në mënyrë të qartë se, masat disiplinore duhet të jepen në mënyrë të përshkallëzuar.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Shkollës nuk u arrit të provohej, dokumentohej se kishte ndjekur dhe zbatuar procedurën e rregullt ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës me të.

Është shkelur e drejta e ankueses për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht i njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e Shkollës.

Nisur nga kronologjia e fakteve dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, se masa disiplinore ndaj ankueses dhe largimi i saj përfundimtar nga puna, kanë ardhur pas ankimit për diskriminim të saj para Komisionerit, ndërkohë që çështja e saj ishte ende në shqyrtim pranë KMD-së, dhe ende Komisioneri nuk ishte shprehur me vendim përfundimtar lidhur me pretendimet e ankueses.

Në përfundim për sa më sipër, bazuar në analizimin e provave të depozituara nga palët në proces, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon bindjen e brendshme dhe vlerëson se subjekti ankues, S.S., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë në formën e viktimizimit, nga ana e shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte pas ankimit të saj për diskriminimin për shkak të konfliktit të krijuar mes saj dhe Drejtorit të Shkollës, para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

VENDIMI

- Konstatimi i diskriminimit në formën e viktimizimit, të S.S., nga ana e shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier, për shkak të ankimit për diskriminim, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Konstatim i diskriminimit në formën e rëndë të tij, të S.S., nga ana e shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier.
- Në referencë të pikës 1 dhe 2, të këtij vendimi, Komisioneri kërkoi nga ana e shkollës 9-vjeçare “Feride Begaj”, Gorishovë/Fier, të merren masa për rikthimin e S.S., në punë.

47. I. A., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUNT)

VENDIM NR. 151, DATË 11.08.2021

Shkaku: Çdo shkak tjetër/prononcimet publike të tij, lidhur me menaxhimin që iu bë situatës së pandemisë nga ana e QSUT dhe shërbimit shëndetësor në Shqipëri.

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë

Fusha: Punësim

Statusi: Në gjykatë

Ankuesi në detyrën e mjekut pranë QSNUT, duke e diskriminuar përmes mohimit të lirisë së shprehjes në periudhë pandemie.

FAKTET

Subjekti ankues, ka qenë i punësuar si mjek në sistemin shëndetësor në Shqipëri, pa shkëputje, që prej datës 01.10.1993. Ai ka qenë në marrëdhënie pune në detyrën e mjekut pranë Urgjencës.

Ankuesi ka provuar se për shkak të gjendjes së pandemisë, ka qenë shpesh herë i ftuar në media të ndryshme, në cilësinë e mjekut, ashtu si shumë mjekë të tjerë, për të folur për situatën e pandemisë dhe menaxhimin e saj në vend.

Për shkak të qasjes së tij në media apo në faqen personale në rrjetin social “Facebook”, nga ana e QSUNT i është komunikuar njoftimi për zhvillimin e takimit për rishikim të marrëdhënieve të punës. Takimi është zhvilluar me datë 24.12.2020, dhe sipas procesverbalit të takimit, të gjitha pyetjet që i janë drejtuar atij nga ana e përfaqësuesve të QSUNT kishin të bënin me lirinë e shprehjes që ai ka ushtruar gjatë pandemisë.

Pas këtij takimi, ankuesit i është komunikuar ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës me punëdhënësin QSUNT, duke cituar ndër të tjera si motivacion, shkeljen e rëndë të Kodit Etik të QSUNT, pikave 4.4 dhe 4.5 të nenit IV “Ruajtja e informacionit dhe komunikimit me publikun”.

Zgjidhja e kontratës së punës është krejtësisht abuzive nga ana e QSUNT, pasi atij si mjek i është mohuar liria e shprehjes në periudhë pandemie, në kohën kur të gjithë mjekët janë shprehur publikisht në lidhje me menaxhimin e kësaj situatë, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokollin 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: çështja “Guja k. Kundër Republikës së Moldavisë”, çështja Matüz k. Hungarisë, çështjet “*Lingens kundër Austrisë*” dhe “*Dalban kundër Rumanisë*”;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut;
- “*Karta Sociale Europiane*”, e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 123/2014 “*Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, vlerësoi se: Të ndodhur para situatës së prezumimit të diskriminimit nga QSNUT kundrejt ankuesit, në këtë rast, barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, QSNUT duhet të provonte se pretendimi i ankuesit ishte i pabazuar në fakte e prova dhe se veprimet e tyre ishin të ligjshme, të drejta, proporcionale, të arsyeshëm dhe të justifikuar objektivisht.

Lidhur me argumentat e dhënë nga QSUNT, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, Komisioneri vlerëson se nuk qëndrojnë, dhe se, referimi tek baza ligjore e cituar në vendimin për largimin e tij nga puna, është i gabuar dhe i keqzbatuar në këtë rast, për arsytet poshtëcituar:

- Në aktet e mësipërme që normojnë marrëdhënien juridike të punës mes ankuesit dhe punëdhënësit, nuk është e parashikuar dhe e përcaktuar se cilat janë rastet konkrete që duhen konsideruar si “*shkelje të rënda*”.
- Pavarësisht këtij fakti, bazuar në përcaktimet e nenit 12, të Kontratës Individuale të Punës, Komisioneri konstaton se, rasti i pretenduar nga QSUNT kundrejt ankuesit, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikura në këtë Kontratë, që sipas përcaktimit të saj, të mund të quhej shkelje disiplinore, mbi bazën e të cilës, më pas mund të ndërmerrej dhe masa disiplinore përkatëse.

Komisioneri gjykon se, QSUNT nuk ka arritur të provojë pretendimet e saj se deklarimet e ankuesit në media, me datë 10.11.2020, përbëjnë shkelje të rëndë të Kodit të Etikës apo të jenë të rreme e të kenë shkaktuar panik.

Referuar bisedës së zhvilluar mes gazetares dhe ankuesit, rezulton se mjeku I.A., ka folur për pandeminë, menaxhimin e saj në përgjithësi, pa nxjerrë asnjë të dhënë konfidenciale, apo që kishte të bënte me QSUNT. Deklarimet për të sëmuret që presin nëpër autoambulanca janë të pasqyruara në dhjetëra media televizive të asaj periudhe.

Lidhur me argumentin e sjellë nga QSUNT se të gjithë mjekët para se të dalin nëpër media me deklarime publike duhet të marrin leje paraprakisht nga Zyra e Informacionit të QSUNT, dhe se vetëm ankuesi nuk ka ndjekur këtë procedurë, Komisioneri vlerëson se, ai është i pabazuar në fakte dhe prova dhe nuk qëndron.

Kështu, ankuesi ka përdorur për analogji rastin e mjekes N.Ç., e cila ka dalë publikisht nëpër media të ndryshme televizive, duke ndarë opinionin dhe mendimet e saj lidhur me menaxhimin e pandemisë, si nga QSUNT, ashtu dhe nga institucionet e tjera të shërbimit shëndetësor në vend.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nga QSUNT;

- Nuk u soll asnjë dokument që të provonte se mjekja N.Ç., apo mjekë të tjerë, (pasi është fakt i gjithëditur se mjekë të ndryshëm të QSUNT kanë dalë shpesh gjatë periudhës së pandemisë dhe vijnë të dalin në media të ndryshme, duke ndarë opinione dhe mendimet e tyre lidhur me situatën e pandemisë në vend), të kishin paraqitur kërkesa paraprakisht dhe që Zyra e Informacionit të QSUNT të kishte miratuar ndonjë kërkesë për daljen publike të saj/tyre në media lidhur me dhënien e mendimeve e opinioneve të tyre personale apo institucionale.
- Bazuar në analizimin e veprimeve të QSUNT kundrejt mjekut I.A., bazës ligjore tek e cila janë referuar masat kundrejt tij, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë krahasuar me mjeken N.Ç., përse i takon ndëshkimit të tij si pasojë e mosmarrjes leje paraprakisht nga Zyra e Informacionit, për të dalë në media për të ndarë opinione me publikun për situatën e pandemisë në vend.
- Në intervistën në fjalë, e cila ka shërbyer si shkak për largimin e tij nga puna, ankuesi në asnjë moment nuk ka bërë deklarime në emër të institucionit, por ka dhënë mendime personale si mjek, i cili ushtronte detyrën pranë QSUNT, lidhur me menaxhimin e pandemisë, pa nxjerrë asnjë të dhënë konfidenciale të ndonjë pacienti apo QSUNT.

Komisioneri ka vlerësuar në arsyetimin e tij se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë krahasuar me mjeken N.Ç., përse i takon deklarimeve publike në mediat e ndryshme audiovizive, lidhur me pandeminë; si dhe subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, nga ana e QSUNT përse i takon ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me të.

Fakti i trajtimit të ankuesit në mënyrë të pabarabartë me mjeken N.Ç., është pranuar nga ana e punëdhënësit, me argumentimin se ajo kishte marrë leje paraprakisht nga instancat përgjegjëse lidhur me daljen e saj në media për të bërë deklarata përse i takon ndarjes së opinioneve personale apo në emër të institucionit, lidhur me menaxhimin e pandemisë nga strukturat përkatëse apo dhe vetë QSUNT.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, QSUNT nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që N.Ç., kishte marrë leje paraprakisht.

Në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, ky justifikim i përdorur nga QSUNT për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtën e tij kushtetuese për lirinë e shprehjes.

Komisioneri vlerësoi se është krejtësisht e pajustificuar që ankuesit në detyrën e mjekut, t'i mohohet e drejta e fjalës në publik dhe liria e shprehjes, sidomos për periudhën në fjalë, në gjendje pandemie kombëtare e botërore, kur të gjithë mjekët janë shprehur dhe kanë dalë publikisht me opinione personale, lidhur me menaxhimin e kësaj situatë të re dhe të panjohur jo vetëm për sistemin shëndetësor shqiptar, por edhe atë botëror. Kjo jo vetëm në kuadër të ndarjes së mendimit profesional si mjek, por edhe në kuadër të së drejtës së publikut/popullatës për t'u njohur me to.

Në këtë logjikë, është plotësisht e kuptueshme që edhe në opinionin e brendshëm të specialistëve të fushës së mjekësisë në rang kombëtar, të kishte opinione dhe qasje të ndryshme individuale, lidhur me funksionimin e sistemit shëndetësor në vend apo menaxhimin e kësaj situatë, si nga ana protokollare mjekësore, ashtu dhe për sa i takon masave të ndërmarra nga instancat më të larta shtetërore, si MSHMS apo Qeveria dhe Komiteti Teknik i Ekspertëve. Për rrjedhojë as ankuesi nuk mund të përjashtohet nga e drejta për të pasur opinionin e tij, si dhe për ta shprehur atë publikisht.

Komisioneri gjykon se, shfaqja dhe bërja publike e mendimeve, opinioneve, problematikave, të metave dhe dhënia e ideve të ndryshme në lidhje me trajtimin e pandemisë, në një vend demokratik nuk mund të konsiderohen si deklarime që shkaktojnë panik, pasi, debatimi i problematikave i ka shërbyer dhe i shërben përmirësimit të sistemit shëndetësor, efijencës së tij, dhe përmbushjes së misionit për mbrojtjen e shpëtimit të jetës.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri konstatoi se QSUNT ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënieve të punës me të, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm por është bërë për shkak të prononcimeve të tij publike në media dhe deklaratave, opinionit të tij personal dhe qëndrimit të tij kritik ndaj institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e situatës së pandemisë dhe gjendjes së sistemit shëndetësor në vend.

VENDIMI

- Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, I.A., nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, në të drejtën për punësim, për shkak të prononcimeve të tij publike në media, deklaratave dhe qëndrimit të tij ndaj institucioneve përgjegjëse, lidhur me menaxhimin e situatës së pandemisë dhe gjendjes së sistemit shëndetësor në vend.
- Në referim të pikës 1, të vendimit, Komisioneri kërkoi nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUNT), të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

48. Y.S., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.,

VENDIM NR. 157, DATË 24.08.2021

Shkaku: Për shkak të ankimit në gjykatë kundër punëdhënësit
Forma: Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Y.S., është diskriminuar nga punëdhënësi duke i zgjidhur kontratës së punës me të si Kryespecialistit, në Drejtorinë Juridike në Administratën e Shoqërisë Albpetrol sh.a., pasi në vitin 2020, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me ankim, me objekt konstatimin e diskriminimit kundrejt punëdhënësit.

FAKTET

Shtetasi Y.S., ka qenë në marrëdhënie pune në pozicionin e Kryespecialistit, në Drejtorinë Juridike në Administratën e Shoqërisë Albpetrol sh.a. Në vitin 2020, ka konstatuar se i është mbajtur nga paga mujore një shumë për të cilën nuk është vënë në dijeni nga ana e punëdhënësit. Në këto kushte, ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me ankim, me objekt konstatimin e diskriminimit si rezultat i cënimit të pagës nga ana e punëdhënësit.

Pasi B.Z., është emëruar në pozicionin e Administratorit të ri të Shoqërisë Albpetrol sh.a., ka thirrur ankuesin dhe i ka kërkuar të heq dorë nga procesi gjyqësor, në të kundërt do t'i duhej të jepte dorëheqjen. Gjithashtu, e njëjta kërkesë për heqjen dorë nga procesi gjyqësor, i është bërë edhe nga ana e Drejtorit të Departamentit Juridik, R.Ç.

Në kushtet që ankuesi nuk ka pranuar të heqë dorë nga procesi gjyqësor kundër punëdhënësit të tij, menjëherë është transferuar, nga pozicioni “Krye/specialist” i Drejtorisë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shoqërisë Albpetrol sh.a., në pozicionin e punës “Specialist zyre dhe i kontratave” pranë Qendrës së Furnizimit dhe Transportit Patos, qendër në varësi të Shoqërisë Albpetrol sh.a. Ky transferim, ndryshon kushtet thelbësore të kontratës së punës, e para e ul në detyrë, dhe e dyta cënon pagën e tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- Karta Social Evropiane e rishikuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;

- Vendimi Unifikues Nr. 127, datë 10.04.2014, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lart;
- Rregullore e Brendshme e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstatoi se transferimi i ankuesit nga pozicioni i Specialistit të Sektorit të Përfaqësimit në Drejtorinë Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, në pozicionin e punës “*Specialist zyre dhe i kontratave*” pranë Qendrës së Furnizimit dhe Transportit Patos, ka ardhur pa arsye të justifikuara.

Pra, nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative subjektit ankues nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a., i kanë ardhur menjëherë pas ankimit të tij në gjykatë.

Rezultoi i provuar se ankuesi me shkresë zyrtare, i është drejtuar punëdhënësit duke i kërkuar ndër të tjera të ndal veprimet diskriminuese ndaj tij. Pra, shoqëria Albpetrol sh.a., ka qenë në dijeni të faktit që me veprimet e saj, ankuesi po ndjehet i diskriminuar për shkak të ankimit të tij në organet gjyqësore.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi se Y.S., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë në formën e viktimizimit, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a., trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e ankimit të tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankuesit Y.S., në të drejtën për punësim, për shkak të ankimit në gjykatë, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a.
- Në referim të pikës 1, shoqëria Albpetrol sh.a., të marrë masa për rivendosjen në vend të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

49. T.B., kundër Qendrës Shëndetësore Gramsh¹⁵ dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

VENDIM NR. 258, DATË 29.12.2021

Shkaku: Çdo shkak tjetër (për shkak të ankimit në gjykatë)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Diskriminimi, i T.B., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Shëndetësore Gramsh për shkak të ankimit në gjykatë kundrejt punëdhënësit.

FAKTET

T.B., ka punuar në pozicionin e mjekut pediatër pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, që prej vitit datës 12.11.1973. Pas mbushjes së moshës për pension pleqërie, ankuesi ka bërë kërkesë për të punuar sërish pranë kësaj Qendre. Qendra Shëndetësore Elbasan i ka kërkuar Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan, shtyrjen e afatit të daljes në pension të Dr. T.B., duke theksuar se është i vetmi mjek pediatër që mbulon qytetin e Gramshit. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor ka bërë të ditur se kërkesa nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kërkesa e ankuesit dhe e disa mjekëve të tjerë është refuzuar, për shkak të procedurës me të meta, që është ndjekur nga qendrat shëndetësore. Ministria ka orientuar Drejtorinë Rajonale rreth procedurave korrekte, që duhet të ndërmerren përpara se të kërkojnë shtyrje të afatit për daljen në pension të mjekëve, që shfaqin vullnet për të punuar, pasi kanë mbushur moshën e pensionit.

Në vijim të kësaj përgjigjeje, Qendra Shëndetësore Gramsh ka zgjidhur marrëdhënien e punës me Dr. T.B. Zgjidhja e kontratës është bërë në mënyrë të menjëhershme, duke mos i njohur ankuesit asnjë kontribut dhe duke mos i caktuar asnjë shpërblim për vjetërsinë në punë. Për këtë arsye, ankuesi i drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për ta zgjidhur çështjen gjyqësisht. Para se t'i drejtohej gjykatës, ankuesi ka kërkuar nga Qendra Shëndetësore Gramsh ta rishikojë vendimin e saj, pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nuk ka kërkuar zgjidhjen e kontratës së punës, por kryerjen e rregullt të procedurave para se të bëhej rinovimi i kontratës së punës. Gjatë kësaj periudhe kohore, MSHMS rishikoi vendimin dhe rekomandoi rilidhje të kontratës së punës për T.B. Shkëputja nga marrëdhënia e punës zgjati 3 muaj, arsye për të cilën edhe masa e dëmshpërblimit që u kërkuar gjyqësisht u kufizua në 3 paga, pa përfshirë këtu shpërblimin për vjetërsinë në punë.

¹⁵ Në vijim do t'i referohemi me akronimin QSH Gramsh.

Kontrata e re e lidhur me mjekun T.B., ishte një kontratë me afat të caktuar. Përpara përfundimit të afatit të përfundimit të kontratës së punës, ankuesi paraqiti kërkesë të re për shtyrje të kësaj kontrate, sikurse kishte bërë më parë, por kërkesa e tij për lidhje të kontratës së punës është refuzuar nga MSHMS.

Ankuesi, vë theksin në faktin, se mosrinovimi i kontratës së tij individuale të punës është bërë për shkak të ankimit të tij në gjykatë, kundër Qendrës Shëndetësore Gramsh. Sipas tij, në shkresën e kësaj Qendre drejtuar Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Elbasan dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, këto institucione janë bërë me dije se procesi gjyqësor i nisur nga ankuesi dhe vlefata e shpërblimeve të kërkuara nga ai përbëjnë dëm ekonomik për Qendrën Shëndetësore Gramsh, si dhe ankuesi konsiderohej se kishte shkelur parimin e mirëbesimit dhe bashkëpunimit të përcaktuara në Kodin e Punës, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Në vijim, Qendra Shëndetësore Gramsh e njofton ankuesin T.B., për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi afati i kontratës individuale të punës kishte përfunduar.

Mosrinovimi i kontratës së punës, pas përfundimit të kontratës paraardhëse me afat 6 mujor, pretendohet si diskriminim i mjekut T.B., për shkak të ankimit të tij në gjykatë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁶ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”,
- Karta Sociale Europiane¹⁷,
- Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, pika 5, germa c),
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

QSH Gramsh ka sqaruar se nuk është organi vendimmarrës, lidhur me refuzimin e rinovimit të kontratës së punës së mjekut T.B., pasi këtë tagër e ka MSHMS, ndërkohë që nga hetimi i KMD-së rezultoi se shkresa e kësaj Qendre ka qenë arsyeja, përse mjekut T.B. nuk i është rinovuar kontrata e punës me afat të caktuar dhe MSHMS ka refuzuar vazhdimin e punësimit me këtë mjek. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj shkrese rezultoi se është paragjykuar e drejta e ankuesit për zhdëmtim në përputhje me ligjin, lidhur me pretendimin e tij se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të QSH Gramsh.

Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se kjo është një e drejtë kushtetuese, që parashikohet shprehimisht në nenin 44, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për sa kohë që, ankuesi ka vlerësuar se Qendra Shëndetësore Gramsh duhet ta dëmshpërblejë për ndërmarrjen e veprimeve të

¹⁶ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁷ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

pretenduara si të padrejta ndaj tij, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Në këtë sens, përgjegjësia bie edhe mbi MSHMS në cilësinë e institucionit epror.

Ankuesi ka punuar për 9 vite rresht pas mbushjes së moshës për pension pleqërie, si mjek pediatër, duke lidhur në mënyrë të përsëritur, kontrata pune me afat të caktuar, ndërkohë që vetëm pas ankimit të tij në gjykatë kundër QSH Gramsh, marrëdhëniet e tij të punës përfundojnë definitivisht, edhe pse pozicioni i punës së mjekut pediatër është ende vakant pranë QSH Gramsh. KMD gjykoj gjithashtu se fëmijëve të qytetit të Gramshit u është mohuar e drejta për të patur mjekun e tyre pediatër, aq më tepër në një periudhë shumë të vështirë pandemie. Në kushtet e pandemisë Covid-19, kur mjekët e familjes pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, sikurse të gjithë mjekët e tjerë me profil të tillë dhe jo vetëm, në qendrat shëndetësore në mbarë Shqipërinë, kanë ngarkesë të konsiderueshme pune, sidomos me pacientët e infektuar me Covid-19, atyre u është lënë edhe ngarkesa e punës së mjekut pediatër.

Komisioneri gjykoj se pavarësisht faktit se në lidhjen e një kontrate punësimi duhet të ekzistojë liria kontraktore punëmarrës-punëdhënës dhe kontrata në vetëvete është një akt dakordësie ndërmjet dy palëve, të cilat shprehin vullnetin e tyre lirisht për të hyrë në marrëdhënie punësimi, duke marrë përsipër detyrime dhe duke gëzuar të drejtat respektive, në rastin konkret është konstatuar se Qendra Shëndetësore Gramsh ka pasur tendencë jo pozitive ndaj ankuesit, pasi ka interpretuar si cënim të parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit, veprimin e tij, në zbatim të një të drejte kushtetuese.

KMD gjykoj se refuzimi i rinovimit të kontratës së punës me afat të caktuar të T.B., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfundimi i marrëdhënieve të punës nga ana e Qendrës Shëndetësore Gramsh, është bërë për shkak të ankimit të tij në gjykatë, duke e diskriminuar ankuesin për këtë shkak.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të T.B., për shkak të ankimit në gjykatë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Shëndetësore Gramsh.

50. Gj.V., kundër Shoqërisë RT Minerals sh.p.k.

VENDIM NR. 64, DATË 16.04.2021

Shkaku: Gjendja gjyqësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi Gj.V., është diskriminuar në të drejtën për punësim, pasi i është zgjidhur marrëdhënia e punës për shkak të gjendjes gjyqësore.

FAKTET

Ankuesi Gj.V., ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë RT Minerals sh.p.k. Ai ka filluar punë pranë kësaj shoqërie në datën 09.08.2018, në pozicionin e punës “punëtor krahu, armator nën tokë”. Marrëdhënia e punës midis ankuesit dhe Shoqërisë RT Minerals sh.p.k., ka zgjatur deri në datën 20.12.2019, datë në të cilën ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në mënyrë të menjëhershme. Shkaku i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës ka qenë fakti se në datën 19.12.2019, ankuesi është konstatuar ne shkelje, duke përvetësuar një sasi tel bakri. Ankuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “vjedhja”, për vjedhjen e një sasive tel bakri me peshë 2.8 kg. Ky vendim ka marrë formë të prerë. Pas dhënies së vendimit nga ana e gjykatës, ankuesi i është drejtuar Shoqërisë RT Minerals sh.p.k., duke i kërkuar që t’i vendosej në dispozicion librezat e punës, paga e papaguar e muajit dhjetor 2019, si dhe likuidimi i lejes së zakonshme të pakryer, por nuk ka marrë zgjidhje.

Shoqëria RT Minerals sh.p.k., deklaroi se paga e muajit dhjetor 2019 dhe pagesa e lejes vjetore të pakryer, nuk mund t’i paguheshin ankuesit, pasi ky i fundit është debitor ndaj shoqërisë, si pasojë e veprës penale të vjedhjes të kryer në dëm të saj dhe se shoqëria trajton në të njëjtën mënyrë të gjitha rastet kur punonjësit kanë kryer një vepër penale. Në këto kushte ajo nuk e ka trajtuar ankuesin në mënyrë më pak të pafavorshme se sa një punonjës tjetër në një situatë të njëjtë ose të ngjashme. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, ankuesi arriti të marrë në dorëzim librezën e punës.

Ankuesi pretendoi se sjellja e Shoqërisë RT Minerals sh.p.k., duke mos i dhënë të drejtat që sipas ligjit i takojnë, pra dhënia e librezës së punës, paga për punën e kryer në muajin dhjetor 2019 dhe leja vjetore e pakryer, është diskriminuese dhe bazohet në gjendjen e tij gjyqësore, si pasojë e vendimit penal të marrë ndaj tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

- Karta Sociale Europiane, e rishikuar;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi Gj.V., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga Shoqëria RT Minerals sh.p.k. Ankuesi i cili nuk ka kryer pushimet vjetore, ka patur të drejtën e një shpërblimi të barabartë me pagën e këtyre pushimeve dhe një shpërblim i tillë nuk kushtëzohet nga mënyra e zgjidhjes së kontratës së punës. Në përfundim të marrëdhënieve të punës, ky shpërblim i jepet punëmarrësit në çdo rast, mjafton që të vërtetohet që ai nuk e ka konsumuar lejen vjetore.

Duke deklaruar se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të njëjtë si të gjithë personat në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, pasi çdo debitor i shoqërisë merr të njëjtën përgjegjësi, shoqëria përforcon faktin se ajo diferencon punëmarrësit bazuar në faktin se ata janë gjetur përgjegjës për vepra penale në dëm të shoqërisë, pra për shkak të gjendjes së tyre gjyqësore, duke iu mohuar *apriori* dhe duke mos iu njohur të drejtat e garantuara sipas Kodit të Punës, me pretendimin se janë debitor kundrejt saj, për shkak të dëmit që i kanë shkaktuar shoqërisë si rrjedhojë e konsumimit të veprës penale. Komisioneri arriti në përfundimin se, pretendimi i ankuesit se diferenca në trajtim bazuar në *gjendjen gjyqësore*, gëzon mbrojtje bazuar në nenin 1, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, pasi bazohet në një karakteristikë të identifikueshme dhe objektive, dhe se ankuesi mbart “shkakun tjetër”, sipas parashikimit të nenit 1 të ligjit.

Komisioneri vlerësoi se jemi në kushtet kur trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm ka ardhur si rezultat i shkakut të mbrojtur, pra gjendjes gjyqësore, të ankuesit. Bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon Shoqërisë RT Minerals sh.p.k., që të tregojnë se kjo diferencë në trajtim mund të justifikohet.

Referuar Kodit të Punës, nuk parashikohet ndonjë situatë e veçantë, kur ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet për shkak se punonjësi është proceduar ose dënuar penalisht, për vjedhje ose vepra ë tjera penale në dëm të punëdhënësit. Procedimi penal dhe procedurat e zgjidhjes së kontratës së punës dhe rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve sipas Kodit të Punës, janë të pavarura nga njëra tjetra. Kodi i Punës, gjithashtu parashikon rregulla të posaçme mbi mënyrën se si punëmarrësi përgjigjet për dëmet që i shkaktin punëdhënësit dhe rrugën që duhet të ndjekë ky i fundit për të marrë vlerën e dëmit që i është shkaktuar nga punëmarrësi. Paga përbën një nga elementët thelbësor të marrëdhënies dhe kontratës së punësimit. Paga paraqet një rëndësi të veçantë për sigurimin e jetesës dhe mirëqënies së punëmarrësit dhe familjes së tij. Në bazë të nenit 608 të Kodit Civil dhe të nenit 27 të Kodit të Punës, kur një punonjës i shkaktin dëm punëdhënësit për faj të tij, punëdhënësi ka të drejtë që dëmin e pretenduar si të shkaktuar ta kërkojë me një padi civile në gjykatë. Kodi i Punës nuk e njeh si mënyrë për rikuperimin e dëmit, pra

mënyrën e njëanshme të vlerësimit dhe vjeljes së tij. Kodi i Punës ka përcaktuar se kërkimi i dëmit të shkaktuar i drejtohet gjykatës dhe është kjo e fundit ajo që vendos, mbasi kryen të gjitha procedurat e parashikuara në ligj. Shoqëria RT Minerals sh.p.k., nuk legjitimohet që në mënyrë të njëanshme të ndërhyjë në pagën e ankuesit duke mos ia akorduar atë, me pretendimin se ankuesi konsiderohet nga ana e saj si debitor për dëmin e shkaktuar si pasojë e veprës penale të kryer nga ankuesi.

Shoqëria RT Minerals sh.p.k., edhe pse pretendon se asaj i është shkaktuar një dëm pasuror dhe jo pasuror në vlerë të konsiderueshme, si pasojë e veprimeve të ankuesit, ajo nuk paraqiti ndonjë vlerë konkrete të dëmit të pretenduar. Shoqëria RT Minerals sh.p.k., nuk ka kryer përlllogaritjet përkatëse se sa është dëmi i pësuar si pasojë e veprimeve të ankuesit dhe ta ketë vënë këtë të fundit në dijeni në lidhje me këtë fakt. Shoqëria *apriori* në përfundim të marrëdhënieve të punës me ankuesin, ka mbajtur qëndrimin se ankuesi duhet të privohet nga përfitimet e tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, pasi ai është gjetur penalisht përgjegjës. Pra, shoqëria në thelb e konsideron ankuesin debitor për shkak të faktit se ai është dënuar penalisht për veprime në dëm të saj, pa bërë më parë përlllogaritje objektive mbi atë që ankuesit i takon në kuadër të marrëdhënieve të punës dhe dëmit që ankuesi i ka shkaktuar shoqërisë RT Minerals sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit. Një sjellje e tillë nga ana e Shoqërisë RT Minerals sh.p.k., vjen gjithashtu në kundërshtim me Kodin e Punës, i cili bën një rregullim të posaçëm në lidhje me përgjegjësinë e punëmarrësit dhe mënyrën se si punëdhënësi ka të drejtë ta vjelë detyrimin për dëmin e shkaktuar. Bazuar në vendimin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, vlera e dëmit të shkaktuar shoqërisë RT Minerals sh.p.k., në cilësinë e viktimës së veprës penale është vlerësuar nga ekspertët në vlerën 1353 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

Komisioneri arriti në përfundimin se trajtimi ndryshe dhe më pak i favorshëm i ankuesit nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Komisioneri konstatoi se, ankuesi është diskriminuar për shkak të gjendjes gjyqësore, duke i'u mohuar të drejtat e garantuara në kuadër të marrëdhënies së punësimit (e drejta e pagës, shpërblimi për lejen vjetore të pakryer) .

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të ankuesit Gj.V., në të drejtën për punësim, për shkak të gjendjes gjyqësore, nga ana e Shoqërisë RT Minerals sh.p.k.
- Në referim të pikës 1, Shoqëria RT Minerals sh.p.k., të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke i njohur dhe paguar ankuesit Gj.V., pagën për ditët që ankuesi ka punuar gjatë muajit dhjetor 2019 dhe shpërblimin për lejen vjetore të pakryer.

XI. ÇËSHTJE DISKRIMINIMI NË FORMËN E SHUMËFISHTË DHE NDËRSEKTORIALE

51. Shoqata “Together for Life” kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

VENDIM NR. 161, DATË 01.09.2021

Shkaku: Gjendja shëndetësore, moshë dhe gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim ndërsektorial; Formë e rëndë diskriminimi
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Trajtim diskriminues i fëmijëve që vuajnë nga sëmundja e leucemisë, në të drejtën për kujdes shëndetësor dhe për të patur standartin më të lartë të shëndetit, duke mos i'u siguruar trajtimin me barnat e nevojshme për kimioterapi, gjatë kohës që ishin të shtruar në QSUNT.

FAKTET

Shoqata “Together for Life”, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar diskriminimin e fëmijëve të sëmurë me leucemi, për shkak të mungesës së barnave, në Pavionin e Onko-Hematologjisë në Shërbimin e Pediatriisë, pranë QSUNT.

Onko – Hematologjia Pediatrike është shërbim kombëtar, unik, qendër e referencës nacionale, që mban përgjegjësinë e përbushjes së tre atributive, të gërshetuara e koordinuara me njëra tjetrën: diagnostiko – kurative, didaktike dhe shkencore. Barnat *Metroteksat*; *Acid Folinik (Leucovorin)*; *Mercaptopurina*, janë barna të cilat janë pjesë e protokolleve të trajtimit për fëmijët me leucemi dhe janë barna vetëm për përdorim spitalor dhe përdoren për trajtimin e tyre me kimioterapi. Barnat dhe trajtimet për sëmundjen e leucemisë janë barna që kanë një kosto të lartë financiare. Rezultoi se, numri i fëmijëve me leucemi që kanë përdorur dhe kanë nevojë për t’u trajtuar me këto barna është: për vitin 2019- 71 pacientë; për vitin 2020 - 51 pacientë; për vitin 2021 -21 pacientë. Barnat, *Metroteksat*, *Acid Folinic (Leucovorin)* dhe *Mercaptopurina*, gjatë vitit 2020-2021, kanë qenë në mungesë dhe nuk janë ofruar për fëmijët me leucemi që trajtohen në Shërbimin e Onkohematologjisë pranë QSUNT-së. Arsyeja e mungesës së këtyre barnave ishte dështimi i procedurave të prokurimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar);
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijës”;
- Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015;
- Rezoluta WHA70.12, “Parandalimi dhe kontrolli i kancerit në kontekstin e një qasje të integruar”, miratuar nga Asambleja Botërore e Shëndetit, në vitin 2017;
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 14/2000 “E drejta për standartin më të lartë të arritshëm të shëndetit”, miratuar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”;
- Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Ligj Nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime”;
- Programi Kombëtar për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Joinfektive në Shqipëri 2016-2020.

KONKLUZIONE

Komisioneri, vlerësoi se në rastin konkret, mbrojtja nga diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore, konsiston në vulnerabilitetin e sëmundjes specifike, sikundër është leucemia.

Komisioneri arriti në përfundimin se, fëmijët e sëmurë me leucemi, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, për shkak të mungesës së barnave në Shërbimin e Onkohematologjisë, Pediatrike, në QSUNT. Trajtimi mjekësor, në çdo rast duhet të sigurohet në sasinë, cilësinë dhe kohën e duhur. Por, këto elementë marrin një rëndësi akoma më thelbësore, për sa i përket trajtimit me kimioterapi të kësaj sëmundje. Mosmarrja në dozën dhe kohën e duhur të trajtimit, në raport me vulnerabilitetin e sëmundjes, sjell pasoja të rënda në shëndetin e fëmijëve dhe ul mundësinë e tyre për t’i mbijetuar kësaj sëmundje.

Fëmijët përfaqësojnë një grup specifik të shoqërisë që gëzojnë një mbrojtje të posaçme. Fëmijët dhe e drejta e tyre për kujdes shëndetësor, gëzojnë mbrojtje të posaçme edhe nga e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

E drejta e fëmijëve për të patur standardin më të lartë të arritshëm për shëndetin e tyre, vendos mbi autoritetet shëndetësore detyrimin për të siguruar që asnjë fëmije të mos i mohohen shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe barnat thelbësore të nevojshme për trajtimin mjekësor. Sigurimi i barnave thelbësore/të domosdoshme për trajtimin mjekësor, përbën një nga detyrimet bazë minimale, që duhet të përmbushet për të siguruar të drejtën për të patur standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit të fëmijës. Referuar “*Listës së barnave thelbësore për fëmijët*”, publikuar nga OBSH, barnat që mungojnë në Shërbimin e Onko-Hematologjisë, Pediatrike në QSUNT, të cilat janë të nevojshme për trajtimin e fëmijëve të sëmurë me leucemi, janë pjesë e kësaj liste. Kjo do të thotë se, sigurimi i këtyre barnave, përbën detyrimin minimal bazë që shteti duhet të sigurojë për të garantuar të drejtën e fëmijëve për shëndet.

Komisioneri vlerësoi se, veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga QSUNT në cilësinë e ofruesit të kujdesit shëndetësor dhe MSHMS, në cilësinë e autoritetit më të lartë shëndetësor, e cila ka detyrimin për të organizuar dhe mbikëqyrur ofrimin e kujdesit shëndetësor, nuk kanë qenë aspak efçente dhe efikase, parime këto që duhet të udhëheqin ofrimin e kujdesit shëndetësor. Komisioneri vlerësoi se, dështimi i procedurave të prokurimit për barna kaq thelbësore për të siguruar kujdesin shëndetësor të fëmijëve me leucemi, nuk mund të shërbejë si justifikim i aryeshëm për mungesën e barnave.

E drejta për të patur standardin më të lartë të arritshëm/ e drejta për kujdes shëndetësor, si një e drejtë themelore e njeriut vendos mbi autoritetet shtetërore detyrimin për ta respektuar, mbrojtur dhe garantuar atë. Nëse detyrimi për ta respektuar vendos mbi shtetin detyrimin për të mos ndërhyrë, dy aspektet e tjera vendosin mbi shtetin dhe institucionet e tij detyrime me karakter pozitiv. Detyrimi për të mbrojtur, vendos detyrimin mbi shtetin dhe institucionet e tij për të mbrojtur individin nga veprimet e të tretëve, ndërsa detyrimi për të garantuar gëzimin e kësaj të drejte vendos detyrime mbi shtetin për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim realizimin e të drejtës për shëndet.

Duke mbajtur në konsideratë se mungesa kujdesit shëndetësor në kohën dhe cilësinë e duhur, sjell pasoja në shëndetin e çdo pacienti, pasojat e mungesës së kujdesit shëndetësor në kohën dhe cilësinë e duhur, për sëmundje të caktuara, të cilat kanë një shkallë të lartë vdekshmërie, janë padyshim më të rënda.

Në kushtet kur barnat për trajtimin e fëmijëve me leucemi janë në mungesë pranë QSUNT, marrja e shërbimit në këtë institucion shëndetësor, bëhet e mundur vetëm nëse prindërit dhe familjarë sigurojnë vetë barnat e nevojshëm për trajtimin e fëmijëve. Për rrjedhojë edhe mungesa e barnave në QSUNT, prek akoma më shumë fëmijët që vijnë nga familjet e varfra, të cilët nuk kanë mundësi ekonomike për blerjen e barnave në mënyrë private, ndërkohë që ato janë barna të cilat duhet të ofrohen falas nga shteti gjatë hospitalizimit të këtyre fëmijëve dhe trajtimit të tyre në shërbimin e onkohematologjisë në QSUNT. Pamundësia ekonomike e vendos këtë kategori fëmijësh përballë pamundësisë absolute për t’i siguruar qoftë edhe privatisht barnat nga familjarët. Nuk ka asnjë mundësi rimbursimi për rastet kur familjarët për të mundësuar trajtimin shëndetësor në sasinë e duhur dhe në kohën e duhur, kanë blerë privatisht barnat e përshkuar nga mjekët për trajtimin

mjekësor të fëmijëve të tyre, ndërkohë që barnat për trajtimin e sëmundjes së leucemisë kanë një kosto të lartë.

Komisioneri, vlerësoi se shkak i moshës, gjendjes shëndetësore dhe gjendjes ekonomike, veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra tjetrën, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme me njëra tjetrën, duke i ekspozuar fëmijët me leucemi ndaj trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, Komisioneri arrin në përfundimin se, QSUNT dhe MSHMS, me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë diskriminuar fëmijët me leucemi në Shërbimin e Onko-Hematologjisë Pediatrike në QSUNT, për shkak të gjendjes shëndetësore, moshës dhe gjendjes ekonomike. Këto dy institucione kanë dështuar që të marrin në konsideratë nevojat e veçanta që kanë fëmijët, të cilët përballen me sfida të veçanta për sa i përket shëndetit, për shkak të zhvillimit të tyre fizik. Të gjitha aktet dhe instrumentat ligjorë, imponojnë një mbrojtje të posaçme për fëmijët, me qëllim gëzimin prej tyre të standartit më të lartë të arritshëm të shëndetit; nevojat e veçanta që paraqesin në trajtim, sëmundje të rënda, sikundër është leucemia; si dhe kushtet akoma më të pafavorshme që vendoset kategoria e fëmijëve me leucemi, të cilët për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike e kanë të pamundur që në mungesë të ofrimit të trajtimit shëndetësor pranë QSUNT, të sigurojnë në mënyrë private barnat e nevojshëm.

Barazia dhe mosdiskriminimi imponojnë jo vetëm ndalimin e diferencës në trajtim, por edhe detyrimin për të adresuar ndryshe nevojat e veçanta që kanë grupe të ndryshme të cilët janë më shumë të cenueshëm ose vulnerabël. Pavarësisht se nuk ka qenë qëllimi i MSHMS dhe QSUNT, që të vendosin në pozita të pafavorshme dhe të pabarabartë fëmijët me leucemi, mungesa e këtij qëllimi, nuk i përjashton nga përgjegjësia.

Komisioneri vlerësoi se, sjellja diskriminuese e konstatuar, përbën formë të rënde të diskriminimit, pasi ka si bazë më shumë se një shkak, atë të gjendjes shëndetësore, moshës dhe gjendjes ekonomike dhe ka sjellë pasojë veçanërisht të dëmshme për fëmijët e sëmurë me leucemi.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të fëmijëve që vuajnë nga sëmundja e leucemisë, në Shërbimin e Onko-Hematologjisë, Pediatrike, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të gjendjes shëndetësore, moshës dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrin në mënyrë të menjëhershme masat e duhura, për ofrimin e barnave të nevojshme për trajtimin e fëmijëve me leucemi, në Shërbimin e Onko-Hematologjisë, Pediatrike, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Komisioneri rekomandon Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që të marrin masa për të rishikuar procedurat për

sigurimin e barnave, në kushte të tilla emergjente dhe mundësinë e rimbursimit të shpenzimeve për barnat që sigurohen për domosdoshmëri shërbimi nga ana e vetë pacientëve.

52. S.R., dhe P.R., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

VENDIM NR. 185, DATË 29.09.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar, mosha dhe gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesit i është mohuar e drejta për shërbim shëndetësor, pasi MSHMS dhe QSUNT nuk kanë siguruar trajtimin e tij me medikamente mjekësore gjatë kohës që ishte i shtruar në spital.

FAKTET

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi është diagnostikuar me aftësi të kufizuar intelektuale (Syndrome Down) dhe Leukoza (leucemia) limfoide, fakt që vërtetohet nga një sërë aktesh të lëshuar nga QSUNT-ja, si dhe nga Zyra Rajonale e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar Tiranë.

Referuar Vendimit të Zyrës Rajonale të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Tiranë, fëmija F.R., përfiton pagesën për aftësinë e kufizuar. Njëkohësisht referuar Kartelës Klinike të lëshuar nga shërbimi i Onkohematologjisë, pavijoni i pediatriisë, në QSUT, rezulton se pacienti F.R është shtruar pranë këtij shërbimi në këtë datë, dhe ka diagnozën e shtrimit për të cilën bëhet trajtim klinik për: syndrome down, tiroidit Hashimoto dhe hiperglicemi.

Onkohematologjia Pediatrike është shërbim kombëtar, unik, qendër e referencës nacionale, që mban përgjegjësinë e përmbushjes së tre atributive, të gërshetuara e koordinuara me njëra tjetrën: diagnostiko–kurative, didaktike dhe shkencore. Barnat Metroteksat 50 mg flakon dhe Doxorubicine 50 mg flakon, janë barna të cilat janë pjesë e protokolleve të trajtimit për fëmijët me leucemi dhe janë barna vetëm për përdorim spitalor dhe përdoren për trajtimin e tyre me kimioterapi.

Bazuar në deklarinimin e ankuesit, faturave të sjella në cilësinë e provës, për blerjen e barit Methotrexate por dhe të medikamenteve të tjera me të cilat kurohej fëmija, rezulton se kostoja për

trajtimin e fëmijës të sëmurë me leucemi, është shumë e lartë për situatën ekonomike të familjes S.R., dhe P.R. Referuar aneksit të Kontratës së Furnizimit të lidhur mes QSUNT-së dhe Shoqërisë “F... N... A” për blerjen e barit Methotrexat 50 mg/flakon/ampulë, rezulton se çmimi për 1 (një) njësi është 289 lekë. Ndërsa referuar shkresës së Grupit të Punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, rezulton se çmimi për një njësi i barit Methotrexat 50 mg/2ml flakon/ampulë, është 258.26 lekë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolle 12 i saj;
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijës”;
- Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokolle Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Vendimin Nr. 483, datë 29.6.2016, e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2020”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendimet Nr. 39, datë 16.10.2007, Nr. 4 datë 12.02.2010, Nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- VKM Nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime”.

KONKLUZIONE

Komisioneri konstatoi se, sjellja e MSHMS dhe QSUNT, karakterizohet nga neglizhencë nga të dy institucionet, mungesë informacioni, mungesë bashkëpunimi, mungesë komunikimi, shmangie përgjegjësie, mosanalizim dhe mungesë e përpjekjeve të vazhdueshme për sigurimin e barnave, nga ana e këtyre institucioneve përgjegjëse të përfshira në procedurën e garantimit të barnave.

Çështja e sipër përmendur konsiston në trajtimin e pacientit F.R me barin Methotrexane 50 mg/flakon, gjatë periudhave që ai ishte i shtruar në QSUNT. Nga informacioni dhe provat e sipërcituara, rezultoi se ankuesi nuk ka marrë barin e rekomanduar nga mjekët e spitalit.

Komisioneri vlerëson se, pacienti F.R, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, për shkak të mungesës së barit, Methotrexane 50 mg/flakon, në Shërbimin e Onkohematologjisë, Pediatrike, në QSUNT.

Komisioneri vlerëson se, dështimi i procedurave të prokurimit për sigurimin e barit objekt i kësaj ankese, i nevojshëm për trajtimin e ankuesit në Shërbimin e Onko-Hematologjisë Pediatrike në QSUNT, nuk përbën një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, ndaj të cilit është ekspozuar ankuesi i sëmurë me leucemi, si pasojë e mungesës së barit në Shërbimin e Onkohematologjisë Pediatrike në QSUNT. Komisioneri, vlerëson se shkak i moshës, aftësisë së kufizuar, gjendjes shëndetësore dhe gjendjes ekonomike, veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra tjetrën, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme me njëra tjetrën, duke e ekspozuar ankuesin ndaj trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, Komisioneri arrin në përfundimin se, QSUNT dhe MSHMS, me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë diskriminuar ankuesin e sëmurë me leucemi në Shërbimin e Onkohematologjisë Pediatrike në QSUNT, për shkak të aftësisë së kufizuar, moshës, gjendjes shëndetësore dhe gjendjes ekonomike.

Këto dy institucione kanë dështuar që të marrin në konsideratë nevojat e veçanta që ka fëmija me aftësi të kufizuara, i cili përballet me sfida të veçanta për sa i përket shëndetit, për shkak të zhvillimit të tij fizik e mendor. Të gjitha aktet dhe instrumentet e mësipërm ligjorë, imponojnë një mbrojtje të posaçme për fëmijës me aftësi të kufizuara, me qëllim gëzimin prej tij të standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit; nevojat e veçanta që paraqesin në trajtim, sëmundje të rënda, sikundër është leucemia; si dhe kushtet akoma më të pafavorshme që vendoset fëmija me leucemi dhe aftësi të kufizuara, i cili për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike e ka të pamundur që në mungesë të ofrimit të trajtimit shëndetësor pranë QSUNT, të sigurojë në mënyrë private barin e nevojshëm. Barazia dhe mosdiskriminimi imponojnë jo vetëm ndalimin e diferencës në trajtim, por edhe detyrimin për të adresuar ndryshe nevojat e veçanta që ka një fëmijë që është i sëmurë me leucemi dhe me aftësi të kufizuar, i cili është më shumë i cenueshëm ose vulnerabël. Dështimi për të përmbushur detyrimet e mësipërme, përbën diskriminim.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të F.R., për shkak të aftësisë së kufizuar, moshës, gjendjes shëndetësore dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Në referim të pikës 1, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të marrin në mënyrë të menjëhershme masat e duhura, për ofrimin e barit Methatroxate 50 mg/flakon, në Shërbimin e Onkohematologjisë, Pediatrike, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Komisioneri rekomandon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, që të marrin masa për të rishikuar procedurat për sigurimin e barnave, në kushte të tilla emergjente dhe mundësinë e rimbursimit të shpenzimeve për barnat që sigurohen për domosdoshmëri shërbimi nga ana e vetë pacientëve.

53. G.Zh., kundër Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë

VENDIM NR. 254, DATË 28.12.2021

Shkaku: Bindja politike, gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i shumëfishtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi është diskriminuar në marrëdhëniet e punësimit për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

FAKTET

Rezulton se DAP-i ka transferuar ankuesin në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Administrimit të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit në ARM Fier/Vlorë/ Gjirokastrë. Me urdhrin e Drejtorit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, është komanduar përkohësisht në kryerjen e detyrës së protokollistit.

Referuar informacionit dhe deklaratave të palëve, rezulton se A.H., përfaqësues për zgjedhjet i Partisë Socialiste në Gjirokastrë, ka biseduar në telefon me A.V., duke i kërkuar që të lejonte G.Zh., të mos paraqitej në punë, që të bënte fushatë për Partinë Socialiste. A.V ka refuzuar kërkesën e përfaqësuesit të PS duke argumentuar se G.Zh., është nëpunës civil dhe e ka të ndaluar që të angazhohet në fushatë elektorale. Sipas deklaratës së A.V., në seancë, ai i ka thënë ankuesit që të mos fusë miq për ta lënë të punojë në Gjirokastrë. Pas këtij takimi të zhvilluar mes palëve dhe mospranimit të angazhimit në fushatën elektorale, për G.Zh., kanë filluar dhe veprimet tendencioze, të pretenduara prej tij.

Gjatë muajit prill 2021, ankuesi ka kërkuar tre herë që të shfrytëzojë lejen e zakonshme për arsye shëndetësore dhe familjare. Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, ka refuzuar kërkesat për leje vjetore dhe pa të drejtë page, duke mos dhënë arsye ligjore apo justifikim objektiv për refuzimin e kërkesave.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Protokolle 12 i saj;
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: “Çështja Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë”, “Çështja D.H., dhe të tjerët kundër Republikës Çeke”;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”;
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore;

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- VKM-së Nr. 115, datë 05.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;
- VKM-së Nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 02.04.2014 i Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë procedurale dhe materialë të ecures dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

KONKLUZIONE

Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm apo arsye objektive për mosdhënien e lejes vjetore ankuesit, konstaton se G.Zh., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

Komisioneri vlerëson se, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, A.V., i ka të ekspozuara dhe të provuara aktivitetin e tij politik, pasi ka qenë i zgjedhur dhe përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe ka pasur dijeni për aktivitetin politik të ankuesit, kur gjatë seancës dëgjimore deklaroi se: “Në dijeninë time ai është marrë me fushatë, edhe gjatë kohës së punës, të pa verifikuar këto, dhe është marrë për subjektin që pretendon (LSI), e di shumë mirë këtë gjë”.

Komisioneri duke vlerësuar marrëdhëniet e punës mes drejtuesit të institucionit dhe ankuesit, ngre dyshimin e arsyeshëm se veprimi i A.V., duke mosmiratuar lejen vjetore, ka qenë veprim i pajustificuar dhe i njëanshëm, në dëm të ankuesit.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruara.

Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkaqet e bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore, kanë vepruar veçmas duke rënduar situatën e ankuesit.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, nuk arriti të faktonte përpara Komisionerit se: Kishte arsye objektive dhe të justifikuar për mosmiratimin e lejes vjetore të ankuesit të kërkuar gjatë muajit prill 2021.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se G.Zh., është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Duke iu referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore, dhe se punëdhënësi ka patur dijeni për to, si dhe faktit që ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë nuk arriti të provojë se nuk ka patur një trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e tyre kundrejt ankuesit për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore; Komisioneri gjykon se, justifikimi i punëdhënësit për trajtimin e G.Zh., nuk ishte objektiv, i përligjur apo i justifikuar.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon bindjen dhe vlerëson se shtetasi G.Zh., është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e Drejtorit të

ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, trajtim i cili ka ardhur për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore të ankuesit.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të shumëfishtë për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore të shtetasit G.Zh., nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

54. V.K., kundër Ministrisë së Brendshme dhe ALEAT sh.p.k.

VENDIM NR. 42, DATË 30.03.2021

Shkaku: Aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Mohimi i përshtatjes së arsyeshme, nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe ALEAT sh.p.k., duke mos i ofruar mundësi aksesit të nevojshëm personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të gjendjes shëndetësore e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identitetit.

FAKTET

Aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore e vajzës së ankuses, nuk i lejon që ajo të mund të aplikojë për tu pajisur me kartë identiteti, si të gjithë qytetarët e tjerë, për shkak se ajo e ka të pamundur të aksesojë Zyrat e Kompanisë ALEAT sh.p.k. Gjithashtu, ajo ndodhej përpara faktit që kartës së identitetit të vajzës së saj i kishte përfunduar vlefshmëria dhe në këtë situatë ajo e kishte të pamundur të përfitonte nga shërbimet shëndetësore të nevojshme. Referuar gjendjes së saj shëndetësore, E.T.,¹⁸ përfitonte pagesë për aftësinë e kufizuar. Për rinovimin e dokumentacionit për vazhdimin e trajtimit me pagesën e aftësisë së kufizuar, një ndër dokumentat e kërkuar është dhe karta e identitetit.

Shërbimi i kërkuar në kushte banese, mund të ofrohej vetëm me kushtin që të aplikohet për një pasaportë, me një tarifë shërbimi prej 18.000 lekë dhe në momentin e aplikimit bëhej edhe ai i kartës së identitetit me një tarifë prej 1500 lekë. Pra, ankuesja ishte e detyruar për të paguar një

¹⁸ Vajza e subjektit ankues

tarifë shërbimi të panevojshme për marrjen e pasaportës, kur asaj nuk i shërbente dhe nuk mund ta përdorte.

Pra, E.T., ndodhej përpara situatës në të cilën, e kishte të domosdoshme të bënte rinovimin e dokumentacionit sa i përket vijimit të trajtimit me pagesë të aftësisë së kufizuar. Fakti që ajo kishte kartën e identitetit jashtë afateve të vlefshmërisë, bënte të pamundur kryerjen e veprimeve të sipërcituara dhe ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar. Kjo situatë mund të sillte si pasojë pamundësinë për të siguruar barnat apo kushtet mjekësore për trajtimin shëndetësor të saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) *“Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”*, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*,
- Ligji Nr. 57/2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- Vendimi Nr. 483, datë 29.06.2016, i Këshillit të Ministrave, për miratimin e *“Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020”*,
- Vendimi Nr. 525, datë 08.08.2007 projektin për Koncesionin *“Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike”*.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria ALEAT sh.p.k., dhe Ministria e Brendshme, nuk vunë në dispozicion asnjë informacion lidhur me:

- Hapat e ndërmarrë apo procedurën e miratuar, për ofrimin e mundësisë së personave me aftësi të kufizuara apo të shtetasve të cilët ndodhen në kushtet e pamundësisë për t’u paraqitur fizikisht pranë Zyrave të Aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identifikimit;
- Procedurën standarte për ofrimin e shërbimit në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë, për personat me aftësi të kufizuara si në rastin e subjektit ankues;
- Tarifat standarte për ofrimin e shërbimit për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identitetit, për personat në nevojë që përfitojnë nga programet e ndihmës ekonomike apo që trajtohen me pagesë të aftësisë së kufizuar, të cilët nuk ndodhen në të njëjtat kushte me qytetarët e tjerë;
- Procedurën e miratuar, që personat në kushtet e ankueses, të mund të aplikojnë për Kartë Identiteti apo Pasaportë Biometrike, pa patur detyrimin që të paguajnë apo marrin shërbimin për të dy Dokumentat Biometrik të Identitetit njëkohësisht.

Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga Shoqëria ALEAT sh.p.k., dhe Ministria e Brendshme, u vërejt se ka patur edhe raste të tjera në kushtet e shtetasës E.T, ku këto subjekte

janë vënë në dijeni dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të miratuar një procedurë standarte për lehtësimin e kostos apo të ofrimit të shërbimit për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identifikimit.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Ministria e Brendshme, me anë të mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, E.T., dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të njëjta me të, sa i përket aksesueshmërisë.

Rezultoi se, shoqëria ALEAT sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit, i cili ofron shërbimin e pajisjes me Dokumenta Biometrik të Identitetit, ka refuzuar që të kryejë ndryshimet/rregullimet e nevojshme për të ofruar shërbimin për t'u pajisur me kartë identiteti në ambientet ku qëndron shtetasja E.T. Ky ndryshim/rregullim i kërkuar në rastin e shtetasës E.T., është e vetmja mënyrë që ajo të përfitojë shërbimin, kjo për shkak se kjo shtetase e ka të pamundur të lëvizë. Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykon se kërkesa për të ofruar shërbimin për tu pajisur me kartë identiteti në banesë, është një ndryshim/rregullim i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për rastin e shtetasës E.T. Në kushtet kur rezultoi se ofrimi i këtij shërbimi në banesë nuk përbën një barrë të tepruar, për ofruesin e shërbimit, në rastin konkret për shoqërinë ALEAT sh.p.k., Komisioneri arrin në përfundimin se shoqëria ALEAT sh.p.k., e ka vendosur shtetasen E.T., përballë një situatë diskriminuese, të konsumuar në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se shtetasës E.T., i është mohuar përshtatja e arsyeshme, nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., dhe aksesueshmëria nga ana e Ministrisë së Brendshme, të cilat do të bënin të mundur që E.T., të aplikonte për kartë identiteti.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të shtetasës E.T., në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme, nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore.
- Konstatimin e diskriminimit të shtetasës E.T., dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, për shkak të aftësisë së kufizuar nga Ministria e Brendshme.
- Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., për të garantuar ofrimin e shërbimit për pajisjen me kartë identiteti të shtetasës E.T., në ambientet e banesës dhe me koston normale të saj.
- Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të parashikuar në kontratën koncesionare, procedura konkrete apo mundësi aksesit të nevojshëm që duhen përmbushur, për personat me aftësi të kufizuara të cilët e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identitetit.
- Komisioneri rekomandoi që Shoqëria ALEAT sh.p.k., dhe Ministria e Brendshme, brenda 3 (tre) muajve, të hartojnë një skemë/program të mënyrave lehtësuese për përfitimin nga shërbimi për pajisjen me kartë identiteti apo pasaportë biometrike, për personat të cilët janë të pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore apo aftësisë së kufizuar.

55. M.Z., kundër Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës

VENDIM NR. 126, DATË 05.07.2021

Shkaku: Raca dhe gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

M.Z., është diskriminuar për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare, nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës pasi legalizimi i objektit informal të deklaruar nga ana e tij nuk është kryer para vitit 2017, pasi vetëdeklarimi i tij i fundit është depozituar në muajin gusht të vitit 2006, pranë ish-Aluiznit, Drejtoria Rajonale Tiranë, pra rreth 11 vite më parë se të miratohej Plani i Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

FAKTET

Ankuesi M.Z., është banor në Yzberisht, Tiranë, i cili ka ndërtuar në vitin 2006 një objekt banesë pa leje ndërtimi në Njësinë Administrative Nr. 6. Në vijim, ai ka depozituar vetëdeklarimin nr. 3434 prot., datë 20.03.2005 dhe vetëdeklarimin Nr. 17, datë 04.08.2006, për legalizimin saj. Edhe pse kanë kaluar 15 vjet, ai ende nuk ka fituar pronësinë mbi objektin e sipërpërmendur.

Rezulton se vetëdeklarimet e ankuesit M.Z., janë depozituar pranë ish- Aluiznit, Drejtorisë Rajonale Tiranë, e cila ka funksionuar deri në vitin 2018, periudhë në të cilën u miratua Ligji Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, nëpërmjet së cilit është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ndër të tjera mori edhe funksionet e ish-Aluizmit. Ndërkohë që, nëpërmjet Urdhërit Nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, “Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës” janë përcaktuar gjithashtu edhe kompetencat e Drejtorive të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat do të shqyrtojnë në vijim kërkesat për legalizim të objekteve informale, të cilat ishin ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale të Aluiznit.

Në referencë të nenit 5, të Ligjit Nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proçeseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proçeseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Nga korrespondenca zyrtare e KMD-së me Drejtorinë Vendore Tirana Rurale 2, të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, rezulton se Bashkia Tiranë e ka informuar këtë institucion nëpërmjet

shkresës Nr. 10546/1, datë 18.03.2021, se territori ku, pozicionohet objekti informal i M.Z., preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

Në këto kushte, për sa kohë që ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, në bazë të pikës 15, gërma c), të VKM Nr. 1040/2020, procesi i legalizimit nuk është vazhduar më tej nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.

Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, e cila është marrë me shqyrtimin e kërkesës së ankuesit për legalizim, e ka bërë me dije M.Z., lidhur me sa më sipër, nëpërmjet shkresave Nr. 663, datë 21.04.2021, dhe shkresës Nr. 1443/3, datë 27.04.2021.

Nga analizimi i fakteve të sipërcituara rezulton se legalizimi i objektit informal të deklaruar për legalizim nga ana e M.Z., nuk mund të kryhet, pasi ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, datë 14.04.2017.

Në këto kushte, lind natyrshëm pretendimi i ankuesit, se përse legalizimi i objektit informal të deklaruar nga ana e tij nuk është kryer para vitit 2017, pasi vetëdeklarimi i tij i fundit është depozituar në muajin gusht të vitit 2006, pranë ish-Aluiznit, Drejtoria Rajonale Tiranë, pra rreth 11 vite më parë se të miratohej Plani i Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe Protokolli 12 i saj;
- Direktiva 2000/43/EC e Këshillit të Bashkimit Evropian
- Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri gjykoi se pavarësisht faktit se në vitin 2018, është kryer një riorganizim institucional, duke krijuar institucionin e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive të saj rajonale, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të suprimuara janë trashëguar tek institucionet e reja. Janë pikërisht Drejtoritë rajonale të ASHK-së që shqyrtojnë dosjet e deklarimeve të pashqyrtuara nga ana e Ish-Aluiznit.

Zvarritja e kryerjes së legalizimit të objektit informal të deklaruar nga M.Z., nga viti 2006 deri në vitin 2021 është tej çdo afati ligjor të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Kjo zvarritje shumëvjeçare i ka kushtuar ankuesit në heqjen e mundësisë të legalizimit të këtij objekti, pasi në vitin 2017, me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, ndërtesa e tij informale preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në këtë Plan.

Komisioneri gjykoi se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, e cila si pjesë e ASHK-së, si dhe në bazë të nenit 67, të Ligjit Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ka në ngarkim të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike. Ankuesi ka depozituar deklarin e tij për legalizim të ndërtesës informale që në vitin 2006 dhe procedura e legalizimit është zvarritur për pothuajse 15 vjet. Vetëm në vitin 2021, pas fillimit të hetimit administrativ të Komisionerit, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 u vu në lëvizje për të proceduar mbi rastin e tij. Një zvarritje e tillë atij i ka kushtuar shumë, pasi aktualisht legalizimi i këtij objekti nuk mund të kryhet më, pasi me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë në vitin 2017, ndërtesa e tij informale preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në këtë Plan.

Drejtorja Vendore Tirana Rurale 2 nuk dërgoi pranë KMD-së informacionin e kërkuar që konsistonte në të dhëna, lidhur me banorë të tjerë, të së njëjtës zonë me ankuesin, që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim në periudhën kohore 2006-2017 dhe objektet e tyre janë legalizuar, informacion mbi arsyen e mos legalizimit të ndërtimit informal të M.Z., para vitit 2017 etj., edhe pse kishte barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e asaj që pretendonte ankuesi. Në këtë kontekst, Komisioneri thekson faktin se të dhënat e kërkuara nga KMD, u konsideruan si të dhëna të gjatshme dhe të administruara nga Drejtorinë Vendore të ASHK-së, edhe nga ana e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së në seancë dëgjimore. Por, pavarësisht kësaj, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 nuk e dërgoi informacionin e kërkuar. Për të bërë të qartë situatën, Komisioneri i dërgoi zyrtarisht këtij institucioni, audion e seancës dëgjimore, në të cilën Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 mungoi dhe nuk dërgoi përfaqësues.

Komisioneri gjykoi se mosdhënia e të dhënave të kërkuara nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, ka penguar kryerjen e hetimit administrativ për shqyrtimin e ankesës së M.Z. Një veprim i tillë bie ndesh me nenin 32, pikat 2 dhe 4, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”* “Detyrimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni përmbushet në përputhje me legjislacionin që rregullon të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”. Informacioni i kërkuar nga KMD nuk konsiderohet cënim i të dhënave personale, pasi në thelb kalimi i parcelave është objekt aktesh normative, që botohen në fletore zyrtare. Duke qenë se Drejtoria Rajonale Vendore Tirana 2 e disponon informacionin dhe ka detyrimin për ta vënë atë në dispozicion, sidomos një organi publik për trajtimin e një procedure administrative-hetimore, është e nevojshme të mbahet në konsideratë që informacioni i kërkuar lidhet me standartin e krahasimit që përdoret për çështjet, që lidhen me pretendime për diskriminim dhe trajtohet nga KMD duke respektuar gjithë legjislacionin për të drejtën e informimit dhe të dhënave personale.

KMD gjykon se M.Z., është diskriminuar për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit të M.Z., për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

56. M.L., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

VENDIM NR. 188, DATË 06.10.2021

Shkaku: Për shkak të bindjeve politike dhe denoncimeve kundër punëdhënësit
Forma: Në formën e diskriminimit ndërsektorial
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

M.L., është diskriminuar në të drejtën për punësim nga Drejtorisa e Përgjithshme të Doganave për shkak të bindjeve politike dhe denoncimeve kundër punëdhënësit.
--

FAKTET

Ankuesi ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Administratës Doganore me datë 17.10.2013, në detyrën Drejtor i Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit.

Bazuar në vlerësim e rezultateve në individuale në punë (jokënaqshëm), si dhe rezultatet e trajnimit të detyrueshëm në përfundim të afatit të periudhës së proves, nuk është konfirmuar Nëpunës Civil (liruar nga shërbimi civil me Vendim Nr. 13467/1 Prot., datë 04.06.2015). Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë, me vendimin e saj, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur ndër të tjera edhe: *“Rikthimin e M. L., në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Informacionit pranë DPD”*.

Në zbatim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Apelit Administrativ, ankuesi ka nënshkruar një deklaratë dhe ka pranuar punësimin e tij në një pozicion pune të së njëjtës kategori dhe në pamundësi në një kategori më të ulët brenda institucionit nga i cili është larguar, duke pranuar emërimin në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Operacioneve Doganore, dega doganore Morinë. Në këtë kuadër, Departamenti i Administratës Publike, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, aktin e emërimit të ankuesit në pozicionin e pranuar prej tij.

Gjatë periudhës që ankuesi ka qenë në pritje për emërimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, i është drejtuar këtyre të fundit me shkresë, në të cilën ka kërkuar emërimin në një pozicion tjetër me kategori A, me ose pa status të nëpunësit civil pranë DPD-së.

Në vijim, është emëruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Kukës (Morinë). Po në të njëjtën ditë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, ka vendosur: *“Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit civil, M.L., në detyrën Përgjegjës në Sektorin e Operacioneve Doganore në Degën Doganore Morinë, Kukës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”*.

Në vijim, ankuesi është transferuar përkohësisht për një periudhë të shkurtër, nga një detyrë në tjetrën, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Në vitin 2021, i është drejtuar punëdhënësit dhe disa drejtuesëve të tjerë të administratës doganore, me një letër denoncuese për kontrabandën që bëhej në sistemin doganor shqiptar, kryesisht nga ana e strukturave të Antikontrabandës dhe Hetimit Doganor. Gjithashtu, ka garantuar gadishmërinë e tij për tu ballafaquar për vërtetësinë e këtij informacioni.

Më pas, rezulton se ankuesi ka kërkuar nga ana e punëdhënësit, të shfrytëzojë lejen e zakonshme, e cila nuk i është miratuar. Nga ana e ankuesit, me anë të e-mailit është dërguar pranë punëdhënësit raporti mjeksor për paaftësi të përkohshme në punë.

Ditën që ankuesi është kthyer në punë nga përfundimi i raportit për paaftësi të përkohshme në punë, për shkak të shkeljes nga ana e tij, të parimeve të mirëbesimit dhe integritetit, punëdhënësi ka zgjidhur marrëdhëniet e punësimit me ankuesin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁹ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*;
- Karta Social Evropiane, ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, *“Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 102/2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 60/2016 *“Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”*;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 2, datë 08.01.2018 *“Për disa ndryshime në vendimin Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për Personelin e Administratës Doganore’*, i ndryshuar.

¹⁹ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstatoi se:

- Që në momentin e rikthimit në punë, mbështetur në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, ndaj ankuesit filloi trajtimi i pafavorshëm dhe i padrejtë, duke e liruar nga shërbimi civil dhe duke e emëruar në një pozicion pune i cili nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil;
- Në vijim, menjëherë pas emërimit në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, të G.G., rreth 1 (një) muaj më vonë, ankuesi u transferua në një pozicion pune të një kategorie më të ulët, duke u transferuar nga pozicioni që mbante si Drejtor i Antikontrabandës, si nëpunës i kategorisë A, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Antikontrabandës Detare, si nëpunës i kategorisë B;
- Gjithashtu, zgjidhja e marrëdhënieve të punës së ankuesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, u bë në mënyrë të menjëhershme dhe në shkelje të legjislacionit të punësimit, siç është parashtruar në rubrikën A të këtij vendimi;
- Pavarësisht faktit që ankuesi si një punonjës i cili sinjalizoi aktet korruptive të strukturave doganore duhej mbrojtur (referuar analizës së bërë në rubrikën A të këtij vendimi), nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në formë hakmarrje u bë ndërprerja e menjëhershme e kontratës së punës;
- Në përfundim, nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët, rezultoi se ndaj ankuesit ishte marrë sanksion me gjobë si pasojë e dëmtimit të mjetit që kishte në përdorim, pavarësisht se një procedurë e tillë nuk ishte e parashikuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Komisioneri konstaton se largimi i ankuesit nga pozicioni i punës si Drejtor i Antikontrabandës, nuk ka ardhur për arsye të justifikuara. Pra, nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i kanë ardhur menjëherë pas denoncimeve të bëra lidhur me korrupsionin në strukturat doganore.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi se M.L., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e bindjes politike të tij dhe denoncimit të korrupsionit dhe kontrabandës së bërë nga ana e strukturave doganore.

VENDIMI

- Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit M.L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike dhe denoncimeve për kontrabandën e kryer në sistemin doganor shqiptar, *në formën e diskriminimit ndërsektorial*, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.



KONTAKTE:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Tiranë

Adresa: Rruga "Durrësit" Nr.27, 1001, Tiranë

Tel: + 355 4 243 1078

web: www.kmd.al

e-mail: info@kmd.al

Zyra Rajonale e KMD në Shkodër

Adresa:, Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1. Në godinën e Bashkisë Shkodër, (Kati II).

Kodi Postar: 4001

Mob: +355 67 449 6586

Zyra Rajonale e KMD në Korçë

Adresa: Pranë Ish Bashkisë Korçë, Rr:28 Nentori, Nr.1

Kodi Postar: 7001

Tel: +355 69 620 7371

Zyra Rajonale e KMD në Fier

Adresa: Rruga "Ramiz Aranitasi". Në godinën e Këshillit të Qarkut Fier, (Kati 1).

Kodi Postar: 9301

Mob: +355 69 516 1864

NUMRI JESHIL: PA PAGESË

08000606